



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“BASHKINË HIMARË”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
FINANCIAR DHE I PËRPUTHSHMËRISË
NË
“BASHKINË HIMARË”

TIRANË, 2024

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	12
II.	HYRJA	3
1	Objektivat dhe Qëllimi i auditimit.	13
2	Identifikimi çështjes	13
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	13
4	Përgjegjësitë e audituesve	13
5	Kriteret e vlerësimit	14
6	Standardet e auditimit	14
7	Metodat e auditimit	14
8	Dokumentimi i auditimit	6
III.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT	6
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	6
2.	Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit	6
2.1	Pika 1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.	6
2.2	Pika 2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.	14
2.3	Pika 3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	19
2.4	Pika 4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.	30
2.5	Pika 5 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)	62
2.6	Pika 6 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.	66
2.7	Pika 7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.	126
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	139
	Masa Organizative	139
	Masa për shpërblim dëmi	144
	Masa për Eliminimin e Efekteve Negative	145
V.	Lista e dokumentacionit të auditimit	146
VI	ANEKSE	

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Himarë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Himarë për periudhën e aktivitetit 2022, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhues dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Himarë për periudhën e aktivitetit 2022, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhues dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Funkzionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022,
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese

e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në F t materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: Kontrolli aritmetik. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:

-Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën 1,341,496 mijë lekë, ndërsa realizimi 539,935 mijë lekë, ose në masën 40%, ku zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 127,825 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 109,436 mijë lekë, ose në masën 86%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 79%. Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën 297,892 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 158,988 mijë lekë, ose në masën 53.%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 827,787 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 240,407 mijë lekë, ose në masën 29%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Himarë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Gjithashtu rezultojnë se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022.

- Në auditimin e procedurave të prokurimit, u konstatua se **3** procedura janë në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, në hartimin e kriterave jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga AK, duke evidentuar një efekt financiar në vlerën 2,023 mijë lekë.

- Në zbatim të nenit 30, Pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është kthyer përgjigje në KLSH, në lidhje me masat korrigjuese të marra dhe të pranuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga **14** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **2** janë zbatuar pjesërisht, **1** është në proces zbatimi dhe **11** nuk janë zbatuar.

-Nga **3** masa për uljen e borxhit të **3** masat janë të pa zbatuara.

-Nga **4** masa për shpërblim dëmi të **4** masat janë të pa zbatuara.

-Nga **7** masa për eliminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike të rekomanduara, të **7** masat janë të pa zbatuar.

Nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve nga ku niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 35%, edhe pse gjatë auditimit në terren bashkia ka vijuar me zbatueshmërinë e plotë të tyre.

- Në zbatimin e kontratave të punëve publike dhe shërbimeve është evidentuar një efekt financiar në vlerën 37,279 mijë lekë.

- Në llogaritjen e TNI për lejet e ndërtimit është konstatuar llogaritje në kundërshtim me aktet ligjore me mungesë në të ardhurat e bashkisë për vlerën 6,386 mijë lekë.

- Në veprimtarinë e IMTV është evidentuar mos marrje masa për arkëtimin e gjobave të aplikuara për ndërtime pa leje në vlerën 27,900 mijë lekë.

f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe drejtoritë e tjera të Bashkisë Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afatmesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

- Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Himarë) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifikimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

- Bazuar në nenin 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces.

- Drejtoria e Financës Buxhetit, të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **690,180 lekë** ndajë shoqërisë “L ” ShPK, përfituar pa të padrejtë.

- Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin TNI, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, prej **6,386 mijë lekë**.

- Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV, për **59** gjoba me vlerë **27,900,000 lekë**.

- I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Grupi i auditimit auditoi pasqyrat financiare të Bashkisë Himarë, për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve

shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Himarë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit “të modifikuar me rezervë”.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e Raportit Përfundimtar.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë (ISA 700-ISSAI 1700). Gjithashtu, dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë edhe faktin se disa llogari, megjithëse nuk janë krijuar në periudhën ushtrimore të vitit 2022 dhe/ose në këtë periudhë nuk kanë pasur lëvizje në debi ose në kredi, është përgjegjësi e raportuesit për saktësinë dhe vërtetësinë e këtyre llogarive. Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 Dhjetor 2022, i referohen faktit që disa llogari të detyrimeve kreditore dhe të drejtave mbi debitorët, nuk pasqyrojnë gjendjen reale në vlera materiale,-ka llogari të Aktiveve të krijuara në viteve paraardhëse për të cilat, mungon dokumentacioni i nevojshme kontabël e ligjor mbi krijimin dhe përmbajtjen ekonomike të tyre.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë:

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, mbi zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e të ardhurave, mbi menaxhimin e asetëve si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues si dhe. Në opinionin tonë, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Himarë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar të përputhshmërisë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar.

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Në **4** raste të procedurave të prokurimit të zhvilluara në vitin 2022 janë vendosur kritere të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.
- Në **2** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.
- Në **3** raste në procedurat e prokurimit publik janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale **54,996 mijë** lekë.
- Në **6** raste, nga Bashkia Himarë nuk është llogaritur saktë TNI për vlerën **6,386 mijë** lekë.
- Mos marre masa për arkëtimin e gjobën së IMTV të aplikuar për ndërtime të paligjshme në vlerën **27,900 mijë** lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së nr. 874/1 Prot., datë 10.10.2023, i ndryshuar, për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022 si dhe zhvillimin e auditimit “Financiar dhe të Përputhshmërisë” nga data 11.10.2023 deri më datë 31.01.2024 në subjektin Bashkia Himarë, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- R.XH (*përgjegjës grupi*)
- A.T (*anëtarë*)
- E.K (*anëtarë*)
- E.S (*anëtarë*)
- A.B (*anëtarë*)

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Himarë.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 *“Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Himarë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Himarë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Himarë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Himarë, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet

zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Himarë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar je me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Himarë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragraf.44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i

ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr.

1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në F t

materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët*. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320)* trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimit i cili u dërgua në subjekt. Nga ana e Bashkisë **Himarë** me shkresën nr. 315/22, datë 15.4.2024 (*prot KLSH nr. 874/11, datë 18.4.2024*) është dërguar konfirmimi i marrjes së Projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Bashkia Himarë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregullorja dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Himarë.

1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik: Bashkia Himarë bën pjesë në Qarkun e Vlorës. *Zona Gjeografike:* Bashkia e re e Himarë kufizohet në veri me bashkitë Vlorë dhe Selenicë, në lindje me bashkitë Tepelenë, Gjirokastër dhe Delvinë, në jug me bashkinë Sarandë dhe në lindje me detin Jon. Kryeqendra e Bashkisë është Himara.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Himara ka 7818 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 27049 banorë. Me sipërfaqe prej 571.94 km², densiteti i popullsisë në bazë të censurit rezulton vetëm 13.7 banorë/ km² ndërsa sipas regjistrimit civil, densiteti është 47 banorë/ km².

Njësitë administrative përbërëse janë: Himarë, Lukovë dhe Horë Vranisht. Himara dhe Horë-Vranishti i përkasin rrethit Vlorë ndërsa Lukova i përket rrethit Sarandë. Bashkia e re do të ketë nën administrim një qytet dhe 24 fshatra.



2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

2.1. “Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik”

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon;

1.2 Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

1.3 Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

Mjedisi i kontrollit

Në lidhje me parimin 1 *“Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”*

- Bashkia Himarë ka të miratuar një Rregullore të Brendshme për parandalimin e Konfliktit të interesit, respektivisht në nenin 39 janë përfshihen rastet e konfliktit të interesit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, por nuk ka trajnime për këto raste.

-Në nenin 8 të Rregullores së Brendshme, janë përfshirë rregulla e etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Brenda institucionit mungon sistemi mbi menaxhimin dhe kontrollin e burimeve njerëzore, për respektimin e orarit zyrtar të punës.

- Në Rregulloren e Brendshme në nenin 5 janë përcaktuar parimet kryesore, parimi i barazisë, i ligjshmërisë, i ndalimit të konfliktit të interesave, i mbrojtjes së interesit publik, i vazhdimësisë, i transparencës, i ndershmërisë dhe parimi i bashkëpunimit. Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të këtyre parimeve. Nuk ka programe të trajnimit për implementimin e parimeve të mësipërme.

- Kryetari i bashkisë organizon pritje me qytetarët në lidhje me Ankesat, një ditë në javë. Çdo shtetas që do të takojë Kryetarin regjistrohet paraprakisht në njësinë e komunikimit dhe pritjes së qytetarit.

Në lidhje me parimin 2 *“Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”*

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxheriale janë përcaktuar që në rregullore e brendshme dhe veprohet në bazë tij.

- Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë për Titullarin (NA). Mungojnë raportet periodike, ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave “Pyetësorin e vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm” për vitin 2021 me shkresën nr. prot. 249, datë 28.02.2022.

- Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 *“Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”*

- Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA. Bashkia Himarë ka të hartuar Planin e Zhvillimit Strategjik. Në dokumentet e PBA-ve nuk ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve, për të cilat nuk disponohen procesverbale të takimeve të tyre. Po ashtu dhe për organizimet e tryezave të rumbullakëta me palët e treta si grupet e interesit, si dhe për dëgjesa me publikun nuk është mbajtur protokoll i veçantë, pavarësisht se kjo gjë është parashikuar në Rregulloren e brendshme neni 24 “Seancat e këshillimit”. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

- Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin, aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, po vetëm përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës.

- Bashkia Himarë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për këtë njësi vendore.

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performancë.

Në lidhje me parimin 4 *“Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”*

- Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune por nuk janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe F ve përkatëse.

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, ku në Rregulloren e Brendshme nuk përcaktohet procedura që duhet të ndiqet për rekrutimin dhe plotësimin e dosjes, dhe çfarë të dhënash e dokumentacioni duhet të përmbajë dosja e punonjësit. përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin. masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Gjithashtu nga Bashkia Himarë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për F të ndryshme.

- Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë Ekonomike.

Në lidhje me parimin 5 *“Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.*

Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar

Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

Menaxhimi i Riskut

Në lidhje me parimin 6: *Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.*

Bashkia Himarë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva si në planet operationale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe dëgjesa me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”*

Në Bashkinë Himarë nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk ka procedura të brendshme ose evidenca mbi sistemet dhe proceset e menaxhimit të riskut.

Nuk ka identifikim dhe vlerësim të risqeve në bashki në të gjitha nivelet e saj , pra mungon regjistri i riskut. Duke mos u ngritur grupi i menaxhimit të riskut dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë hartuar as planet e veprimit për menaxhimin e riskut.

Në lidhje me parimin 8: *“Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.*

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe funksionimi i tij, por as në Rregulloren e Brendshme nuk është përfshirë si funksion “Koordinatori i Riskut”, ku të përcaktoheshin kushtet që duhet të plotësojë për të qenë një nëpunës koordinator risku, detyrat dhe përgjegjësitë etj.

Referuar këtij komponenti të MFK rezulton se nuk është realizuar. NA nuk ia ka deleguar këtë funksion ndonjë nëpunësi të Aparatit të Bashkisë bashkë me detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë këtij funksioni. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9 pika 3, neni 10, neni 11 pika 2 .

Në lidhje me parimin 9: *“Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.*

Bashkia Himarë në politikën dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga rishikimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

Aktivitetet e Kontrollit

Në lidhje me parimin 10: *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.*

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së procese të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj).

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA)

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

Në lidhje me parimin 11: *“Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”*

- Bashkia Himarë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

Në lidhje me parimin 12: *“Njësi publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.*

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

Informimi dhe komunikimi

Në lidhje me parimin 13: *“Njësia Publike merr gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.*

Drejtuesit në Bashkinë Himarë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Nuk janë hartuar raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit çdo 4-mujor dhe vjetor, me qëllim paraqitjen pranë këshillit bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.

- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo 3 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

Në lidhje me parimin 14: *Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm*

Në lidhje me parimin 15: *Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm*

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në Seksionin Etika dhe Komunikimi Zyrtar, Nenin 6 “Etika dhe kodi i veshjes”, Neni 7 “Komunikimi verbal dhe zyrtar” Nuk është në përdorim emailit zyrtar komunikimi zyrtar mes menaxherëve dhe punonjësve të bashkisë realizohet përveç komunikimit verbal e shkresor si dhe nëpërmjet postës elektronike personale.

Nga bashkia Himarë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të parashikuara dhe në rregulloren e brendshme, por mungon dokumenti i evidentimit të konsultimit publik të kryer.

Monitorimi

Në lidhje me parimin 16: *“Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.*

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë Impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit

të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Në Bashkinë Himarë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

- Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultojnë se nuk janë realizuar.

- Në Bashkinë Himarë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

- Një nga drejtimit e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi nuk është ngritur si strukturë, duke sjellë mundësinë e një elementi që luan rol të rëndësishëm në funksionin e monitorimit e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm .

Në lidhje me parimin 17: *“Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”*.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo të në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenet 8, 16, 22, 23, 24.

II.2.2. “Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit”

Në zbatim të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Situacioni i shpenzimeve rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave rakorduar me Degën e Thesarit’;
- PBA dhe buxheti vjetor;
- Raportet e monitorimit;
- Vendimet e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Gramsh”;
- Vendime të tjera të Këshillit Bashkiak, në lidhje me ndryshimet buxhetore, etj...

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2022

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2022- 2024 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 31 datë 25.06.2021.

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Kategoria	Burimi	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
Të Ardhura Nga Burimet E Veta	Të Ardhura Nga Taksat Lokale	156,500	123,494	304,748	258,500	280,243	304,263
	Të Ardhura Nga Taksat E Ndara	6,000	6,000	7,000	10,400	10,658	10,975
	Të Ardhura Nga Tarifa Vendore	89,900	64,601	122,300	174,401	189,642	206,173
	Të Ardhurat E Tjera	27,500	17,215	39,000	39,000	40,500	42,500
Të Ardhura Nga Buxheti Qendror	Transferta E Pakushtëzuar	115,736	118,403	135,771	124,998	193,000	205,000
	Transferta E Kushtëzuar	67,000	89,754	52,114	59,264	81,000	82,000
	Transferta Specifike	48,229	49,064	3,087	0	6,000	8,000
Trashëgimi Nga Viti I Shkuar	Trashëgimi Pa Destinacion	70,000	88,074	297,396	596,901	0	0
	Trashëgimi Me Destinacion	40,000	93,810	0	0	0	0
Të Ardhurat Totale		620,865	650,415	961,416	1,263,464	801,043	858,911

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2022-2024 është bërë me VKB nr. 31, datë 25.06.2021, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37. Për vitin 2022, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 62 datë 23/12/2021, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Vlorë me shkresën nr.643/1 date 20.07.2022.

Në këtë VKB, të ardhurat të trashëguara nga 2021 janë në vlerën 596,900,563 lekë, nga debitorë të prapambetur janë në vlerën 25,000,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 124,998,000 lekë si dhe nga granti i pakushtëzuar në vlerën 59,264,173 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 1,263,462,736 lekë.

Gjatë vitit 2022, Bashkia Himarë me VKB nr. 14, datë 30.03.2022 ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2021) me VKB nr. 35, datë 05.07.2022.

Buxheti i miratuar për vitin 2022 është 1,263,462,736 lekë me burime financimi si me poshtë:

- Të ardhurat e veta 1,054,200,563 lekë, (83.4%) të totalit të burimeve
- Të ardhurat nga debitor të prapambetur 25,000,000 lekë, (1.9%) të totalit të burimeve
- Transfertat e pakushtëzuar 124,998,000 lekë (9.8%) të totalit
- Grant i pakushtëzuar 59,263,143 lekë (4.6%) të totalit

Buxheti i miratuar është dërguar në Degën e Thesarit brenda afatit ligjor.

Më të detajuar burimet dhe shpenzimet e planifikuara paraqiten në tabelën si vijon:

në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022 ne leke	
		Ardhurat	Shpenzimet
1	Të ardhura të trashëguara viti 2021/2022	596,900	0
2	Plani i të ardhurave viti 2022	457,300	0
3	Transfertat e pakushtëzuar viti 2022	124,998	0
4	Të ardhura nga debitor të prapambetur	25,000	
5	Grant i pakushtëzuar sektorial viti 2022	59,264	0
1	Paga (600) , sigurime shoqërore (601)	0	151,000
2	Shpenzime operative (602)	0	256,984
3	Transferta (603+604)	0	7,573
4	Investime (230 +231)	0	608,000
5	Fonde		32,823
6	Detyrime		235,354
	Totali i buxhetit	1,263,462	1,291,734

Për sa më sipër nga Grupi i Auditimit u konstatua që nga ana e Bashkisë Himarë është planifikuar më shumë shpenzime sesa të ardhura.

Më poshtë pasqyra përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 sipas VKB përkatëse në lekë

në mijë lekë

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr 62 Datë 23.12.2021	Buxheti shtesë miratuar me VKB nr. 14 date 30.03.2022	Ndryshime Buxhetore Qershor 2022 VKB Nr 35 Dt 05.07.2022	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr 62 Datë 23.12.2021	Buxheti shtesë miratuar me VKB nr. 14 date 30.03.2022	Ndryshime Buxhetore Qershor 2022 VKB Nr 35 Dt 05.07.2022
	1	2	3		1	2	3
Të Ardhurat nga Taksat viti 2022	268,900	329,612	362,147	Art. 600 Paga & 601 Sig Shoqërore	151,000	156,500	156,500
Të Ardhurat nga tarifrat viti 2022	177,400	177,400	177,400	Art.602 Shpenzime operative	256,984	280,999	302,892
Te ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qera	11,000	11,000	11,000	Art.603 Subvencione	3,000	3,000	3,000
Të Ardhura nga debitore te prapambetur	25,000	25,000	25,000	Art.604 Transferime korrente të brendshme	4,573	4,903	4,903
Totali i te ardhurave te Veta	482,300	543,012	575,547	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë			
Te ardhura te trashëguara nga 2021	596,900,	584,160,	584,160	Art. 230-231 Investime	608,000	836,234	846,876
Te ardhura nga transferta e pakushtezuar e përgjithshme	124,998	124,998	124,998	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	32,823	27,324	27,324
Te ardhura nga granti I pakushtezuar sektorial	59,264	56,790	56,790	Detyrime	235,354		
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	781,162	765,948,567	765,948				
TOTALI TE ARDHURAVE	1,263,462	1,308,961	1,341,496	Totali shpenzimeve	1,291,734	1,308,961	1,341,496

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e më poshtme:

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Art. 600 Paga & 601 Sig Shoqërore	156,500	151,000	5,500
2	Art.602 Shpenzime operative	302,892	295,259	7,633
3	Art.603 Subvencione	3,000	3,000	0
4	Art.604 Transferime korrente të brendshme	4,903	4,573	330
5	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë		5,500	-5,500
6	Art. 230-231 Investime	846,876	776,807	70,069
7	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	27,324	27,324	0
	Gjithsej	1,341,496	1,263,463	78,033

Burimi: Drejtoria e financës

Nga auditimi konstatohet se:

- Nga krahasimi i planit përfundimtar të vitit 2022 me atë të PBA-së 2022-2024, do shikojmë se ulje të planit përfundimtar në vlerën 78,033 mijë lekë respektivisht: vlera në ulje 5,500 mijë lekë i përket shpenzimeve për paga; vlera në ulje 7,633 mijë lekë i përket shpenzimeve operative dhe transfertat , vlera në ulje 330 mijë lekë i përket transferimeve korrente te brendshme, vlerë në ulje 70,069 mijë lekë i përket investimeve ndërsa vlera në rritje 5,500 mijë lekë i përket transferimeve

të buxhetit familjar dhe individë.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar.

- Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2022, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Himarë, për vitin 2022. Në lekë								
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Nga të ardhurat e veta	Burimi i financimit të shpenzimit		
						% e realizimit nga të ardhurat e veta	Nga transfertat e pakushtëzuar & PK	% e realizimit nga Transfertat e kushtez dhe PK
1	Art. 600 Paga	127,825	109,436	86%	34,247	31%	75,189	69%
2	Art. 601 Sig Shoqerore dhe Shëndetësore	23,174	18,251	79%	5,736	31%	12,515	69%
3	Art.602 Shpenzime operative	297,892	158,988	53%	154,338	97%	4,650	3%
4	Art.603 Subvencione	28,089	3,000	11%	3,000	100%	0	0%
5	Art.604 Transferime korrente të brendshme	4,903	4,860	99%	4,860	100%	0	0%
6	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	5,500	3,855	70%	3,855	100%	0	0%
7	Art. 230-231 Investime	827,787	240,407	29%	184,311	77%	56,095	23%
8	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	26,323	1,134	4%	1,134	100%	0	0%
	Totali	1,341,496	539,935	40%	391,484	73%	148,450	27%

Burimi: Bashkia Himarë

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transfertat e pakushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **1,341,496 mijë lekë**, ndërsa realizimi **539,935 mijë lekë**, ose në masën 40%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **127,825 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **109,436 mijë lekë**, ose në masën 86%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 79%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **297,892 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **158,988 mijë lekë**, ose në masën 53%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **827,787 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **240,407 mijë lekë**, ose në masën 29%.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Himarë ka diferencë me vlerën e planifikuar.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara , i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **827,787 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **240,407 mijë lekë**, ose në masën 29 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Himarë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Neni 46 “Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Nënpika 2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifat, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Nga auditimi mbi administrimin e taksave e tarifave vendore në Bashkinë Himarë, rezulton se: Plani i të ardhurave është realizuar në masën 110 %, ku nga vlera 550,547 mijë lekë e parashikuara është arkëtuar vlera prej 608,652 mijë lekë, me një diferencë në plus prej 58,105 mijë lekë. Ndikim në këtë realizim ka dhënë TNI e cila nuk është planifikuar saktë, pasi nga vlera e parashikuar prej 290,247 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 348,670 mijë lekë, duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 me vlerë 331,102 mijë lekë, sipas Aneksit 3 bashkëlidhur PRA.

Burimi i krutit të të ardhurave është nga taksat e tarifat vendore që kjo njësi arkëton nga subjekte fizik/juridik dhe abonentë familjarë.

Të ardhurat e arkëtuara bashkia Himarë në vlerën 391,484 mijë lekë i con për kryerjen e shpenzimeve të ndryshme, e cila zë 72.5% e totalit të shpenzimeve vjetore, pasqyra:

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Himarë, për vitin 2022. Në lekë								
Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Nga të ardhurat e veta	Burimi i financimit të shpenzimit		
						% e realizimit nga të ardhurat e veta	Nga transfertat e pakushtëzuar & PK	% e realizimit nga Transfertat e kushtez dhe PK
1	Art. 600 Paga	127,825	109,436	86%	34,247	31%	75,189	69%
2	Art. 601 Sig Shoqerore dhe Shëndetësore	23,174	18,251	79%	5,736	31%	12,515	69%
3	Art.602 Shpenzime operative	297,892	158,988	53%	154,338	97%	4,650	3%
4	Art.603 Subvencione	28,089	3,000	11%	3,000	100%	0	0%
5	Art.604 Transferime korrente të brendshme	4,903	4,860	99%	4,860	100%	0	0%

6	Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	5,500	3,855	70%	3,855	100%	0	0%
7	Art. 230-231 Investime	827,787	240,407	29%	184,311	77%	56,095	23%
8	Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)	26,323	1,134	4%	1,134	100%	0	0%
	Totali	1,341,496	539,935	40%	391,484	73%	148,450	27%

Në lidhje me detyrimet e paarkëtuara deri më 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë paraqitet në shumën 246,517,068 lekë për 3154 subjekte/abonentë, nga e cila: *për subjektet fizik/juridik në vlerën 193,521,676 lekë për 989 subjekte dhe abonentë familjarë për vlerën 52,995,392 lekë për 2165 abonentë.*

Në krahasim me fundin e vitit 2021, totali i detyrimeve të paarkëtuara është rritur për vlerën 79,284,260 lekë, nga e cila: *për subjekte fizik/juridik në vlerën 69,810,163 lekë dhe për abonentë familjarë në vlerën 9,474,097 lekë.*

Referuar të dhënave të mësipërme si dhe dokumentacionit, nga Drejtoria e Taksave Vendore për arkëtimin e tyre është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve, duke mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër deri në kallëzim penal, gjë e cila konstatohet dhe nga vlera e lartë e detyrimeve për subjektet fizik/juridik të cilët megjithëse ushtrojnë aktivitet nga viti në tjetrin vlera e detyrimeve vjen në rritje, duke mos marrë asnjë masë për arkëtim, ku vetëm për subjektet mbi 1 milionë lekë detyrime janë 38 subjekte me vlerë 59,637 mijë lekë sipas Aneksit 1, bashkëlidhur RPA.

Gjithashtu konstatohet dhe fakti se Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizime si agjent tatimorë për arkëtimin e detyrimeve të abonentëve familjarë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të arkëtuara të cilat nuk janë xhiruar në Bashkinë Himarë, kjo për vlerën **20,024 mijë lekë**, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur RPA.

II.2.3. “Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi”

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- *Pasqyrat financiare të vitit 2022 të shoqëruar me formatet 1-9.*
- *Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.*
- *Dokumentacioni i kryerjes së inventarëve të aktiveve 2022, libri i aktiveve.*
- *Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2022*
- *Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “Excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet te ardhurat etj.).*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- *Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:*

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Himarë” për hartimin e Pasqyrave Financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

- Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara

Bashkia Himarë për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Himarë pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

- Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Vlorë për vitin ushtrimor 2022 ku janë konfirmuar me datë 31.03.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Himarë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë

kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësive ekonomike.

- *Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare*

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik – financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; (Tab. nr.1 Pasqyra e pozicioni financiar, Aneks)

Totali i Aktivit për vitin 2021 është në vlerën **3,540,265,418** lekë dhe për vitin 2022 është **3,540,265,418** lekë , i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

- **AKTIVE AFATSHKURTRA.**

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 46,136,181 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 373,624,132 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” .

Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 135,837,799 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 114,261,352 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, por nuk rakordon me rubrikën analoge “Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022” të paraqitur në Aneks. (Tab. nr.2 Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022)

Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar” sipas bilancit në mbyllje të në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën **373,624,132** lekë, e cila rakordon me gjendjen në rubrikën analoge “Tepicën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **373,624,132** lekë në Formatin nr.3 “Pasqyrë e flukseve monetare viti 2022” në përputhje me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5, datë 21.02.2022, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **15,255,772 lekë** dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **15,854,363 lekë**, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej **598,591 lekë** rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive: si vijon:

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 371,009,876 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 375,937,330 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i mos kryerjes se pagesave të debitorëve.

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 287,712,000 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 298,977,495 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 11,265,495 lekë e cila vjen si mos arkëtimin në kohë të debitorëve, etj. Analiza e gjendjes së llog. 468“Debitorë të ndryshëm “dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

-Gjendja e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin, të drejta” (debitorë) më 31.12.2022 paraqitet në vlerën 76,959,835 lekë.

- AKTIVE AFATGJATA MATERIALE.

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale,** u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si dhe u verifikuan:

- Tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- Tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale;**
- Të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- Nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konformë parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- Nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- Investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,105,984,738 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 26,546,525,816 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 25,568,354,854 lekë, për të cilat nuk ka një rakordim midis tyre.

Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Në lekë

NJESIA PUBLIKE		BASHKIA HIMARE			Pasqyre Aneks Statistike							
		GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA (VLERA NETO)			Formati nr. 7/b NE / LEKE							
Nr. Rrjesht	Nr. Referenca Llogaria	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shesht gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/O MATERIALE	122,092,960	90,542,854	31,550,106	60,594,348	13,821,668	0	-	182,687,308	104,364,522	78,322,786
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-
3	202	Studime dhe kerkime	122,092,960	90,542,854	31,550,106	60,594,348	13,821,668	0	-	182,687,308	104,364,522	78,322,786
4	203	Koncesione, palenta, licenca e tjera ngjashme	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-
5	21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	2,223,960,854	709,414,639	1,514,546,215	23,378,193,730	114,318,995	216,487,038	215,849,597	25,385,667,546	607,884,037	24,777,783,509
6	210	Toka,troje,Terene	28,563,121	-	28,563,121	22,592,302,057	-	-	-	22,620,865,178	0	22,620,865,178
7	211	Pyje,Kullota Pllantacione	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-
8	212	Ndertime e Konstruksione	1,043,693,693	313,901,077	729,792,616	645,242,295	68,751,746	160,720,633	160,720,633	1,528,215,355	221,932,190	1,306,283,165
9	213	Rruges,rjete,vepra ujore	799,475,042	332,738,625	466,736,417	116,047,340	29,139,188	-	-	915,522,382	361,877,813	553,644,569
10	214	Instalime teknike,makineri,pajse,vegja pune	13,878,553	7,645,972	6,232,581	9,868,800	3,220,276	-	-	23,747,353	10,866,248	12,881,105
11	215	Mjete transporti	59,462,084	27,008,266	32,453,818	12,586,261	8,880,528	27,645,706	27,008,266	44,402,639	8,880,528	35,522,110
12	216	Rezerva shtetore	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-
13	217	Kafshe pune e prodhimi	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-
14	218	Inventar ekonomik	47,610,011	28,120,699	19,489,313	2,146,977	4,327,257	28,120,699	28,120,699	21,636,289	4,327,257	17,309,032
15	24	Aktive te Qend te trupezuara te demtuara	-	-	-	-	-	-	-	-	0	-
16	28	Caktime	231,278,350	-	231,278,350	-	-	-	-	231,278,350	-	231,278,350
17		TOTAL I (I+ II)	2,346,053,814	799,957,493	1,546,096,321	23,438,788,078	128,140,663	216,487,038	215,849,597	25,568,354,854	712,248,588	24,856,106,296

PASIVET

Pasivet afatshkurtra

Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **3,540,265,418** lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën **27,389,967,118** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikjuara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 62,449,493 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë.

Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 0 lekë.

Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 458,998 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhet në janar të vitit 2023.

Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 2,460,554 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhet në janar të vitit 2023.

Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”, në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 336,840 lekë, sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhet në janar të vitit 2023.

Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 46,136,181 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 52,480,267 lekë.

Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për zhblokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022 paraqitet më poshtë. (Tab. nr.4 Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2022, Aneks).

II.2.4. “Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve”.

Bashkia Himarë bazuar në regjistrin e realizimeve, vënë në dispozicion grupit të auditimit si dhe verifikimit në Sistemin e Prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, për gjatë vitit 2022 ka realizuar **45** procedura prokurimi me fond limit **640,770,071 lekë**, nga të cilat: **1 (një) procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar me vlerë 337,808,187 lekë, 8 procedurë e hapur me vlerë 16,550,000 lekë, 24 procedurë e hapur e thjeshtuar me vlerë 149,621,583 lekë dhe 12 prokurime me vlerë të vogël 106,636,198 lekë pa TVSH.**

Bazuar në një analizë rrisht dhe në metodat e përzgjedhjes për auditim të procedurave të prokuruar janë vlerësuar për auditim 5 procedura me vlerë të fondit limit prej 411,338,128 lekë ose 64.1% e totalit të procedurave të prokuruar, si vijon:

- Procedura “Rikonstruksioni i Sallës Polifunkionale të Bashkisë”

Me anë të Memos nr.3197 prot., datë 01.07.2022, të sektorit të prokurimeve dhe procedurave administrative të drejtorisë juridike ka filluar procedura e prokurimit me objekt “**Rikonstruksioni dhe rinovimi i sallës polifunkionale të bashkisë**”, me fond limit **66,666,667 lekë** pa TVSH.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksioni dhe rinovimi i sallës polifunkionale të bashkisë” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.197, datë 01.07.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”	2. Njësia e Prokurimit Znj.K.M Z.O.V Z. E.SH	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: G.S A.G
4. Fondi limit (pa TVSH): 66 666 667 lekë pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë Himarë	6. Data e hapjes së tenderit 24.11.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: “L” SHPK me NIPT: K...I “E” SHPK me NIPT: K...I BOE “K” SHPK me NIPT: K...G & “A” ” SHPK NIPT: K...Ë “D” SHPK me NIPT: K...Q b) Kualifikuar: “L” SHPK me NIPT: K...I	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdh. Nr. 198 dt. 01.07.2022 Z. U.D Kryetar Znj.B.R Anëtar Z. A.G Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh) 66 344 444 lekë pa TVSH

10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë sipërmarrje 3197/19 datë 07.12.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 322 223 lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : S.K	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës Nga lidhja e kontratës deri më 06.06.2022
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi Nr. 1 datë 23.02.2023 , 20 593 164 lekë me TVSH Nr. 2 datë 31 .05.2023, 41 140 683,84 lekë me TVSH Nr. 3 datë 14.06.2023, 17 879 103 lekë me TVSH		

Hartimi i dokumenteve standarde nga Njësia e Prokurimit

Më datë, 15.07.2022, Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhër nr.197, datë 01.07.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, u hap procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, Punë” me objekt: *“Rikonstruksioni i sallës Polifunksionale të Bashkisë”*

Nga Njësia e Prokurimit, në Bashkinë Himarë, është mbajtur procesverbali nr. 3197/ 9, datë 15.07.2022 nga Njësia e Prokurimit, me qëllim hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, Punë” me objekt: *“Rikonstruksioni i sallës Polifunksionale të Bashkisë”*, me fond limit **66,666,667** leke pa TVSH, në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit është bërë miratimi dhe argumentimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderit .

Në adresën e e-mailit të AK nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve/enteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit të shpallura në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) ka ardhur një e-mail me disa rekomandime për procedurën e prokurimit.

Në zbatim të nenin 23 dhe nenin 75 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 78 pika 3 të Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në kuadër të asistencës së ofruar nga APP me qëllim sigurimin e mirë zbatimit të legjislacionit të prokurimit publik, Njësia e Prokurimit ka vendosur të ndryshojë/ modifikojë dokumentet standarde të kësaj procedure.

Më datë 09.09.2022, është ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) “Njoftimi për ndryshimin e dokumenteve të tenderit”.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhër Nr.198, datë 01.07.2022, ka mbajtur procesverbalin nr.3197/15 , date 16.09.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave.

Kanë paraqitur ofertën në formë elektronike operatorët ekonomikë:

“L ” sh.p.k me NIPT: K...I, me vlerë 66,344,444 lekë pa TVSH;

“E ” sh.p.k me NIPT: K...I, me vlerë 57,601,712 lekë pa TVSH;

BOE “K ” sh.p.k me NIPT: K...G & “A ” sh.p.k me NIPT: K...Ë me vlerë 55,990,862 lekë pa TVSH;

“D ” sh.p.k me NIPT K...Q me vlerë 0 (zero) lekë pa TVSH.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.198, datë 01.07.2022 , ka mbajtur procesverbalin nr.3197/16 , date 16.09.2022, për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur , Punë ”.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorit ekonomik konkludoi se:

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “L ” sh.p.k me NIPT: K...I, me vlerë 66 344 444 lekë pa TVSH, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit. Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “E ” sh.p.k me NIPT: K...I, me vlerë 57 601 712 lekë pa TVSH, nuk është vijuar të vlerësohet nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave për arsye se operatori ekonomik ka paraqitur kerkese per terheqje nga procedura e prokurimit.

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE “K ” sh.p.k me NIPT: K...G & “A ” sh.p.k me NIPT: K...Ë, me vlerë 55 990 862 lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, për arsyet si më poshtë:

-Nuk plotëson kriterin 2.3.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- 1.Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi 18 ton, 1 copë në pronësi ose me qera*
- 2.Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes dhe transportues mbi 10 ton, 2 cope pronësi ose me qera*
- 3.Kamionçine me kapacitet mbajtes 1-3 ton, 2 copë në pronësi ose me qera*
- 4.Autovinc peshe ngritese jo me pak se 5 ton, 1 copë në pronësi ose me qera*
- 5.Vibrator betony 2 copë në pronësi ose me qera*
- 6. Depozite uji 5000 lit. 1 copë në pronësi ose me qera*
- 7. Moto/Gjenerator 1 copë në pronësi ose me qera*
- 8. Saldatrice 1 copë pronësi ose me qera*
- 9. Skela 2000m2 në pronësi ose me qera*
- 10. Kompresor 1 copë pronësi ose me qera*
- 11. Betoniere kantieri 2 copë pronësi ose me qera*
- 12. Aparature per bashkim tubash dhe nyjesh me electrofusion, 2 copë në pronësi ose me qera*

Operatori ekonomik “ K ” SHPK, nuk ka provuar disponimin e numrit të mjeteve në përputhje me përqindjen e marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Nuk plotëson kriterin 2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose Autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për materialet e zerit te punimeve si me poshte:

- 1.Materiale gipsi dhe profile*
- 2.Materiale elektrike, kabuj*
- 3.Fan Coil*
- 4.Meriale hidraulike, hidrosanitare,*
- 5.Mobilimi*
- 6.Materiale duro alumini (dyer, dritare)*
- 7.Boje, pllaka, kolle,*
- 8.Sistemet ngrohje ftohje*

Se bashku me autorizimet Operatori Ekonomik duhet te paraqese dhe kataloget perkatese me specifimet teknike perkatese, shoqeruar me Ison 9001:2015 te prodhuesit.

Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk është sipas kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit.

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “D ” SHPK , me vlerë 0 (zero) , nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, për arsyet si më poshtë: Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Formularin e Ofertes Ekonomike dhe dokumentacionin shoqerues per te provuar plotesimin e dokumenteve standarte te tenderit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri klasifikimin e ofertuesve si më poshtë:

“L ” sh.p.k me NIPT: K...I, me vlerë 66,344,444 lekë pa TVSH;

Sa më sipër ky proces-verbal është mbajtur në 2 (dy) kopje dhe është nënshkruar nga anëtarët.

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 24.11.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të mësipërm u konstatua:

Në lidhje me tërheqjen e operatorit “E ” SHPK, Bashkia Himarë **nuk ka kryer** procedurën për tërheqjen e garancisë të depozituar nga OE me vlerë 1,333,333 lekë pa TVSH “Formulari i sigurimit të ofertës”. Vlera e mësipërme konsiderohet dëm i shkaktuar në buxhetin e Bashkisë Himarë.

Në lidhje me kriterin 2.4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për materialet e zërit të punimeve si me poshtë:

- 1.Materiale gipsi dhe profile
- 2.Materiale elektrike, kabuj
- 3.Fan Coil
- 4.Meriale hidraulike, hidrosanitare,
- 5.Mobilimi
- 6.Materiale duro alumini (dyer, dritare)
- 7.Boje, pllaka, kolle,
- 8.Sistemet ngrohje ftohje, kritere të cilat janë të ekzagjeruara për objektin e kontratës pasi janë produkte të larmishme dhe duke u bazuar në objektin e kontratës, produktet e caktuara janë për përdorim/përpunim dhe jo për tregtim.

Këto kritere nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe dhe pikës 2 të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.”

Zbatimi i Kontratës.

Gjatë auditimit të zbatimit të kontratës, gjatë verifikimit në terren u konstatua:

- Problematika të konstatuara në lidhje me shtrimin e moketit e cila nuk ishte e vënë në mënyrë të rregullt, dhe jo në përputhje me specifikimet teknike. (foto ilustruese)
- Problematika të konstatuara në lidhje me Bokset modulare, ku mungojnë 2 nga 4 bokset që duhet të ishin instaluar. Dëmi i shkaktuar përllëgaritet në vlerën 2*150,000 lekë= 300,000 lekë pa TVSH.
- Problematika të konstatuara në vendosjen e dritaret doppio xham, ku u konstatua që dritarja nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST, si dhe është me një xham, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Bashkisë Himarë në vlerën 4m2*25,000 lekë = 100,000 lekë pa TVSH. (Foto Ilustruese)
- Problematika të konstatuara në lidhje me spotet e ndriçimit, Spot Led Horizontal, ku mungojnë 4 spote* 55,000 lekë= 220,000 lekë pa TVSH.

- Problematika të konstatuara në lidhje me shtresat e pllakave të mermerit $11.68m^2 - 5.3m^2$ (që ishin shtruar) = $6.38m^2 * 11,000 \text{ lekë}/m^2 = 70,180 \text{ lekë}$ pa TVSH. (Foto Ilustruese)
- Problematika të konstatuara në lidhje me veshjen e murit e cila nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST, ku dallohet qartë që veshja e murit nuk është e llojit “Dru”, por e një lloji materiale tjetër. (Foto Ilustruese)
- Problematika të konstatuara në ndërtim shkalle druri, ku veshja e të cilit është jashtë përdorimit dhe nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST. (Foto Ilustruese)

• **“Ndërtimi i Kompleksit Sportiv Rajonal Borsh”**

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Memos nr.3133/1 prot., datë 30.06.2022, të sektorit të prokurimeve dhe procedurave administrative të drejtorisë juridike ka filluar procedura e prokurimit me objekt **“Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh”**, me fond limit **40.000.000** (dyzet milion) lekë pa TVSH.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.194, datë 30.06.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur”	2. Njësia e Prokurimit Znj.K.M Z.T.D Z. E.SH	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: S.K
4. Fondi limit (pa TVSH): 40 000 000 lekë pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i shtetit	6. Data e hapjes së tenderit 04.07.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: BO “C ” sh.p.k dhe “A ” 34.033.033 lekë pa TVSH BO “J ” sh.p.k dhe “G ” 39.464.714 lekë pa TVSH OE “J ” sh.p.k 34.491.250 lekë pa TVSH OE “M ” sh.p.k 0 leke pa TVSH OE “S ” sh.p.k 36.798.026 lekë pa TVSH b) Kualifikuar: BO “C ” sh.p.k dhe “A ” 34.033.033 lekë pa TVSH BO “J ” sh.p.k dhe “G ” 39.464.714 lekë pa TVSH OE “J ” sh.p.k 34.491.250 lekë pa TVSH OE “S ” sh.p.k 36.798.026 lekë pa TVSH	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.195 Prot. 3133/3 datë 30.06.2022 Z.D.B Kryetar Znj.B.R Anëtar Z.A.B Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 34.033.033 lekë pa TVSH
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë sipërmarrje 3133/19 datë 28.09.2022	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 5.966.967 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : S.K	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës 9 muaj
16.Situacioni përfundimtar/Faturë malli/ shërbimi		

Hartimi i dokumenteve standarde nga Njësia e Prokurimit

Më datë, 04.07.2022, Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhër nr.194, datë 30.06.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, u hap procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, Punë” me objekt: *“Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal, Borsh”*.

Në 04.07.2022, në Bashkinë Himarë, është mbajtur procesverbali nr.3133/10, datë 04.07.2022, nga Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhër nr.194, datë 30.06.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me qëllim hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, Punë” me objekt: “Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal, Borsh”, me fond limit 40.000.000 (dyzet milion) lekë pa TVSH, në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit është bërë miratimi dhe argumentimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderit.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr. 195, datë 30.06.2022, mbajti procesverbalin nr. 3133/15 prot., date 08.08.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, Punë ” me objekt: **“Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal, Borsh”** me fond limit 40.000.000 (dyzet milion) lekë pa TVSH.

Në procedurën e hapjes së ofertave, ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave përbërë nga: kryetari D.B dhe anëtarët A.B dhe B.RR .

Në këtë procedurë prokurimi, të zhvilluar më datë 08.08.2022, kanë qenë pjesëmarrës pesë O.E: BOE “C ” ShPK me NIPT: J...K & “A ” me NIPT: K...P me ofrtë **34.033.033** lekë pa TVSH.

BOE “J ” ShPK me NIPT: J...K & “G ” me NIPT: K...A me ofertë **39.464.714** lekë pa TVSH. OE “J ” ShPK me NIPT: J...M me ofertë **34.491.250** lekë pa TVSH.

OE “M ” ShPK me NIPT: J...K me ofertë 0 (zero) lekë pa TVSH.

OE “S ” ShPK me NIPT: K...H me ofertë **36.798.026** lekë pa TVSH.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin e Nr. 195, datë 30.06.2022, më date 10.08.2022, mbajti procesverbalin nr.3133/16, date 10.08.2022, për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, Punë ” me objekt: **“Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal, Borsh”** me fond limit 40.000.000 (dyzet milion) lekë pa TVSH.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorit ekonomik konkludoi se:

Oferta e paraqitur nga BO “C ” SHPK me NIPT: J...K & “A ” me NIPT: K...P, me vlerë 34.033.033 lekë pa TVSH, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativ – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga BO “J ” SHPK me NIPT: J...K & “G ” me NIPT: K...A, me vlerë 39.464.714 lekë pa TVSH, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativ – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE “J ” SHPK me NIPT: J...M, me vlerë 34.491.250 lekë pa TVSH, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë

23.12.2020 "Për prokurimin publik", për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE "S" SHPK me NIPT: K...H, me vlerë 36.798.026 lekë pa TVSH, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga OE "M" SHPK me NIPT: J...K, me vlerë 0 (zero) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur formularin e ofertës ekonomike dhe dokumentacionin shoqërues për të vërtetuar plotësimin e kriterëve të dokumenteve standarte të tenderit, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri klasifikimin e ofertuesve si më poshtë:

BO "C" SHPK me NIPT: J...K & "A" me NIPT: K...P me ofrtë 34,033,033 lekë pa TVSH.

BO "J" SHPK me NIPT: J...K & "G" me NIPT: K...A me ofertë 39,464,714 lekë pa TVSH.

OE "J" SHPK me NIPT: J...M me ofertë 34,491,250 lekë pa TVSH.

OE "S" SHPK me NIPT: K...H me ofertë 36,798,026 lekë pa TVSH.

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, më datë 29.08.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

KVO mbajti procesverbalin nr.3133/16, date 10.08.2022, nga 4 O.E pjesëmarrës në procedurë, ka kualifikuar BO "C" SHPK me NIPT: J...K & "A" me NIPT: K...P me ofertë 34,033,033 lekë pa TVSH. si ofertë të suksesshme. Kjo ofertë rezulton edhe oferta ekonomike me e ulët.

Për sa më sipër u konstatua:

Në lidhje me mjetet e transportit, BO fitues "C" SHPK me NIPT: J...K & "A" me NIPT: K...P, nuk i është përmbajtur specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të dhëna në DST, pasi për mjetet në fjalë është sjellë vetëm kontrata e shitjes dhe dokumentacioni i zhdoganimit, i cili nuk dallohet qartë pasi janë dokumente të vjetra. Gjithashtu nuk janë deklaruar dhe foto të mjeteve, në mospërputhje me kriterit 2.3.7 të DST ku cilësohet :

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit për të tretë (e vlefshme).
- c) Për mjetet e deklaruara që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsakur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes..
- e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme nenje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

Procedura është në shkelje të akteve ligjore për shpalljen fitues të BO “C” & “A” SHPK, në këto kushte KVO duhet të vijonte me OE e tjerë në garë, duke ngakuar me përgjegjësi anëtarët e KVO.

• **“Sistemimi Rrugëve të Fshatit Kuç”.**

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Memos nr.4375/1 prot., datë 28.09.2022, të sektorit të prokurimeve dhe procedurave administrative të drejtorisë juridike ka fillura procedura e prokurimit me objekt **“Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç”**, me fond limit **6,666,667** lekë pa TVSH.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.279, datë 28.09.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”	2. Njësia e Prokurimit Znj.K.M Z.O.V Z. E.SH	3. Komisioni për Përlogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: “E” SHPK
4. Fondi limit (pa TVSH): 6,666,667 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë Himarë	6. Data e hapjes së tenderit 30.09.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: “A” SHPK K...C b) Kualifikuar: “A” SHPK K...C	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër Nr.280 datë 28.09.2022 Z. A.G Kryetar Znj. B.R Anëtar Z. U.D Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 6.081.431.50
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë sipërmarrje nr.716 datë 10.02.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 585.235,5 lekë	12. Ankimime S’ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : S.K	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës Nga lidhja e kontratës deri më 15.04.2023

Nga auditimi i procedurës së prokurimit të mësipërm u konstatua:

Hartimi i dokumenteve standarte nga Njësia e Prokurimit

Më datë, 29.09.2022, Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhër nr.279 , datë 28.09.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, u hap procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Punë” me objekt: **“Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç”**.

Më 29.09.2022, në Bashkinë Himarë, ka mbajtur procesverbali nr.4375/10 , datë 29.09.2022, nga Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhër nr.279, datë 28.09.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me qëllim hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar, Punë” me objekt: “Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç”, me fond limit **6,666,667 lekë pa TVSH** , në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit është bërë miratimi dhe argumentimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderit.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.280 , datë 28.09.2022, ka mbajtur procesverbalin nr.4375/15, datë 17.10.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit.

Në procedurën e hapjes së ofertave ,ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave përbërë nga: kryetari A.G dhe anëtarët U.D dhe B.RR .

Ka paraqitur ofertë në formë elektronike operatorit ekonomik:

“A ” SHPK me NIPT K...C oferta ekonomike 6,081,431.5 lekë pa TVSH.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.280, datë 28.09.2022 , ka mbajtur këtë procesverbalin nr.4375/16, date 07.11.2022, për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit.

Në procedurën e shqyrtimit të ofertave , ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave përbërë nga: kryetari A.G dhe anëtarët U.D dhe B.RR .

Kanë paraqitur ofertën në formë elektronike vetëm një operator ekonomikë:

“A ” SHPK me NIPT K...C

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorit ekonomik konkludoi se:

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “A ” SHPK, me vlerë 6,081,431.5 lekë pa TVSH , është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri klasifikimin e ofertuesve si më poshtë:

“A ” sh.p.k me NIPT K...C me vlerë 6,081,431.5 lekë pa TVSH.

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit.

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 05.12.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

Në lidhje me përmbushjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike nga O.E. fitues, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të sjellë nga O.E. u konstatua që O.E. “A”, **nuk i është përmbajtur kriterëve të kërkuara në DST**, pasi për kapacitetet teknike të kërkuara është mjaftuar vetëm me sjelljen e deklaratave të përmbushjes së tyre në mospërputhje me kriterin nr. 2.3.8. (makineri, pajisje) ku citohet :

“Për vërtetimin e disponimit të makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, të paraqiten:

- a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit duhet të shoqërohet me kontratën perkatese materiale të qerave, ku te jete percaktuar objekti i prokurimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Makinat e transportit te shoqerohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit te Mallrave (te vlefshme), leshuar nga organet kompetente ne emer te shoqerise apo subjektit pronar te mjetit, bazuar ne legjislacionin ne fuqi.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në 2.3.8. në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas pikës 2.3.8 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor
- h) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesiose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të ofertave ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimit e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8 ku operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.”

Gjithashtu nga O.E. në lidhje me stafin kryesor mbështetës, punonjësit specialist si dhe certifikimet përkatëse, në mospërputhje me kriterin nr. 2.3.5 të DST-së, ku citohet:

“Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga Ministria e Financave ose te njihet nga Ministria e Punes Ceshjteve Sociale të paraqitet certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat / diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar. Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licencuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.
- Per manovratorët dhe shoferët duhet te paraqiten dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.
- Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise

Diplomë nga institucionet e arsimit të mesëm profesional/publik/privat) të akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, kontratë pune të vlefshme dhe të figurojë në listëpagesa.”

• **“Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjellësi, Hundë E Xhepe Bolenë”.**

Përshkrimi i procedurës:

Me anë të Memos nr.4320/1 prot., datë 26.09.2022, të sektorit të prokurimeve dhe procedurave administrative të drejtorisë juridike ka fillura procedura e prokurimit.

Përmbledhja e procedurës në tabelë

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “ Rrugë mirëmbajtje linje ujësjellësi”, Hundë e Xhepe Bolenë” 2022		
Urdhër Prokurimi : Nr.260, datë 26.09.2022		
1. Lloji i procedurës së Prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”	2. Njësia e Prokurimit Znj.K.M Z.O.V Z. E.SH	3. Komisioni për Përlllogaritjen e Fondit Limit dhe Hartimit të Specifikimeve Teknike: S.K
4. Fondi limit (pa TVSH): 8,330,752 pa TVSH	5. Burimi i Financimit Buxheti i Bashkisë Himarë	6. Data e hapjes së tenderit: 02.11.2022
7. Operatorët Ekonomikë a) Pjesmarrës: B.O.E. "A "SHPK K...C & "R " M...A O.E. "Z " SHPK J...K B.O.E "M "SHPK J...K &"I " SHPK L...R b) Kualifikuar: B.O.E. "A "SHPK K...C & "R " M...A	8. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdher Nr261 datë 26.09.2022 Z.A.G Kryetar Znj.B.R Anëtar Z.U.D Anëtar	9. Oferta fituese (pa tvsh): 8,170,400
10. Data e lidhjes së kontratës Kontratë sipërmarrje nr.717 datë 10.02.2023	11. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) : 160.352 lekë	12. Ankimime S'ka
13.Struktura për ndjekjen e kontratës : S.K	14. Fletë hyrja	15. Afati i kontratës Nga lidhja e kontratës deri më 25.04.2023

Hartimi i dokumenteve standarde nga Njësia e Prokurimit.

Më datë, 27.09.2022, Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhër nr.260 , datë 27.09.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, u hap procedura e prokurimit.

Më 12.10.2022, në Bashkinë Himarë, është mbajtur procesverbali nr.4320/2, date 27.09.2022, nga Njësia e Prokurimit, e ngritur me urdhër nr.260 , datë 26.09.2022, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, me qëllim hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim për procedurën e prokurimit, në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit është bërë miratimi dhe argumentimi i kriterëve të dokumenteve standarde të tenderit.

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.261, datë 26.09.2022, ka mbajtur procesverbalin nr.4320/15, date 12.10.2022, për të dokumentuar hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit.

Ka paraqitur ofertë në formë elektronike operatorit ekonomik:

A ShPK me NIPT K...C & “R ” me NIPT M...A, me ofertë ekonomike : **8,170,400** lekë pa TVSH

Z ShPK me NIPT J...K, me ofertë ekonomike: **8,328,600.lekë pa TVSH.**

M ShPK me NIPT J...K & “I ” ShPK me NIPT L...R Oferta ekonomike:**7,727,300** lekë pa TVSH.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.261, datë 26.09.2022 ka mbajtur procesverbalin nr.4320/16, date 16.12.2022 për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorit ekonomik konkludoi se:

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "A " SHPK"& "R " SHPK, me vlerë 8,170,400 lekë pa TVSH, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativ – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Z ” SHPK, me vlerë 8.328.600 lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativ – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, për arsyt si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e dokumenteve standarte të tenderit si më poshtë:

Kriterin 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Operatori ekonomik nuk i ka paraqitur bilancet në sistemin e prokurimeve elektronike.

Kriterin 2.3 Kapaciteti teknik:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a)punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100 % i vlerësimit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.”

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin provues për këtë kriter.

Kriterin 2.3.2 Kapaciteti teknik:

“Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrjnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Licensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:

Kategoria NP-1 – Klasifikimi A

Kategoria NP-4 – Klasifikimi A

Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në licensë:

Kategoria NS-1 – Klasifikimi A

Kategoria NS-4 – Klasifikimi A

Kategoria NS-5 – Klasifikimi A

Kategoria NS-6 – Klasifikimi A

Kategoria NS-7 – Klasifikimi A

Kategoria NS-18 – Klasifikimi A

Kategoria NS-19 – Klasifikimi A

Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Operatori ekonomik duhet të ketë licence lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL kodi III.2.B”

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin provues për këtë kriter.

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “M ” SHPK& “I ” SHPK, me vlerë 7.727.300 lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë nuk kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativ – ligjor përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit, për arsyt si më poshtë vijon: Njëri nga anëtarët e bashkimit të operatorëve, “M ” SHPK , rezultoi i angazhuar në kontrata të tjera të nënshkuara me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Himarë, për pasojë nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3 Afësitë teknike dhe profesionale të dokumenteve standarte të tenderit.

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri klasifikimin e ofertuesve si më poshtë

"A " SHPK K...C & “R ” me NIPT M...A me ofertë ekonomike: 8,170,400 lekë pa TVSH.

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 30.12.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) Formularin e njoftimit të fituesit.

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

Nga verifikimet rezulton që nuk ka ankesa në lidhje me procesin e vlerësimit.

- **“Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë”**

Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit.

Më datë, 28.02.2022, Njësia e Prokurimit, hap procedura e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Shërbime” me objekt:

“Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “ Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë ”

Më 03.10.2022, në Bashkinë Himarë, është mbajtur procesverbal nga Njësia e Prokurimit, me qëllim hartimin e kërkesave të veçanta për kualifikim për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, Punë” me objekt: “Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “ Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë ”, me fond limit 289,674,042 lekë pa TVSH ose 2,389,458.40 EURO. (Kursi i këmbimit 121,23)., në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit është bërë miratimi dhe argumentimi i kritereve të dokumenteve standarde të tenderit .

Hapja, shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.56, datë 25.02.2022, mbajti procesverbal për të dokumentuar hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Shërbime”.

Në procedurën e hapjes së ofertave, ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave përbërë nga: kryetari A.B dhe anëtarët K.K dhe B.RR .

Kanë paraqitur ofertën në formë elektronike operatorët ekonomik:

BOE “ S ” SHPK me Nipt K...N & “ A ” SHPK me Nipt: K...P, me ofertën prej 167,834,589.28 lekë pa TVSH.

OE “ F ” SHPK me Nipt J...S, me ofertë 169,860,036 lekë pa TVSH

BOE “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt K...I & “A” SHPK me Nipt K...D, me ofertë 149,624,874 lekë pa TVSH.

Pas leximit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se i duhet me shumë së një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij.

Kur të ketë dalë rezultati i vlerësimit të ofertave do të komunikohet me operatorët ekonomikë për ti njoftuar për klasifikimin përfundimtar.

Sa më sipër ky proces-verbal u mbajt në 2 (dy) kopje dhe u nënshkrua nga anëtarët.

Në zbatim të nenit 90 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 80 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin Nr.56 ,datë 25.02.2022, ka mbajtur procesverbal për të dokumentuar hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit.

Në procedurën e hapjes së ofertave, ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave përbërë nga: kryetari A.B dhe anëtarët K.K dhe B.RR .

Kanë paraqitur ofertën në formë elektronike operatorët ekonomik:

BOE “ S ” ShPK me Nipt K...N & “ A ” SHPK me Nipt K...P, me ofertë 115,591,569 lekë pa TVSH.

O.E. “ F ” ShPK me Nipt J...S, 119 451 905,41 lekë pa TVSH.

BOE “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt K...I & “A ” SHPK me Nipt K...D, 106 636 198,50 lekë pa TVSH

BOE “L ” ShPK me Nipt K...L & “A ” SHPK me Nipt K...H, 108 686 445 lekë pa TVSH

O.E. “R ” ShPK me Nipt: J...Q, 102,863,648.79 lekë pa TVSH.

Pas leximit të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se i duhet me shumë së një ditë pune për të përfunduar veprimtarinë e tij.

Kur të ketë dalë rezultati i vlerësimit të ofertave do të komunikohet me operatorët ekonomikë për ti njoftuar për klasifikimin përfundimtar.

Sa më sipër ky proces-verbal u mbajt në 2 (dy) kopje dhe u nënshkrua nga anëtarët.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin e Nr.56, datë 25.02.2022, ka mbajtur këtë procesverbal për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit.

Në procedurën e shqyrtimit të ofertave , ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave përbërë nga: kryetari A.B dhe anëtarët K.K dhe B.RR .

Kanë paraqitur ofertën në formë elektronike operatorët ekonomik:

1.Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ S ” SHPK me Nipt: K...N & “ A ” SHPK me Nipt: K...P, 167 834 589.28 (një qind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetë qind e tridhjetë e katër mijë e pesë qind e tetëdhjetë e nëntë presje njëzet e tetë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “ F ” SHPK me Nipt: J...S, 169 860 036.30 (një qind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e tetë qind e gjashtëdhjetë mijë e tridhjetë e gjashtë presje tridhjetë) lekë pa TVSH

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D, 149 624 874.29 (një qind e dyzet e nëntë milion e gjashtë qind e njëzet e katër mijë e tetë qind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e nëntë) lekë pa TVSH.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorëve ekonomikë konkludoi se:

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “S” SHPK me Nipt: K...N & “ A ” SHPK me Nipt: K...P, me vlerë 167 834 589.28 (një qind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetë qind e tridhjetë e katër mijë e pesë qind e tetëdhjetë e nëntë presje njëzet e tetë) lekë pa TVSH, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit

38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “F” SHPK me Nipt: J...S, me vlerë 169 860 036.30 (një qind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e tetë qind e gjashtëdhjetë mijë e tridhjetë e gjashtë presje tridhjetë) lekë pa TVSH është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo–ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D , me vlerë 149 624 874.29 (një qind e dyzet e nëntë milion e gjashtë qind e njëzet e katër mijë e tetë qind e shtatëdhjetë e katër presje njëzet e nëntë) lekë pa TVSH, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për arsytet si më poshtë:

“Oferta e paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D përmban gabime aritmetike.Më datë 12.04.2022, autoritetit kontraktor i është drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D me “ Kërkesë” në sistemin e prokurimeve elektronike , me anë të së cilës i ka bërë të ditur konstatimin e gabimeve aritmetike në ofertë (bashkëlidhur tabela me të gjitha përlllogaritjet) dhe i ka kërkuar korigjimin e këtyre gabime. Nga afati i përcaktuar në kërkesë, deri më datën e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga ana e ofertuesit nuk është pranuar korigjimi i gabimeve aritmetike (nuk ka dhënë asnjë përgjigje).

Në këto kushte, bazuar në nenin 92, pika 2, të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 3 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi, komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D.

A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I, në deklaratën e dates 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik Z.E.T , për të cilin ka paraqitur edhe dokumentacionin shoqëruar: Diploma, Çertifikata, Librezë pune Kontratë pune.

Në licencën LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, si Drejtues Teknik është **Z.E.K** . Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “A ” Degë e shoqërisë së huaj, për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që Z.E.K nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri. Sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për licencim është Certifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). **Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.** Fakti që drejtuesi i Teknik nuk është i deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nëse deklarimi nuk është bërë sepse punëmarrësi është larguar nga puna, atëherë kemi shkelje të legjislacionit në fuqi : Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” të ndryshuar dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, për rrjedhojë liçenca LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, duhet të revokohet.

Bazuar në nenin 76, pika 3, gërma “ a” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik”, çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor **provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës**, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së dR tës ndërkombëtare në lidhje me këto F , ku Republika e Shqipërisë është pale. Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D.

A ” me Nipt: K...D në deklaratën e dates 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik Z.E.D . Në liçencën LN-1293-10-2020, me Kod III.2.B “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, si Drejtues Teknik është **Znj. E.Ç** .

Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “A ” , për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që Znj. E.Ç , nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri.

Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem **Znj. E.Ç** është e punësuar si Drejtues e teknike pranë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I.

Në të njëjtë kohë **Znj. E.Ç** është Drejtues e Teknike në Liçencën **NZ.6105/8** të A ” Degë e shoqërisë së huaj, si rrjedhojë nuk mundet të jetë e punësuar në një shoqëri tjetër ndërtimi sepse këto Veprime këto ne kundërshtim me VKM Nr.42,date 16.01.2008 « Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari «i ndryshuar Kreu IV pika 2 e tije «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtues it teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtues it teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtues i teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi...

Nga ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “A ” SHPK me Nipt: K...D, Znj. A.F , është administratore e kësaj shoqërie që nga data 05/05/2020 deri më: 05/05/2025.

Fakti që A.F nuk është e deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma “ a” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik”, çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së dR tës ndërkombëtare në lidhje me këto F , ku Republika e Shqipërisë është pale.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D

Formulari i Vetëdeklarimit të “A ” SHPK me Nipt: K...D, përmban gabime sepse deklarimi fillon në emër të “A ” Degë e shoqërisë së huaj.....”

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri klasifikimin e ofertuesve si më poshtë:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ S ” SHPK me Nipt: K...N & “ A ” SHPK me Nnipt: K...P., **167 834 589.28 (një qind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e tetë qind e tridhjetë e katër mijë e pesë qind e tetëdhjetë e nëntë presje njëzet e tetë) lekë pa TVSH.**

Operatori ekonomik “ F ” SHPK me Nipt: J...S, **169 860 036.30 (një qind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e tetë qind e gjashtëdhjetë mijë e tridhjetë e gjashtë presje tridhjetë) lekë pa TVSH**

Sa më sipër ky proces-verbal u mbajt në 2 (dy) kopje dhe u nënshkrua nga anëtarët.

Në zbatim të nenit 92 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave, i ngritur me Urdhrin e Nr.56, datë 25.02.2022, ka mbajtur procesverbal për të dokumentuar shqyrtimin e ofertave për procedurën e prokurimit “**E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Shërbime**”.

Në procedurën e shqyrtimit të ofertave , ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave përbërë nga: kryetari A.B dhe anëtarët K.K dhe B.RR .

Kanë paraqitur ofertën në formë elektronike operatorët ekonomik:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ S ” SHPK me Nipt: K...N & “ A ” SHPK me Nipt: K...P, 115,591,569,65 (një qind e pesëmbëdhjetë milion e pesë qind e nëntëdhjetë e një mijë e pesë qind e gjashtëdhjetë e nëntë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Operatori ekonomik “ F ” SHPK me Nipt: J...S, 119,451,905,41 (një qind e nëntëmbëdhjetë mijë e katër qind e pesëdhjetë e një mijë e nëntë qind e pesë presje dyzet e një) lekë pa TVSH.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D, 106,636,198,50 (një qind e gjashtë milion e gjashtëqind e dyzet mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy presje shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “L ” SHPK me Nipt: K...L & “A ” SHPK me Nipt: K...H, 108,686,445 (një qind e tetë milion e gjashtë qind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH

Operatori ekonomik “R ” SHPK me Nipt: J...Q, 106,640,592,78 (një qind e gjashtë milion e gjashtë qind e dyzet mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy presje shatatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave kaloi në shqyrtimin një për një të gjitha dokumentet e operatorëve ekonomikë konkludoi se:

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “ S ” SHPK me Nipt: K...N & “ A ” SHPK me Nipt: K...P, me vlerë **115 591 569, 65 (një qind e pesëmbëdhjetë milion e pesë qind e nëntëdhjetë e një mijë e pesë qind e gjashtëdhjetë e nëntë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**, është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “ F ” SHPK me Nipt: J... S, me vlerë **119 451 905,41 (një qind e nëntëmbëdhjetë mijë e katër qind e pesëdhjetë e një mijë e nëntë qind e pesë presje dyzet e një) lekë pa TVSH** është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për rrjedhojë kualifikohet përsa i përket dokumentacionit administrativo – ligjor dhe përsa i përket dokumentacionit teknik dhe të zbatimit.

Bazuar në nenin 93 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, komisioni i vlerësimit të ofertave vëren se oferta nuk është anomalisht e ulët.

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D , me vlerë **106 636 198,50 (një qind e gjashtë milion e gjashtëqind e dyzet mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy presje shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH** , nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për arsytet si më poshtë:

“Oferta e paraqitur nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D përmban gabime aritmetike.Më datë 12.04.2022, autoritetit kontraktor i është drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D me “ Kërkesë” në sistemin e prokurimeve elektronike , me anë të së cilës i ka bërë të ditur konstatimin e gabimeve aritmetike në ofertë (bashkëlidhur tabela me të gjitha përlllogaritjet) dhe i ka kërkuar korigjimin e këtyre gabime. Nga afati i përcaktuar në kërkesë, deri më datën e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga ana e ofertuesit nuk është pranuar korigjimi i gabimeve aritmetike (nuk ka dhënë asnjë përgjigje).

Në këto kushte, bazuar në nenin 92, pika 2, të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 82, pika 3 të VKM-së nr.285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ku parashikohet se ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur nuk pranohet korigjimi nga ofertuesi, komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D.

A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I, në deklaratën e datës 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik Z.E.T , për të cilin ka paraqitur edhe dokumentacionin shoqëruar: Diploma, Çertifikata, Librezë pune Kontratë pune.

Në licencën LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, si Drejtues Teknik është **Z.E.K**. Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “A ” Degë e shoqërisë së huaj, për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që Z.E.K nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri. Sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” ndër kriteret kryesore të plotësimit të kushteve për licencim është Certifikata e drejtuesit Teknik dhe Kontratë pune me Drejtuesin Teknik (me kohë të plotë pune). **Bazuar në nenin 12 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, licenca/autorizimi/leja revokohet kur titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.** Fakti që drejtuesi i Teknik nuk është i deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Nëse deklarimi nuk është bërë sepse punëmarrësi është larguar nga puna, atëherë kemi shkelje të legjislacionit në fuqi : Ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe vendimit nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, për rrjedhojë liçenca LN-1163-03-2016, me Kod III.2.B “Transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, duhet të revokohet.

Bazuar në nenin 76, pika 3, gërma “ a” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik”, çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor **provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës**, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së dR tës ndërkombëtare në lidhje me këto F , ku Republika e Shqipërisë është pale. Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D.

A ” me Nipt: K...D në deklaratën e datës 01.04.2022 ka deklaruar si Drejtues Teknik Z. E.D .

Në licencën LN-1293-10-2020, me Kod III.2.B “Grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve të parrezikshme”, si Drejtues Teknik është **Znj. E.Ç** .

Nga verifikimi i listëpagesave të paraqitura nga shoqëria “A ” , për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022, rezulton që Znj. E.Ç , nuk është pjesë e punëmarrësve të deklaruar nga kjo shoqëri.

Nga dokumentacioni i ngarkuar në sistem **Znj. E.Ç** është e punësuar si Drejtues e teknike pranë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I.

Në të njëjtë kohë **Znj. E.Ç** është Drejtues e Teknike në Liçencën **NZ.6105/8** të A ” Degë e shoqërisë së huaj, si rrjedhojë nuk mundet të jetë e punësuar në një shoqëri tjetër ndërtimi sepse këto Veprime këto ne kundërshtim me VKM Nr.42,date 16.01.2008 « Për miratimin e rregullores

për kriteret dhe procedurat e dhënies licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari «i ndryshuar Kreu IV pika 2 e tije «Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi...

Nga ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “A ” SHPK me Nipt: K...D, Znj. A.F , është administratore e kësaj shoqërie që nga data 05/05/2020 deri më: 05/05/2025.

Fakti që A.F nuk është deklaruar në listëpagesa për një periudhë mbi 6 muaj, përmban shkelje të legjislacionit në fuqi: ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 77, pika 3, gërma “ a” të ligjit nr. 162/ 2020 “Për prokurimin publik” , çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së dR tës ndërkombëtare në lidhje me këto F , ku Republika e Shqipërisë është pale.

Komisioni i vlerësimit të ofertave vendos të refuzojë ofertën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “A ” Degë e shoqërisë së huaj me Nipt: K...I & “A ” SHPK me Nipt: K...D

Formulari i Vetëdeklarimit të “ A ” SHPK me Nipt: K...D, përmban gabime sepse deklarimi fillon në emër të “A ” Degë e shoqërisë së huaj.....”

Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “L ” SHPK me Nipt: K...L & “A ” SHPK me Nipt: K...H, me vlerë **108 686 445 (një qind e tetë milion e gjashtë qind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH** , nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për arsyet si më poshtë:

“ Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “L ”SHPK me Nipt: K...L SHPK &“A ” SHPK me Nipt: K...H, skualifikohet për arsyet si më poshtë vijon:

-Oferta ekonomike nuk shoqërohet me analizat e çmimeve sipas kërkesave të dokumenteve standarde të tenderit.

-Shtojca 9 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit i paraqitur nga “A ” SHPK me Nipt: K...H, është i pasaktë sepse nuk është shënuar operatori ekonomik me të cilin ka lidhur kontratë bashkëpunimi.

-Operatori ekonomik “L ”SHPK me Nipt: K...L, nuk ka paraqitur Shtojca 9 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit.

-Bashkimi i operatorëve ekonomik “L ”SHPK me Nipt: K...L SHPK & “A ” SHPK me Nipt: K...H, nuk plotëson kriterin 2.3.2 Për kapacitetin teknik sepse operatori ekonomik “A ” SHPK nuk ka paraqitur Liçencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) , Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis “, Nënkatëgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”, dhe për sa kohë që nuk kemi një ndarje punimesh të përcaktuar midis palëve nuk përjashtohet mundësia që ky operator të kryejë këtë shërbim për të cilin nevojitet liçenca.

-Bashkimi i operatorëve ekonomik “L ”SHPK me Nipt: K...L SHPK & “A ” SHPK me Nipt: K...H, nuk plotëson kriterin 2.3.2 Për kapacitetin teknik sepse çertifikata ISO të operatorit ekonomik “A ” SHPK janë të papërkthyer në gjuhën shqipe nga një përkthyes zyrtar i autorizuar, sipas kërkesave të dokumenteve standarte të tenderit.

-Bashkimi i operatorëve ekonomik “L ”SHPK me Nipt: K...L SHPK & “A ” SHPK me Nipt: K...H, nuk plotëson kriterin 2.3.5 Për kapacitetin teknik sepse nuk ka paraqitur një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohet tipi (emërtimi teknik), lloji, marka, nr. i shasisë, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet.

Nuk plotësohet numri i mjeteve sipas llojit dhe tonazhit të kërkuar. “A ” SHPK me Nipt: K...H, ka deklaruar vetëm dy mjete.

Edhe pas verifikimit të të gjithë dokumentacionit të mjeteve (mjete të padëklaruara) të ngarkuar në sistem nuk rezulton të plotësohen kriteret.

Nuk ka paraqitur deklaratë për mjetet në pronësi/qera apo të porositura, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të dr të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruara në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e saktë të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s’kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

-Bashkimi i operatorëve ekonomik “L ”SHPK me Nipt: K...L SHPK & “A ” SHPK me Nipt: K...H, nuk plotëson kriterin 2.3.5.1 Për kapacitetin teknik sepse nuk ka paraqitur liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): Kodi III.7.3.B.1.a.b.c.ç “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, autoriparimi i mjeteve për të siguruar një shërbim riparimi të mjeteve që do të meren me realizimin e kontratës së shërbimit të pastrimit, gjatë të periudhës së zbatimit të kontratës e në veçanti gjatë periudhës së verës, ose të ketë kontratë shërbimi me kohëzgjatje sa kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik të licencuar. ”

• Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “R ” SHPK me Nipt: J...Q , me vlerë **106 640 592,78 (një qind e gjashtë milion e gjashtë qind e dyzet mijë e pesë qind e nëntëdhjetë e dy presje shatatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH**, nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, për arsye si më poshtë:

“Operatori ekonomik “ R “ SHPK me Nipt: Nipt: J...Q, nuk plotëson kriterin 2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë: 1 (një) punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndhimës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Licence;
- CV-në përkatëse;

- Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).
znj.E.XH disponon certifikim vetëm për dhënien e ndihmës së pare, dhe jo për ndërhyrjen ndaj emergjencave.

Operatori ekonomik “ R ” SHPK me Nipt: Nipt: J...Q, nuk plotëson kriterin **2.3.5**. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

k) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 7-8 mije litra ujë, jo më pak se 1 (një) cope.

Autoboti AA865GC nuk është i pajisur me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, sipas kërkesave të dokumenteve standarde të tenderit.

Makina me vinç për ngarkim-shkarkim kazanësh gjate lëvizjes dhe shkarkimit ne vendet e përdorimit, jo më pak se 1 (një) copë;

Automjeti me targa AB480CC, nuk është vinç për ngarkim-shkarkim kazanësh”

Komisioni i vlerësimit të ofertave bëri klasifikimin e ofertuesve si më poshtë:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “ S ” SHPK me Nipt: K...N & “ A ” SHPK me Nipt: K...P, 591 569, 65 (një qind e pesëmbëdhjetë milion e pesë qind e nëntëdhjetë e një mijë e pesë qind e gjashtëdhjetë e nëntë presje gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Operatori ekonomik “ F ” SHPK me Nipt: J...S, 119 451 905,41 (një qind e nëntëmbëdhjetë mijë e katër qind e pesëdhjetë e një mijë e nëntë qind e pesë presje dyzet e një) lekë pa TVSH

Publikimi i Formularit të njoftimit të fituesit

Në zbatim të nenit 97 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 83 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, më datë 27.04.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik Formularin e njoftimit të fituesit për “Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “ Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë ” Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë. ” dhe më datë 27.05.2022 Njësia e Prokurimit ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik Formularin e njoftimit të fituesit për “Marrëveshje kuadër me kohëzgjatje 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj: “ Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë ”Loti 1 : “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Himarë ”” dhe më datë

Me publikimin e këtij njoftimi, kanë filluar afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

Për sa i përket procedurës së mësipërme është ngritur padi nga shoqëria “S ” shpk dhe “A ” ShPK pranë Gjykatës Administrative, çështje e cila është vendosur në favor të shoqërisë paditëse dhe aktualisht po gjykohet pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Në lidhje me zbatimin e kontratës, kontrata është e ndarë në dy Lote,

Loti 1 : “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Himarë”;

Loti 2: “Shërbimi i pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, Njësia Administrative Horë- Vranisht dhe Lukovë”.

- Grumbullim i mbetjeve ricikluese (karton, plastike, metal etj)
- Edukim publik dhe Ambiental i Qytetarëve,

O.E. “R ” ShPK Loti 2

Shoqëria : " REJ " SHPK
A. SITUACION NR.6

COMPANIA : "REJ" S.R.L. SITUACION Nº.6

IND.	DESCRIPCION DE LOS ELEMENTOS	UNIDAD	CANTIDAD	VALOR UNITARIO	VALOR TOTAL	PREVENTIVO ORIGINAL		PREVENTIVO ACTUAL		DIFERENCIA		COMENTARIOS	
						VALOR	PERCENTUAL	VALOR	PERCENTUAL	VALOR	PERCENTUAL	DESCRIPCION	VALOR
1	GRUMBULLIM I MBETJEVE RICIKLUESE (KARTON, PLASTIKE, METAL ETJ)	LEKË	12,569,320	100.00%	12,569,320	12,569,320	100.00%	15,083,185	100.00%	2,513,865	100.00%		
2	EDUKIM PUBLIK DHE AMBIENTAL I QYTETARËVE	LEKË	377,966	100.00%	377,966	377,966	100.00%	196,991	100.00%	-180,975	100.00%		
3	LAGJIA E RUGËVE DHE SHESHEVE ME MJET TEKNOLOGJIK	LEKË	2,227,225	100.00%	2,227,225	2,227,225	100.00%	5,912,270	100.00%	3,685,045	100.00%		
4	FSHIRJE DHE LARJE E SHESHEVE ME MJET TEKNOLOGJIK	LEKË	1,033,478	100.00%	1,033,478	1,033,478	100.00%	3,100,434	100.00%	2,066,956	100.00%		
5	HEQJA E MBETJEVE INERTE VOLUMINOZE NGA PIKA E GRUMBULLIMIT	LEKË	2,168,396	100.00%	2,168,396	2,168,396	100.00%	6,505,190	100.00%	4,336,794	100.00%		
6	GRUMBULLIM I MBETJEVE RICIKLUESE (KARTON, PLASTIKE, METAL ETJ)	LEKË	2,209,956	100.00%	2,209,956	2,209,956	100.00%	6,629,870	100.00%	4,419,914	100.00%		
7	EDUKIM PUBLIK DHE AMBIENTAL I QYTETARËVE	LEKË	377,966	100.00%	377,966	377,966	100.00%	1,133,899	100.00%	755,933	100.00%		
8	TOTAL		18,566,231		18,566,231	18,566,231		53,669,044		35,102,813			

Për "REJ" sh.p.k. Për "BASHKËSI HËNARË" Për "BASHKËSI HËNARË"
 Autorizim RENCIBAR I HËNARË Autorizim
 Jozepa GJERA Jozepa GJERA Andrea BREGI

Nga analizimi i situacioneve mujorë për kryerjen e shërbimit të pastrimit të territorit të Bashkisë Himarë, vlera për vitin 2022 është në total 12,569,320 lekë pa tvsh ose 15,083,185 lekë me tvsh ndërsa për vitin 2023 vlera në total është lekë pa tvsh ose lekë me tvsh.

Në Situacionin e mësipërm janë përfshirë zëra punimesh si

- Fshirje me fshese dore rrugëve dhe shesheve (Dhërmi, Vuno, Jalë, Himarë dhe Qeparo)
- Grumbullim e transportim i mbeturinave urbane dhe kontenierë e mjet teknologjik deri ne vend e depozitim e mbeturinave (Stacioni i transferimit Vumblo)
- Grumbullimi e Transportimi i mbeturinave urbane me kontenierë e mjet teknologjik deri në vend depozitimin e mbeturinave (sezon turistik)
- Larja e Kontenierve
- Lagia e rrugëve dhe shesheve me mjet teknologjik.
- Heqja e mbetjeve inerte voluminoze nga pika e grumbullimit.
- Grumbullim e transportim i mbeturinave në plazhe.
- Edukim publik dhe Ambiental i Qytetarëve.

Verifikimi i zbatimit të kontratës gjatë periudhës së auditimit në terren që përkon me muajt Dhjetor – Janar e bën më të vështirë arritjen e një konkluzioni mbi zbatimin e kontratës, pasi popullimi dhe lëvizjet e qytetarëve në këtë periudhë është e ulët.

Në lidhje me disa nga zërat e punimeve të mësipërme, grupit të auditimit iu vu në dispozicion procesverbal të mbajtur nga ana e mbikëqyrësit të kontratës në lidhje me realizimin e tyre, si:

Përshkrimi i punimeve	A ShPK		R sh.p.k	
	2022	2023	2022	2023
Lagjia e rrugëve dhe shesheve me mjet teknologjik	2,227,225	5,912,270	1,610,048	973,583
Fshirje dhe larje e shesheve me mjet teknologjik	1,033,478	3,100,434	0	0
Heqaj e mbetjeve inerte voluminoze nga pika e grumbullimit	2,168,396	6,505,190	0	0
Grumbullim i mbetjeve ricikluese (karton, plastike, metal etj)	2,209,956	6,629,870	1,431,761	1,567,767
Edukim publik dhe Ambiental i Qytetarëve	377,966	1,133,899	200,658	196,991
Total	8,017,021	23,281,663	3,242,467	2,738,341

Nga Bashkia Himarë nuk dokumentohet realizimi i zërave të mësipërm e cila në total për O.E. “A” është në vlerën 31,298,684 lekë pa TVSH, për O.E. “R” ShPK është në vlerën duke e konsideruar vlerën 5,980,808 lekë pa TVSH, ku në total është në vlerën 37,279,492 lekë pa TVSH si shumë e përdorur pa Efektivitet, Eficencë dhe Ekonomicitet nga Bashkia Himarë.

Nga subjekti Bashkia Himarë nuk janë paraqitur kundërshtinë fazën e projektraport auditimit.

II.2.5. “Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)”.

VI.1) Auditim mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.

VI.2) Auditim mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV; Për subjektet të cilat kanë kryer kundravajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.

VI.3) Auditim mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur mbi zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Mbi organizimin e strukturës së Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nen 64 “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”, të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, “Për miratimin e numrit të punonjësve niveli i pagave”, me urdhërat përkatës të Kryetarit të Bashkisë janë emëruar: **Z.M.N** me detyrë Kryeinspektor IMT, arsim i lartë dega Inxhinieri Ndërtimi, **R.H** Inspektor ndërtimi me arsim të lartë dega Juridik. **E.Z** Inspektor ndërtimi me arsim të lartë. **R.K** Inspektor ndërtimi (i komanduar në datë 22.12.2022) arsim i mesëm, si dhe Inspektori **E.V** me arsim i mesëm, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, e konkretisht nenit 11 të tij, ku citohet se:

Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/kombëtar duhet të kenë arsimin te lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Për të gjithë periudhën e auditimit 01.01.2022 deri më 31.12.2022, struktura ka funksionuar me 5 punonjës, 1 Kryeinspektor si dhe 4 Inspektor në nivel sektori. Për periudhën objekt auditimi, IMTV e Bashkisë Himarë ka mangësi në dokumentacion pasi nuk dispononte programe pune vjetore dhe mujore, si dhe nuk është bërë ndarje e detyrave përkatëse. Në terren IMTV është marrë me kontrollin e zbatimit të punimeve të ndërtimit, në përputhje me dispozitat ligjore nga subjektet të pajisura me leje ndërtimi, me zgjidhjen e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve.

IMTV e Bashkisë Himarë edhe pse nuk disponon 1 plan të detajuar vjetor dhe as mujor për vitin 2022, ka vijuar aktivitetin e saj në disa F dhe konkretisht; shqyrtimi i ankesave të ardhura nga komuniteti në fushën e ndërtimeve të mjedisit, shkëmbime informacione me institucionet përkatëse si D.P.K.ZH.T për lejet e ndërtimit, deklaratat paraprake të punimeve të miratuara gjatë muajit, shkëmbime i korrespondencës me institucione të tjera dhe Njësitë Administrative, kontroll periodik të objekteve etj.

IMTV e Bashkisë Himarë, ka inspektuar terrenin duke kontrolluar subjekte të ndryshme sipas dokumentacionit tekniko-ligjor që disponojnë, ose që nuk disponojnë subjektet ndërtuese dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore, ku për shkeljet e konstatuara në zbatim të nenit 12, të ligjit nr. 9870, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, nenit 81, të ligjit nr. 10119 datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të nxjerra, ligjit nr. 107/2014, datë 1.10.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar konstatoi disa problematika për vitet respektive 2020, 2021, 2022.

Më konkretisht referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Kr/Inspektorit të Bashkisë Himarë, është ushtruar kontroll në subjekte të ndryshme ku janë konstatuar kundrvajtje administrative, ku nga ana e tyre janë ndjekuar të gjitha procedurat ligjore të pasqyruara në tabelën nr. 5 bashkëlidhur.

-Sikurse rezulton nga të dhënat e tabelës, nga IMTV janë vendosur 64 gjoba me vlerë 28,400,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 5 gjoba me vlerë 500,000 lekë ndërkohë që 59 gjoba me vlerë 27,900,000 lekë janë në proces arkëtimi. Nga ana e IMTV Bashkia Himarë nuk është bërë njoftim për Drejtorinë e Financës dhe buxhetit për vjeljen e gjobave të subjekteve të cilët kanë marrë gjobë. Në Drejtorinë e financës, grupi i auditimit siguroi dokumentacionit e nevojshëm të rakordimit të debitorëve të krijuar nga vendosja e gjobave për vitin 2022, ku janë konstatuar vetëm 5 raste të dokumentacionit për vjeljen e këtyre gjobave. Nga auditimi i zbatimit të procedurave ligjore për vendosjen e gjobave dhe arkëtimin e tyre, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, përkatësisht neni 16, ku përcaktohet se:

Gjopa paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë deri në një muaj, nga verifikimi u konstatua se nuk është vepruar në plotësim të kësaj kërkesë ligjore nga ana e IMTV Himarë. Për vendimet e gjobave të pa arkëtuara brenda afatit ligjor, përveç vlerës së gjobës, llogaritur edhe vlerat e kamatë vonesave në masën 2% të vlerës të gjobës për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë, (ose në shumën 60% kamatë vonesë mbi gjobën e vendosur), në zbatim të pikës 3, neni 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Nga ana e IMTV Bashkia Himarë me shkresat përkatëse nuk është njoftuar Drejtoria e Financës dhe buxhetit për vjeljen e gjobave.

Gjatë periudhës së auditimit 01.01.2022 deri më 31.12.2022, janë nxjerrë në total 66-Vendime për prishje objektësh (kryesisht shtesa, mure rrethuese, ose ndertime me struktura metalike dhe druri). Jane ekzekutuar nga Bashkia Himarë vetëm në 7 raste pasi nuk disponon mjetet e nevojshme për kryerjen e këtyre proceseve. Në raste të veçanta janë përdorur mjete private, pa kryer asnjë kontratë mes palëve (Bashkisë Himarë dhe personave që i disponojnë këto mjete) duke vepruar në kundërshtim me ligjin. Për këto raste janë kryer denoncime dhe ngritur padi kundër këtyre vendimeve. Gjithashtu nga ana e IMTV Himarë janë bërë njoftime subjekteve të ndryshme kundërvajtës për zbatimin vullnetar të urdhrave të dala nga Bashkia Himarë.

Kryeinspektori i IMTV, brenda afateve të përcaktuara ka vazhduar procedurat përkatëse me vendime respektive në zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 9780 “Për Inspektimin e ndërtimit”. Në disa raste nga ana K/Inspektori dhe Inspektorëve janë hartuar vendimet për pezullim punimesh. Përsa i përket masave të ndëshkimit me gjobë për subjektet të cilat kanë shkelur dispozitat ligjore në

fuqi, rezultoi se pR IMTV janë mbajtur procesverbalet përkatës dhe akt konstatime të shoqëruar me gjobë në zbatim të Ligjit Nr.9780 datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimit e kundërligjshme”, i ndryshuar neni 5, gërma b si dhe ligjit nr.107/2014, i ndryshuar neni 52, pika 1 si dhe nenit 10 279 datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”

Nga ankimimet e kryera pranë Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Vlorë si dhe Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, nga ana e shtetasve të cilët u janë vendosur masa administrative (gjobë) nga IMTV Bashkia Himarë, pasi kanë shqyrtuar rastet ku në disa prej tyre kanë dhënë vendimet ne favor të subjektit, duke shfuqizuar vendimin për dënimin me gjobë nga ana e IMTV Himarë, ka vendosur që shpenzimet gjyqësore ti ngarkohen IMT Bashkia Himarë. Vlera e dëmit të shkaktuar buxhetit të Bashkisë Himarë prej këtyre vendimeve shkon në vlerën 273.680 lekë të reja.

Nga auditimi u konstatua këto mangësi:

-Nga kontrollat e kryera me sektorin e IMTV pranë Bashkisë Himarë rezultoi se ky sektor nuk disponon mjetet e nevojshme për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, duke mos respektuar përcaktimet e Ligjit Nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” neni 5, “Detyrat e inspektoriatit ndërtimor dhe urbanistik të bashkisë komunës,ku citohet që: Inspektoriatit vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm. Pra nga ana e Inspektorëve të IMTV në çdo rast konstatimi të kundravajtjes e bën të pamundur përmbushjen e këtij detyrimi.

-Nga të dhënat e marra si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi gjithashtu që Inspektorët për përmbushjen e përgjegjësisive të parashikuara në ligj, disponojnë vetëm 1 mjet lëvizës mbi ushtrimin e kontrollit në territor. Nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa që të sigurohen mjetet e nevojshme lëvizëse në përmbushje të detyrave funksionale të Inspektorëve të IMTV bazuar në Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007, neni 4 ku citon: *Për përmbushjen e përgjegjësisive të parashikuara me ligj, inspektorati ndërtimor e urbanistik i bashkisë/komunës mbështetet nga policia bashkiake/komunale dhe pajiset me mjetet dhe makineritë e nevojshme nga bashkia/komuna.*

-Nga auditimi i dosjeve të personelit, me konkretisht nga auditimi i dosjeve së sektorit të IMTV rezultoi se 3 Inspektorët nuk e kanë arsimin përkatës në kundërshtim me Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 neni 11 ku citon: *“Kryeinspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/kombëtar duhet të kenë arsimin te lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.*

-Nga auditimi i praktikave të mbajtura nga IMTV, në lidhje me inspektimin në terren mbi kontrollat e ushtruara në subjekte të ndryshme sipas dokumentacioni teknik-ligjor, rezultoi se nuk dokumentohet plotësisht puna apo procesi i punës në rastet kur nuk konstatohen kundravajtje apo në raste ku inspektorët dalin në terren mbi verifikimin e ndërtimeve pa leje. Nga ana e inspektorëve duhet të mbahet një rregjistër apo libër ku të paraqitet procesi i punës së përditshme. Kjo në zbatim të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin(MFK) Nr.10296 datë 08.07.2010, neni 16, gjurma e auditimit.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

VKM Nr.408, Dt.13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”.

Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” .

II.2.6. “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”.

6/1 Planifikimi i territorit.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) për territorin administrativ të Bashkisë Himarë ka nisur me procesin e hartimit në kuadër të prokurimit të shërbimit të konsulencës nga ish Ministria e Zhvillimit Urban për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki në Shqipëri. Në zbatim të neneve 7,20 dhe 25 të Ligjit Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, me propozimin e kryetarit të Bashkisë Himarë dhe miratuar në Këshillin Bashkiak Himarë me Vendimin nr.122 datë 30.08.2017.

Miratimi në KKT është finalizuar me Vendimin Nr.2 datë 16.10.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë”.

Ky plan ka pësuar rishikimin e parë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Himarë Nr.26 datë 06.05.2020. Ky propozim për rishikim është miratuar në Këshillin Kombëtar të Territorit me Vendim Nr.05 datë 10.06.2020 “Për Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë”.

Ky plan ka pësuar rishikimin e dytë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Himarë Nr.18 datë 30.03.2021. Ky propozim për rishikim është miratuar në Këshillin Kombëtar të Territorit me Vendim Nr.05 datë 15.04.2021 “Për Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë, të miratuar me Vendimin Nr.2 datë 16.10.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit, i ndryshuar”.

Gjatë vitit të ushtrimit të auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përkatësisht nga 01.01.2022 deri 31.12.2022, Bashkia Himarë për shqyrtimin e aplikimeve në e-leje i është referuar planeve vendore në fuqi dispozitive ligjore në zbatim të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” të ndryshuar.

Përjashtim nga kompetencat për të shqyrtuar kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi nga Bashkia Himarë bëjnë zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike dhe **brezi bregdetar**, sipas vendimit nr. 1, datë 8.10.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), **në të cilat çdo ndërtim i ri do të jetë objekt shqyrtimi nga Këshilli Kombëtar i Territorit.**

Neni 45, i VKM Nr. 408 përcakton gjithashtu se:

2. Kërkesat për leje ndërtimi, që bazohen në instrumentet e planifikimit të miratuara përpara hyrjes në fuqi të Planeve të Përgjithshme Vendore për territoret e R administrative, do të shqyrtohen në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe kushtet zhvillimore në fuqi në kohën e miratimit të tyre.

Bazuar në Ligjin Nr.107 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” të ndryshuar, kushtet zhvillimore janë kushtet e përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor.

Neni 3

15. **“Kushte zhvillimore” janë kushtet e përcaktuara nga plani i detajuar vendor ose, në mungesë, nga plani i përgjithshëm vendor dhe, në mungesë të dyjave, të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës i planifikimit që shërbejnë si bazë për hartimin e dokumentacionit të domosdoshëm për pajisjen me leje ndërtimi.**

Për gjithë sa më sipër nga auditimi rezulton se për periudhën e auditimit 01.01.2022 deri 31.12.2022:

1. Në territorin administrativ të Bashkisë Himarë kërkesat për leje zhvillimi/ndërtimi shqyrtohen konform Ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi , si edhe duke u bazuar në dokumentet e planifikimit si : Plani i përgjithshëm Vendor Bashkia Himarë e miratuar me Vendimin nr.2 të KKT-së datë 16.10.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë” (që tani e tutje do të shënohet *PPV në këtë dokument*), i rishikuar me Vendimin nr.5 datë 10.06.2020 të KKT “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë, i rishikuar me Vendimin nr.5 datë 15.04.2021 të KKT “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor , Bashkia Himarë”.

2. Kontrolli dhe zhvillimi i territorit

Referuar të dhënave në sistemin elektronik e-lejet për Bashkinë Himarë, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2022 deri 31.12.2022**, ka pasur **179 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi etj. përkatësisht 38 aplikime për leje Zhvillimi, 29 për leje ndërtimi me sipërfaqe mbi 250m², 12 aplikime për leje me sipërfaqe deri 250m², 7 certifikata përdorimi, 10 shtyrje afati leje ndërtimi, 28 deklarata paraprake për kryerje punimesh, 0 ndryshime funksioni, aplikime për shtesë në ndërtim ekzistues, rikonstruksione 9 dhe 8 leje infrastrukture.

Lloji i lejes	Total 2022	Miratuar	Refuzuar	Jashtë afateve ligjore për shqyrtim
Leje Zhvillimi	38	23	15	29
Leje Ndërtimi mbi 250m ²	29	22	7	15
Leje Ndërtimi deri 250m ²	12	8	4	0
Leje Ndërtimi shtesa me sipërfaqe deri 250m ²	9	5	4	4
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	28	11	17	-
Rikonstruksion me ndryshim funksioni	3	1	2	3
Rikonstruksion pa ndryshim funksioni	6	2	4	4
Certifikatë përdorimi	7	4	3	5
Shtesë në objekt ekzistues	1	-	1	-
Ndryshim projekti gjate zbatimit	6	2	4	4
Ndryshim funksioni	-	-	-	-
Ndryshim subjekti zhvillues	1	1	-	1
Ndryshim subjekti zbatues	4	4	-	1
Njoftim fillim punimesh	17	17	-	7
Shtyrje afati leje ndërtimi	10	6	4	7
Leje Infrastrukture	8	6	2	-


Referuar të dhënave në sistemin elektronik e-lejet për Bashkinë Himarë, për afatin e auditimit 01.01.2022 deri në 31.12.2022, rezulton se janë tejkualuar afatet ligjore për shqyrtimin e aplikimeve, pavarësisht statusit të tyre, specifikisht për këto lloje lejesh: përkatësisht 23 aplikime për leje Zhvillimi janë trajtuar në tejkualim të afateve të përcaktuara për shqyrtim, 26 aplikime për

leje ndërtimi, 7 aplikime për leje njoftim fillim punimesh dhe 7 aplikime për ndryshim subjekti zbatues janë shqyrtuar në tejkalim të afateve dhe 5 aplikime për pajisje me certifikatë përdorimi.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur disa nga procedurat e miratimit për leje ndërtimi për ndërtime të R a me sipërfaqe më të madhe se 250 m², nën 250m² si edhe certifikata përdorimi, duke e bazuar kështu përzgjedhjen në madhësinë e objekteve, vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë si edhe vendndodhjes së tyre, për të mbajtur në fokus veçanërisht lejet e dhëna në Bashkinë e Himarë në zonën e brezit bregdetar, si zona ku risku paraqitet më i lartë.

Nga auditimi me zgjedhje i procedurave për leje ndërtimi të miratuara nga Bashkia Himarë, ku u përzgjedhën si më me risk lejet për objektet shumëkatëshe banimi, multifunksionale dhe turistike, rezulton se **Bashkia Himarë në 16 raste ka miratuar leje ndërtimi dhe procedura të tjera në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi**, konkretisht:

1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, Prot. 819 datë 16.02.2023 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi miratuar me Vendim të KKT Nr. 32 datë 28.12.2020 për objektin “G , zona G6b, REZIDENCE BANIMI ME APARTAMENTE 2, 3, 4 dhe 5 kat me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë”, në adresën Gjilekë (Dhrale), Bashkia Himarë, me zhvillues “G” sh.p.k, Subjekt Ndërtues “M” sh.p.k, projektuar nga ark. B.SH .



Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së sipërcituar rezulton se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, i cili është miratuar me Vendim nr.2 të KKT-së datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuria e cila zhvillohet me nr.68/180, e cila rrjedh nga ndarjet e pasurisë 96 vol.2 fq.96, me status kullotë dhe sipërfaqe 7957 m², Zona Kadastrale 1739 bën pjesë në njësinë strukturore:

HI.UB.1.168, me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim me përdorime të lejuara AR_Aktivitete sociale dhe rekreacion; A.5_Zona me shtëpi të dyta.

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 15\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 28.9\%$, duke shkelur kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 11$ m, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 21.33$ m. Gjithashtu numri maksimal i kateve sipas përcaktimeve të kësaj njësie strukturore në dokumentin vendor të

planifikimit është 3 kate, ndërsa në Vendimin Nr.25 datë 16.02.2023 lartësia maksimale e miratuar është 5 kate mbi tokë. Pra, nuk është respektuar lartësia maksimale e lejuar e përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max}=0.25$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkalohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 1.04$.

1.4. Sipas përcaktimeve të treguesve të nevojshëm për zhvillimin e kësaj njësie strukturore, HI.UB.1.168, madhësia e parcelës minimale për zhvillim duhej të ishte $K1=50000 \text{ m}^2$. Sipërfaqja e vënë në dispozicion për këtë zhvillim është pasuria nr.68/180 me sipërfaqe 7957 m^2 .

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën e objektit 3 kate me kufirin e pasurisë në dR timin verior, që duhej të ishte minimalisht 4.0m nga kufiri i pasurisë.

3. Shqyrtuesit e praktikës, nuk kanë kërkuar mendimin e institucioneve mendimdhënëse si: AKM, ASHK, UK Himarë, OSHEE, MZSH në kundërshtim kjo me Nenin 21 pika 6 e VKM 408/2015 i ndryshuar.

Neni 21 pika 6 VKM 408/2015: Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës ose KKT-ja, sipas fushës së kompetencës, u dërgon atyre kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

4. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Ligjin Nr.124/2015 “Për Eficencën e Energjisë”, Urdhërin Nr. 5, datë 12.01.2021, Ligjin Nr. 116/2016 për Efiçencën e Energjisë në Ndërtesa dhe VKM Nr.537, datë 08.07.2020, pasi nuk është marrë konfirmimi i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë dhe objekti nuk është pajisur me Certifikatën e Performancës së Energjisë.

5. Plani i rilevimit paraqet pasurinë e përfshirë në zhvillim, por nuk ka asnjë informacion mbi vendndodhjen e pasurisë, përmasat apo madhësinë e saj, duke e bërë të papërdorshëm si dokument, gjithashtu duke mos përmbushur kështu kërkesat ligjore sipas nenit 15 pika c të VKM 408/2015 me ndryshimet përkatëse.

6. Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 491,690,780 lekë.

Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.4 datë 27.01.2023 është përlllogaritur me vlerën 17,722,341.40 lekë. Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 491,690,780 = 19,667,631.2$ lekë.

Nga subjekti “G” sh.p.k me faturën e R datë 01.02.2023 janë paguar 17,722,341.40 lekë.

Vlera e llogaritur në mungesë nga Bashkia Himarë pR **1,945,289.88 lekë përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.**

Për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ngarkohet me përgjegjësi z. D.B .

7. Nga shqyrtimi i kësaj procedure vihet re se aplikimi është kryer me cështjen nr.5530 datë 16.02.2023, dhe koha për shqyrtimin e saj është 69 ditë kalendarike. Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Himarë ka tejkualuar afatet e shqyrtimit sipas nenit 20 dhe 21 të VKM 408/2015 e ndryshuar, duke u bërë subjekt i Nenit 52 pika 1 e Ligjit 107/2014 i ndryshuar “Kundravajtjet Administrative”.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr. 25, Prot. 819 datë 16.02.2023 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.G.S drejtues i DPKZHT, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.23 datë 25.01.2023 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; Për përlogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e vlerave monetare ngarkohet me përgjegjësi z.D.B ; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z.J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.

2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 26, Prot.820, datë 16/02/2023 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 32, datë 28.12.2020 të KKT për objekt “G , zona Ë, Rezidencial-Vila 1 dhe 2 kat, pishinë e mur rrethues”, me vendndodhje Gjilekë (Dhrale), Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "S " ShPK dhe “G ” shpk, subjekt Ndërtues dhe projektues “K ” ShPK.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN091220220041 aplikuar nr.5531



prot. me datë 10.01.2023 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 26, Prot.820, datë 16.02.2023 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për “G , zona Ë, Rezidencial-Vila 1 dhe 2 kat, pishinë e mur rrethues” , u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuritë në të cilat zhvillohet ky projekt propozim si vijon:

- Pasuria nr.68/129 ZK.1739, vol.2 fq.55, status Kullotë, në pronësi të D.M K me sip.5431.3 m2;

Pasuria nr.68/37 ZK.1739, status Kullotë, në pronësi të L.D me sip.1000 m2;

Pasuria nr.68/38 ZK.1739, status Kullotë, në pronësi të L.D me sip.1000 m2;

Pasuria nr.68/78 ZK.1739, status Kullotë, në pronësi të E.SH me sip.3975.4 m2;

Pasuria nr.68/133/2 ZK.1739, status Kullotë, në pronësi të S.XH me sip.1000 m2;

Pasuria nr.68/134 ZK.1739, status Kullotë, në pronësi të J.M me sip.1000 m2;

Pasuria nr.68/135 ZK.1739, status Kullotë, në pronësi të R me sip.1000 m2;

Pasuria nr.68/148 ZK.1739, status Kullotë, në pronësi të M.M me sip.2374.5 m2;

bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.1.168, me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim dhe përdorime të lejuara S. Shërbime; AR_Aktivitetet sociale dhe rekreative; A.5_Zona me shtëpi të dyta.

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, parcela minimale për zhvillim është 50000 m², ndërsa parcela e zhvilluar me lejen e miratuar me vendim Nr. 26, Prot.820, datë 16.02.2023 është 18781 m², pra leja është miratuar në kundërshtim me treguesit zhvillimorë të PPV Bashkia Himarë.

1.2. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 15\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 17.4\%$, duke tejkaluar dhe mosrespektuar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.3. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.25$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është $I_{miratuar} = 0.33$, duke tejkaluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objekteve me njëra-tjetrën në zbatim të Nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

Vila nr.2 dhe Vila nr.3 duhej të kishin distance 6m nga njëra-tjetra, ndërkohë kanë distancë 3.3m; Vila nr.5 dhe Vila nr.4 duhej të kishin distance 6m nga njëra-tjetra, ndërkohë kanë distancë 2.1m sipas planvendosjes së miratuar;

Vila nr.14 dhe Vila nr.13 duhej të kishin distance 6m nga njëra-tjetra, ndërkohë kanë distancë 5.2 m;

Vila nr.16 dhe Vila nr.17 duhej të kishin distance 4m nga njëra-tjetra, ndërkohë kanë distancë 3.1m;

Vila nr.18 dhe Vila nr.19 duhej të kishin distancë 5m nga njëra-tjetra, ndërkohë kanë distancë 4.7 m.


3. Plan i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë. Një informacion i tillë mungon. Për sa më sipër Plani i rievimit është i pasaktë.

4. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të vlerësimit mjedisor nga AKM, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion, gjithashtu nga aplikuesi nuk është depozituar në sistemin e-leje Leja Mjedisore përkatëse. Bashkia Himarë ka shkëlur kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit sipas Ligjit Nr. 10440, date 23/01/2003 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar, si edhe nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

5. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të mendimit të ASHK për pasuritë që zhvillohen, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion. Bashkia Himarë nuk ka respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015. Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr. 26, Prot. 820 datë 16.02.2023 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.G.S drejtues i DPZHT, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.24 datë 25.01.2023 me lëndë: "Raport i Vlerësimit Teknik"; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z.J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë

3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 31, Prot.1013/1, datë 24.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Nr. 20, datë 28.07.2020 të KKT për objekt "Strukture

hotelerie dhe shërbimi 3 kate”, me vendndodhje në Gjilekë, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria “R ” ShPK.



Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me AN310120220045 me date 31.01.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 31, Prot.1013/1, datë 24.03.2022 i Kryetarit të Bashkisë Himarë për “Strukturë hotelerie dhe shërbimi 3 kate”, u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuria Nr.68/1/24 në të cilën zhvillohet ky projekt propozim bën pjesë në njësinë strukturore HI.UB.1198 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori S.2_Zonë Hotelesh dhe s.3_Zonë turizmi të integruar (resorte, vila) dhe përdorime të lejuara S.4_ Shërbime plazhi; S.5_ AR_Aktivitete sociale dhe rekreative; A.5_Zona me shtëpi të dyta.

1.1. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax}= 40\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar}= 43\%$, duke tejkalluar dhe mosrespektuar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.2. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max}=1.7$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është më i lartë, pasi kati në kuotën -3.96 është konsideruar si kat nëntokë, duke mos e marrë parasysh në përlllogaritjen e intensitetit të objektit, sipas përcaktimeve të pikës 3(a) të Nenit 37 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duke tejkalluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit ‘Hotel’ me kufirin e pasurisë në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015.

- Objekti në verilindje nuk plotëson distancën pR 4m me kufirin e pasurisë, pasi kjo distancë është ruajtur 3.2m;
- Objekti në jug nuk plotëson distancën pR 4m me kufirin e pasurisë, pasi kjo distancë është ruajtur 3.3m;

3. Mungon plan i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare.

4. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacioni/pëlqimit nga OSHEE, UK Himarë, ASHK, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar.

5. Leja e ndërtimit për këtë objekt është lëshuar në mungesë të pajisjes me Certifikatën paraprake të performancës së energjisë nga AEE, pasi nuk është kryer bashkërendimi me këtë institucion. Bashkia Himarë ka shkelur kërkesat ligjore në zbatim të ligjit Nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” dhe aktet nënligjore në fuqi, si edhe nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar. Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 31, Prot.1013/1, datë 24.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.G.S drejtues i DPZHT, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.30 datë 11.03.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z.J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.

4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 40, Prot.1015/1, datë 01.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe Leje zhvillimi Nr. 44, Nr.1572/1 Prot. datë 15.07.2021 të KKT për objekt "Vile me 2,3 kate ne Qeparo në pronë të z. F.P ", me zhvillues F.P dhe Subjekt Ndërtues “M ”, Qeparo, Himarë.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit për aplikimin me AN040220220052 për të cilën është marrë Vendim Nr. 40, Prot.1015/1, datë 01.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për miratimin e lejes së ndërtimit "Vile me 2,3 kate ne Qeparo në pronë të z. F.P ", u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, në pasurinë Nr.94/30/4 ZK.3095 me status “Ullishte” me sipërfaqe 368 m², e cila bën pjesë në njësinë strukturore HI.UB.20.454 me përdorim UB_Urban, dhe kategori kryesore A_Banim, nënkategori A.3_Zonë Banimi përdorimi miks përdorime të lejuara AR_Aktivitetet sociale dhe rekreative; S.1_Dyqane, Shërbime Personale, Qendra Lokale multifunktionale; S.5_Format e turizmit të Vecantë (ekoturizmi, agroturizmi, turizmi kulturor).

1.1. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës sipas PPV është $K_{shtmax}= 40\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar}= 30.5\%$.

1.2. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max}=0.8$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është $I=0.67$.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.20.454, $K_{shr}=15\%$ dhe $K_{shp}=15\%$, në këtë leje nuk ka asnjë parashikim për plotësimin e këtyre dy treguesve të zhvillimit.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me kufirin e pasurisë në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Objekti në veri nuk plotëson distancën pR 4m me kufirin e pasurisë, pasi kjo distancë është ruajtur 0.66m;

- Objekti në jug nuk plotëson distancën pR 4m me kufirin e pasurisë, pasi kjo distancë është ruajtur mesatarisht 1.5 m;


3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(b) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

- Objekti në perëndim nuk plotëson distancën pR 3 m me trupin e rrugës së propozuar, pasi kjo distancë është ruajtur 1.5 m;

4. Plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin online nuk i ka të dhënat e sipërpërmendura si edhe paraqet statusin e pasurisë “truall” kur sipas certifikatës së pasurisë nr. 94/30/4 ZK.3095, statusi i saj është ‘ullishte’.

5. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, AKM, MZSH Himarë, Bashkia Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 40, Prot.1015/1, datë 01.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z.G.S drejtues i DPZHT dhe F.B për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.43 datë 31.03.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; Për përlogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padR të të vlerave monetare ngarkohet me përgjegjësi z.L.M ; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z.J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



5. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.86, Nr.1429/1 datë 10.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe Leje zhvillimi Vendim Nr. 28, datë 14.10.2020 të KKT për objekt “Godine hotelerie dhe spa “Q ” me vendndodhje Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues shoqëria “Q ” ShPK.


Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN190320220016 me datë 19.03.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.86, Nr.1429/1 datë 10.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Godine hotelerie dhe spa "Q ’ u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:
 - pasuria e regjistruar me dokumentin hipotekor me nr.308 datë 26.06.2019, ZK.1481, me sipërfaqe 3763 m², mbi të cilën ndodhet godina nr.9 me tre kate;
 - dhe pasuria me nr.68/1/1 me sipërfaqe 2031 m² me pronar Këshillin e Sindikatave të Shqipërisë;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.6.177 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori S.2_Zonë Hotelesh dhe përdorime të lejuara S.1_Dyqane, Shërbime Personale, Qendra Lokale Multifunkionale; AR_Aktivitetet sociale dhe rekreative; A.5_Zona me shtëpi të dyta.

1.1. Njësia strukturore HI.UB.6.177 ku propozohet ky objekt parashikon hartimin e PDV. Për këtë njësi është marrë nisma e hartimit të saj, por ende nuk ka një PDV në fuqi, mbi të cilën mund të bazohet dhënia e kësaj Leje Ndërtimi.

1.2. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 30\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 17.2\%$. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.4$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është më i lartë, pasi sipërfaqja e pronës e zënë nga rrugët nuk duhen marrë parasysh në përlllogaritjen e intensitetit të objektit, sipas përcaktimeve të të Nenit 38 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, duke tejkaluar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.



2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(b) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

- Objekti në jug nuk plotëson distancën pR 3.0m me trupin e rrugës;

3. Plani i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin online nuk i ka

të dhënat e sipërpermdura si edhe paraqet objekt 3 kate, për të cilin nuk ka vendimmarrje mbi prishjen e tij, në kundërshtim kjo me legjislacionin në fuqi.

Për prishjen e ndërtimit ekzistues nuk është lëshuar leje ndërtimi e posacme dhe as nuk është përfshirë lejimi i prishjes në lejen e ndërtimit për objektin e ri, veprim i cili ka shkaktuar mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Himarë në vlerën që përftohej nga gjoba që ky zhvillues duhet të paguante për mospajisje me leje për prishjen e objektit ekzistues pR 72m2, duke shkelur parashikimet ligjore në Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 39 pika 1 dhe pika 3, ku përcaktohet se:

1. Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji.

3. Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit.

Në nenin 52 “Kundravajtjet administrative” shkronja ‘e’ përcaktohet se:

e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për

4. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkëndimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga PMNZSH Himarë UK Himarë, ASHK. Bashkia Himarë nuk ka respektuar nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

5. Leja e ndërtimit për këtë objekt është lëshuar në mungesë të pajisjes me Certifikatën paraprake të performancës së energjisë nga AEE, pasi nuk është kryer bashkëndimi me këtë institucion. Bashkia Himarë ka shkelur kërkesat ligjore në zbatim të ligjit Nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave” dhe aktet nënligjore në fuqi, si edhe nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

6. Preventivi i paraqitur për kryerjen e punimeve të këtij objekti është 117’718’661.3 lekë. Subjekti zhvillues në aplikimin në e-leje nuk ka paraqitur oponencën teknike për objektet që kalojnë vlerën 100,000,000 lekë në zbatim të Nenit 6 të Ligjit Nr.8402 dt.10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr.86, Nr.1429/1 datë 10.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Godinë hotelerie dhe spa "Q ’ në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi zj. E.R specialiste e praktikës, z. G.S drejtues i DPZHT, për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.72 prot. datë 26.04.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.

6. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 158, Prot.4678/1, datë 18.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 32, datë 28.12.2020 të KKT për objekt "G , Zona G11, Rezidencial - vila 1, 2 dhe 3 kat dhe kat nentoke (parkim)", ndodhur ne adresen: Gjilekë (Dhrale), në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqeria ‘G ’ sh.p.k, Subjekt ndërtues shoqëria “M ” ShPK.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN141020220026 dhe nr.4678 prot. me datë 14.10.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 158, Prot.4678/1, datë 18.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "G , Zona G11, Rezidencial - vila 1, 2 dhe 3 kat dhe kat nëntoke (parkim)", u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:
 - pasuria me nr. 68/179 ZK.1739, me sipërfaqe 21793 m², me status ‘kullotë’ me pronar G ;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.1.168 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori A.5_Zonë me shtëpi të dyta; S_Shërbime; AR_Aktivitetet sociale dhe rekreative.

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 15\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 16.91\%$ (pa pishina), duke shkelur kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 11$ m, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 13.35$ m, duke mos respektuar lartësinë maksimale të lejuar përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.25$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkalohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 0.27$, duke shkelur kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.4. Sipas përcaktimeve të treguesve të nevojshëm për zhvillimin e kësaj njësie strukturore, HI.UB.1.168, madhësia e parcelës minimale për zhvillim duhej të ishte $K1 = 50'000$ m². Sipërfaqja e vënë në dispozicion për këtë zhvillim është pasuria nr.68/179 me sipërfaqe 21'793 m².


2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(b) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

- Objekti në përdorim nuk plotëson distancën pR 2.5m me trupin e rrugës me gjerësi deri 7m së bashku me trotualet.

3. Plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin në e-leje nuk i paraqet gjithë të dhënat e sipërpërmendura.

4. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 158, Prot.4678/1, datë 18.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.178 prot. datë 03.11.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë



7. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 166, Prot.4720/2, datë 15.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 19, datë 10.06.2021 të KKT për objekt “Strukture 1-5 Kate me 1 kat nentoke, me funksion hoteleri”, ndodhur ne adresen: Rruga e Plazhit, Borsh, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqeria ‘G’, Shoqeria ‘F’ Shpk, Shoqeria ‘A’.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN171020220017 dhe nr.4720 prot. me datë 17.10.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 166, Prot.4720/2, datë 15.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Strukture 1-5 Kate me 1 kat nentoke, me funksion hoteleri”, u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:
 - pasuria me nr. 168/33 Z.K.1253, me sipërfaqe 16863 m², me status ‘arë’;
 - dhe pasuria me nr.92/31 Z.K.1253, me sipërfaqe 1497 m² me status ‘arë’

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore LI.UB.3.342 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori S.2_Zonë Hotelesh dhe përdorime të lejuara S.1_Dyqane, Shërbime Personale, Qendra Lokale Multifunkionale; AR_Aktivitete sociale dhe rekreative.

1.1. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në këtë njësi strukturore është $K_{shtmax}=30\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar}=34\%$ duke tejkaluar dhe mosrespektuar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.2. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max}=1.3$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është $I_{miratuar}=1.03$.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në dR timin veri cila duhet të ishte minimalisht 5m për objektin 4kate dhe është miratuar 2.6m;
- Nuk plotëson distancën në dR timin jugor e cila është propozuar 1.1 m e cila duhet të ishte minimalisht 6.0 m, nga një volum 5 kate;
- Nuk plotëson distancën në dR timin perëndimor e cila është propozuar 1.4 m e cila duhet të ishte minimalisht 3.0 m, nga një volum 3 kate (vilat);

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(b) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

- Objekti në jug nuk plotëson distancën pR 3.0m me trupin e rrugës me gjerësi 10m.

4. Plani i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur ne aplikimin online nuk i ka gjithë të dhënat e sipërpërmendura.

5. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

6. Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 1,343,922,000 lekë.


Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% . Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social kjo taksë në faturën me nr.265 datë 23.11.2022 është përlllogaritur me vlerën 49,306,834.08 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 1,343,922,000 = 53,375,688$ lekë.

Nga subjekti G me faturën e OTP Bank datë 12.12.2022 janë paguar 49,306,834.08 lekë. Vlera e llogaritur në mungesë nga Bashkia Himarë pR **4,068,854 lekë përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.**

Për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ngarkohet me përgjegjësi **z. D.B .**

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 166, Prot.4720/2, datë 15.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT dhe F.B për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.180 prot. datë 08.11.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; Për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padR të të vlerave monetare ngarkohet me përgjegjësi z. D.B ; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z.J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



8. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 157, Prot.4677/1, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 32, datë 28.12.2020 të KKT për objekt "G , Zona G14, Rezidencial - vila 1, 2 dhe 3 kat dhe kat nentoke (parkim)", ndodhur në adresën: Gjilekë (Dhrale), në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqëria 'G' sh.p.k, Subjekt ndërtues shoqëria "M" ShPK

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN141020220024 dhe nr.4677 prot. me datë 14.10.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr.157, Prot.4677/1, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "G , Zona G14, Rezidencial - vila 1, 2 dhe 3 kat dhe kat nentoke (parkim)", u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:
 - pasuria me nr. 68/189 ZK.1739, me sipërfaqe 13'660 m², me status 'kullotë' me pronar G ;


në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bën pjesë në njësinë strukturore HI.UB.1.168 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori A.5_Zonë me shtëpi të dyta; S_Shërbime; AR_Aktivitetet sociale dhe rekreative.

- 1.1.Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 15\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 13.12\%$.
- 1.2.Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 11$ m, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 12.5$ m, duke mos respektuar lartësinë maksimale të lejuar përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.
- 1.3.Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.25$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet është $I_{max.miratuar} = 0.21$.
- 1.4.Sipas përcaktimeve të treguesve të nevojshëm për zhvillimin e kësaj njësie strukturore, HI.UB.1.168, madhësia e parcelës minimale për zhvillim duhej të ishte $K1 = 50'000$ m². Sipërfaqja e vënë në dispozicion për këtë zhvillim është pasuria nr.68/189 me sipërfaqe 13'660 m².

2. Plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin në e-leje nuk i paraqet gjithë të dhënat e sipërpërmendura.

3. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkëndimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr. 157, Prot.4677/1, datë 02.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.178 prot. datë 03.11.2022 me lëndë: "Raport i Vlerësimit Teknik"; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



9. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 26, Prot.234/1, datë 11.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 18, datë 13.08.2021 të KKT për objekt “2 Banesa individuale 2 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë”, ndodhur në adresën: Gjilekë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me zhvillues V.G , G.G , M.H dhe Subjekt ndërtues shoqëria “A ” ShPK.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m2, aplikuar me nr.1012-2022 prot. me datë 24.02.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 26, Prot.234/1, datë 11.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “2 Banesa individuale 2 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë”, u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuritë:

- pasuria me nr. 74/29 ZK.1739, me sipërfaqe 520 m2, me status ‘ullishte’ vërtetuar me vërtetimin hipotekor nr.271 datë 27.08.2020 në pronësi të V.G dhe G.G ;
- dhe pasuria me nr.74/29/1 Z.K.1739, me sipërfaqe 394 m2 me status ‘ullishte’ paraqitur me vërtetimin hipotekor nr.270 datë 27.08.2020 në pronësi të M.H ;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.6.1082 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore A_Banim, Nënkategori A.5_Zona me shtëpi të dyta dhe përdorime të lejuara S.2_Zonë Hotelesh dhe përdorime të lejuara S.3_ Zonë Turizmi e Integruar:

1.1. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në këtë njësi strukturore është $K_{shtmax}=40\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar}=25.6\%$;

1.2. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max}=0.4$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është $I_{miratuar}=0.42$ duke tejkalar dhe mosrespektuar kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë;

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Nuk plotëson distancën në dR timin parëndimor për vilën A e cila duhet të ishte minimalisht 3m për objektin 2kate dhe është miratuar 2.5m;

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(b) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

b) për gjerësi rruge, përfshirë trotuaret, 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) metra, distanca minimale është 3 (tre) metra;

Objekti Vila A nuk plotëson distancën pR 3.0m me trupin e rrugës në projekt me gjerësi 9m së bashku me trotuaret.

4. Mungon plani i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, i cili duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare.

5. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

6. Bazuar në planin e vendosjes së infrastrukturës i cili azhurnohet para lëshimit të 4 lejes së zhvillimit, nga UK Himarë është shënuar se zona nuk disponon rrjet kanalizimesh ujërash të ndotura. Në projektin e instalimeve Hidrosanitare nuk ka asnjë përcaktim nga projektuesi se si do të realizohet shkarkimi i ujërave të zeza. Pra leja është lëshuar pa infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e banesave, në kundërshtim me Nenin 45 të Ligjit 107/204 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar.

7. Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 22,581,007 lekë.

Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% ose 4% e vlerës së përlllogaritur sipas çmimit të referencës bazuar në Udhëzimit Nr.3 datë 28.12.2016 të EKB e cila për qarkun Vlorë është 32’508 lekë/m² (përzgjidhet vlera më e lartë mes të dyjave. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.20 datë 11.03.2022 është përlllogaritur me vlerën 857,007.99 lekë.


Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 22'581'007 = 903,240$ lekë.

Po të llogaritet me çmimin e EKB kjo vlerë del $4\% * 32508 * 380 \text{ m}^2 = 494,121,6$ leke.

Nga subjekti “A ” sh.p.k me faturën e T datë 11.03.2022 janë paguar 875,007,99 lekë. Vlera e llogaritur në mungesë nga Bashkia Himarë pR **28,232,01 lekë përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.**

Për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ngarkohet me përgjegjësi z. S.K .

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 26, Prot.234/1, datë 11.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.28 prot. datë 11.03.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; Për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejte të të vlerave monetare ngarkohet me përgjegjësi z. S.K ; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z.J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



10. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 30, Prot.1012/1, datë 24.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 17, datë 13.07.2021 të KKT për objekt “4 Objekte banimi 4 kate me 1 kat parkimi nëntokë”, ndodhur në adresën: Potam, në territorin e Bashkisë Himarë, me zhvillues Shoqëria "A " shpk, R.D .

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me nr.1012-2022 prot. me datë 24.02.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 30, Prot.1012/1, datë 24.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “4 Objekte banimi 4 kate me 1 kat parkimi nëntokë”, u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:

- pasuria me nr. 398/31/3 ZK.1952, me sipërfaqe 7500 m², me status ‘arë-pemtore-ullishte’ vërtetuar me vërtetimin hipotekor nr.490 datë 30.12.2020 lëshuar me date 03.09.2021 në pronësi të DH.B ;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bën pjesë në njësinë strukturore HI.UB.13.437 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore A_Banim, Nënkategori A.5_Zona me shtëpi të dyta dhe përdorime të lejuara S.5 - Format turizmi të Vecantë (ekoturizmi, agroturizmit, turizmi kulturor).

1.1. Kjo njësi strukturore zhvillohet me PDV, sipas përcaktimeve të PPV Bashkia Himarë miratuar me Vendimin Nr.2 datë 16.10.2017 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Himarë”, ndërsa kjo leje është lëshuar në mungesë të hartimit të planit të detajuar vendor.

1.2. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në këtë njësi strukturore është $K_{shtmax}=50\%$, ndërsa koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar}=22.2\%$;

1.3. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max}=0.8$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është $I_{miratuar}=0.78$.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Objekti B nuk plotëson distancën nga veriu, e cila për objekt 4 kate duhet të jetë minimalisht 6.0m nga kufiri i pasurisë;

- Objekti D nuk plotëson distancën në dR timin lindor distance kjo që duhej të ishte 6.0.m dhe jo 5.4 siç është propozuar në këtë leje ndërtimi.

3. Dokumenti i cili ka shërbyer si dokument që provon të dR tat mbi pasurinë, është vërtetimi hipotekor nr.490 datë 30.12.2020 lëshuar me datë 03.09.2021 në pronësi të DH.B , i cili ashtu siç edhe shkruhet në të, nuk provon regjistrimin e pasurisë 398/31/3 Z.K 1952 në regjistrin e pasurive të paluajtëshme. Pra, lëshimi i lejes së ndërtimit pa një certifikatë pasurie përbën shkelje të hapur ligjore.

4. Planvendosja e miratuar nga Bashkia Himarë nuk ka të evidentuara dimensionet e distancave të objekteve nga pasuria, nga rrugët si dhe të distancave të objekteve nga njëri-tjetri, si edhe dimensionet e kufirit të pasurisë.

5. Leja e ndërtimit e miratuar me Vendimin Nr. 30, Prot.1012/1, datë 24.03.2022, ka parametra të tjerë ndryshuar zhvillimi, nga Leja e zhvillimit e miratuar nga KKT me Vendim Nr. 17, datë 13.07.2021, në kundërshtim me përcaktimet ligjore Neni 15 pika 1/1 e VKM Nr.408, datë 13.05.2015, sipas të cilit:

Neni 15 pika 1/1.Projekti i ndërtimit hartohet konform kushteve të përcaktuara në lejen e zhvillimit/dokumentet e planifikimit dhe në bazë të tij lëshohet leja e ndërtimit. Në varësi të llojit të ndërtimit, projekti përmban:

6. Plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, i cili duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Këto të dhëna mungojnë në planin e rievimit të paraqitur në këtë aplikim në e-leje.

7. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit **Vendim Nr. 30, Prot.1012/1, datë 24.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë** në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.29 prot. datë 11.03.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



11. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 39, Prot.1014/1, datë 01.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 43, Prot. 1570/1 datë 15.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Vilë me 2,3 kate në Qeparo në pronë të z. A.SH ", Qeparo, në territorin e Bashkisë Himarë, me zhvillues A.SH.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe deri në 250m², aplikuar me nr.1014-2022 prot. me datë 03.03.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 39, Prot.1014/1, datë 01.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Vilë me 2,3 kate në Qeparo në pronë të z. A.SH ", u konstatua se:

- Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:
- pasuria me nr. 94/30/5 ZK.3095, me sipërfaqe 365 m², me status 'ullishte' vërtetuar me certifikatën e regjistrimit të pronës në pronësi të A.SH ;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bën pjesë në njësinë strukturore HI.UB.20.454 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore A_Banim, Nënkategori A.3_Zona banimi përdorimi mik.

1.1. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në këtë njësi strukturore është $K_{shtmax} = 40\%$, ndërsa koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 30.5\%$;

1.2. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.8$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është $I_{miratuar} = 0.67$.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specififikisht:

Objekti nuk plotëson distancën nga veriu, e cila për objekt 3 kate duhet të jetë minimalisht 4 m nga kufiri i pasurisë;

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(b) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specififikisht:

b) për gjerësi rruge, përfshirë trotualet, 7 (shtatë) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) metra, distanca minimale është 3 (tre) metra;

1. Objekti nuk plotëson distancën pR 3.0m me trupin e rrugës në projekt në pjesën jugore e cila ka gjerësi 13m së bashku me trotualet;

2. Objekti nuk plotëson distancën pR 2.5m me rrugën në perëndim të objektit të miratuar.

4. Mungon plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr.408, datë 13.05.2015, i cili duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare.

5. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 39, Prot.1014/1, datë 01.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.42 prot. datë 31.03.2022 me lëndë: "Raport i Vlerësimit Teknik"; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.

1.1. Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës në këtë njësi strukturore është $K_{shtmax} = 80\%$, ndërsa koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 48\%$;



Figure 5, 6 pamje 3-dimensionale e objektit të ri

Figure 1 Fragment nga Relacioni Arkitektonik

Treguesit e zhvillimit

Sipërfaqja e truallit që zhvillohet:	300 m ²
Sipërfaqja e truallit të zënë nga struktura:	126.1 m ²
Koeficienti i shfrytëzimit	48%
Sipërfaqja totale e ndërtimit mbi tokë	195.75 m ²
Lartësia maksimale e strukturës	6.9 m
Sipërfaqja e gjelber dhe rekreative	95 m ²
Intensiteti	0.59

1.2. Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.6$, ndërsa Intensiteti i miratuar me këtë leje është $I_{miratuar} = 0.65$. Edhe pse në planvendosje sipërfaqja totale e ndërtimit është vendosur sipërfaqe totale e ndërtimit mbi tokë 176.4 m², sipas relacionit arkitektonik të hartuar nga Ark. Aldor Karaja sipërfaqja e ndërtimit mbi tokë është shënuar 195.75 m². Ky falsifikim në bashkëpunim i vlerave të sipërfaqes totale të ndërtimit mbi tokë me qëllim justifikimin e lëshimit të kësaj leje ndërtimi përbën kundravajtje.

perëndimi, e cila për objekt 1 kat duhet të jetë minimalisht 2 m nga kufiri i pasurisë;

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(a) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

b) për gjerësi rruge, përfshirë trotuaret deri 7 (shtatë) metra, distanca minimale është 2.5 metra;

Objekti nuk plotëson distancën pR 2.5 m me trupin e rrugës në pjesën lindore;

4. Dokumenti i cili ka shërbyer si dokument që provon të dR tat mbi pasurinë, është vërtetimi hipotekor vërtetim hipotekor me nr.4215 dt.12.04.2021, në emër të V.A , dhe lënë në përdorim të “U” sh.p.k, i cili ashtu siç edhe shkruhet në të, nuk provon regjistrimin e pasurisë pa numër pasurie ZK.2806, me sipërfaqe 300 m², me status ‘truall’ dhe banesë 1 kt. me sipërfaqe 63.2 m² në regjistrin e pasurive të paluajtëshme. Pra, lëshimi i lejes së ndërtimit pa një certifikatë pasurie përbën shkelje të hapur ligjore.

5. Plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr.408, datë 13.05.2015 duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në këtë aplikim nuk i ka të dhënat e nevojshme për shqyrtimin e këtij propozimi.

6. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, Bashkia Himarë nuk ka respektuar legjislacionin për zhvillimin e territorit, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit **Nr. 160, Prot.4286, datë 22.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë** në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.57 prot. datë 03.11.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë

Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.

13. Leje ndërtimi për ndryshim projekti gjatë ndërtimit miratuar me Vendim Nr. 151, Prot.3678/1, datë 10.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 27, datë 14.10.2020 të KKT për objekt “Struktura me funksion apart-hotel 1 dhe 2 kat, parkim dhe ambiente ndihmëse nëntokë, Drimadhë, Bashkia Himarë” ndodhur në Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues F.D , Subjekt ndërtues shoqëria “GJ” ShPK.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit për ndryshimin e projektit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN150820220015 dhe nr.3678 prot. me datë 23.09.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Vendim Nr. 151, Prot.3678/1, datë 10.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për ndryshime në projekt gjatë ndërtimit të objektit “Struktura me funksion apart-hotel 1 dhe 2 kat, parkim dhe ambiente ndihmëse nëntokë”, u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi: pasuria me nr. 36/2 ZK.1739, vol.2, fq.186 Z.K.1739 me sipërfaqe 1970 m² në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bën pjesë në njësinë strukturore HI.UB.3.1191 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori S.2_Zonë Hotelesh/Shërbime Turistike:

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.1191, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 25\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 29.1\%$, duke shkelur kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.1191, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.4$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkalohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 0.54$, duke shkelur kështu përcaktimet e dokumentit të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit në Bashkinë Himarë.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të nevojshëm për zhvillimin e kësaj njësie strukturore, HI.UB.3.1191, Kjo njësi duhej të zhvillohej pas hartimit dhe miratimit të një PDV-je. Për këtë njësi nuk ka PDV të miratuar, duke shkelur kështu përcaktimet e PPV së Bashkisë Himare.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

Objekti nuk plotëson distancën nga lindja, e cila për objekt 2 kat duhet të jetë minimalisht 3 m nga kufiri i pasurisë. Kjo distance është 0m.

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga objekte në zbatim të Nenit 36 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:


Objektet 2 katëshe nuk plotësojnë distancën nga njera-tjetra pR 4m.

4. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(a) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

Objekti në përfundim nuk plotëson distancën pR 2.5m me trupin e rrugës me gjerësi deri 7m së bashku me trotualet.

Objekti nuk plotëson distancën në jug me trupin e rrugës nga ballkoni e cila konsiderohet si faqe ndërtimi. Distanca është mbajtur 2.0 dhe duhej të ruhej 3.0m.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 87, Prot.2022/1, datë 22.09.2021 dhe Vendim Vendim Nr. 151, Prot.3678/1, datë 10.11.2022 në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.152 prot. datë 13.10.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



14. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 09, Prot.328, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 12, datë 24.11.2021 të KKT për objekt "Strukturë hotelerie 2 kate me 2 kate nëntokë, me vendndodhje në shëtitoren Qeparo, Bashkia Himarë", ndodhur ne adresen: Protopape, Fshati Qeparo Fushë në Territorin e Bashkisë Himarë, me Subjekt Zhvillues S.K Person Fizik.

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN231220220072 dhe nr.5658 prot. me datë 29.12.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 09, Prot.328, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "Strukturë hotelerie 2 kate me 2 kate nëntokë, me vendndodhje në shëtitoren Qeparo, Bashkia Himarë", u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuritë:
 - pasuria me nr. 105/107/1 ZK.3095, me sipërfaqe 105 m², me status ‘truall’ me pronar S.K ; pasuria me nr. 105/107/1 ZK.3095, me sipërfaqe 105 m², me status ‘truall’ me pronar S.K ;
 - pasuria me nr. 105/118/1 ZK.3095, me sipërfaqe 58 m², me status ‘truall’ me pronar M S.K ;
 - pasuria me nr. 105/120/1 ZK.3095, me sipërfaqe 84 m², me status ‘truall’ me pronar S.K ;
 - pasuria me nr. 105/108 ZK.3095, me sipërfaqe 300 m², me status ‘truall’ mbi të cilën ndodhet ndërtesë me sip.53.81m² me pronar S.K ;
 - pasuria me nr. 105/107 ZK.3095, me sipërfaqe 250 m², me status ‘truall’ mbi të cilën ndodhet ndërtesë me sip.138m² me pronar S.K ;
 - pasuria me nr. 105/118 ZK.3095, me sipërfaqe 250 m², me status ‘truall’ mbi të cilën ndodhet ndërtesë me sip.124m² me pronar M S.K ;
 - pasuria me nr. 105/120 ZK.3095, me sipërfaqe 250 m², me status ‘truall’ mbi të cilën ndodhet ndërtesë me sip.223m² me pronar S.K ;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.20.560 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore A_Banim, Nënkategori A.4_Zona Banimi; Përdorime të lejuara A.5_Zonë me shtëpi të dyta; S.5_ Format e turizmit të vecante (ekoturizmi, agroturizmi, turizmi kulturor). Përdorime të ndaluara: S.2_Zonë Hotelesh/Shërbime Turistike; S.3_Zonë Turizmi e Integruar (Resorte/Vila); IE_Industri dhe Ekonomi.

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.20.560 përdorimi i lejuar për këtë njësi është banimi, kurse përdorimi hoteleri, sic është miratuar në këtë leje ndërtimi është i ndaluar. Pra janë shkelur përcaktimet e PPV Bashkia Himarë miratuar me Vendim nr.2 të K.K.T-se me date 16.10.2017 i rishikuar.

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.20.560, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 40\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 40\%$ (pa pishina).

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.20.560, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 8$ m, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 12$ m nga terreni i sistemuar, duke mos respektuar lartësinë maksimale të lejuar përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.

1.4. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.20.560, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.8$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkalohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 0.8$.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

- Objekti nuk plotëson distancën nga lindja, e cila për objekt 2 kat duhet të jetë minimalisht 3 m nga kufiri i pasurisë. Kjo distance është miratuar 1.13m.
- Objekti nuk plotëson distancën nga perëndimi, e cila për objekt 2 kat duhet të jetë minimalisht 3 m nga kufiri i pasurisë. Kjo distance është miratuar 2.0 m.

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me trupin e rrugës në zbatim të Nenit 36 pika 3(a) të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Objekti në jug (streha) nuk plotëson distancën pR 2.5m me trupin e rrugës(pedonale) me gjerësi deri 7m.

4. Mungon plani i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015, i cili duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare.

5. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

6. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Ligjin Nr.124/2015 “Për Eficencën e Energjisë”, Urdhërin Nr. 5, datë 12.01.2021, Ligjin Nr. 116/2016 për Efiçencën e Energjisë në Ndërtesa dhe VKM Nr.537, datë 08.07.2020, pasi nuk është marrë konfirmimi i Agjencisë për Efiçencën e Energjisë dhe objekti nuk është pajisur me Certifikatën e Performancës së Energjisë.

7. Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 78,978,883.53 lekë.

Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me


vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% . Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlloraget duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social kjo taksë në faturën me nr.257 datë 17.01.2023 është përlloragitur me vlerën 2,984,585.49 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 78,978,883.53 = 3,159,155.34$ lekë.

Nga subjekti S.K me faturën e O. Bank datë 18.01.2023 janë paguar 2,984,585.49 lekë. Vlera pR **174,569.85** lekë e llogaritur nga Bashkia Himarë **përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.**

Për përlloragitjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ngarkohet me përgjegjësi z. D.B .

Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr. 09, Prot.328, datë 19.01.2023të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.008 prot. datë 18.01.2023 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; Për përlloragitjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejte të të vlerave monetare ngarkohet me përgjegjësi z. D.B ; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë



15. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 127, Prot.3310/1, datë 05.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 32, datë 28.12.2020 të KKT për objekt "G , Z , R " , ndodhur ne adresen: Palasë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqeria "S " dhe Subjekt Ndërtues shoqëria "A " sh.p.k

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m2, aplikuar me AN070720220038 dhe nr.4678 prot. me datë 14.10.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 127, Prot.3310/1, datë 05.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt "G , Z , R " , u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:
 - pasuria me nr. 68/172 Z.K.1739, dhe pasuria me nr.68/173 Z.K.1739 në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.1.168 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori A.5_Zonë me shtëpi të dyta; S_Shërbime; AR_Aktivite sociale dhe rekreative.

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 15\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 12.9\%$ (pa pishina).

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 11$ m, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 13.35$ m, duke mos respektuar lartësinë maksimale të lejuar përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.25$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkalohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 0.25$.

1.4. Sipas përcaktimeve të treguesve të nevojshëm për zhvillimin e kësaj njësie strukturore, HI.UB.1.168, madhësia e parcelës minimale për zhvillim duhej të ishte $K1 = 50'000$ m². Sipërfaqja e vënë në dispozicion për këtë zhvillim është pasuria me nr. 68/172 Z.K.1739, dhe pasuria me nr.68/173 Z.K.1739 me sipërfaqe 18476.8 m².

2. Plani i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin në e-leje nuk i paraqet gjithë të dhënat e sipërpërmendura.

3. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar.

4. Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 197'641'383 lekë.

Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% . Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.92 datë 16.09.2022 është përllogaritur me vlerën 7,765,636.37 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 197,641,383 = 7,905,655.32$ lekë.

Nga subjekti S 1 me faturën e R datë 05.10.2022 janë paguar 7,765,636.37 lekë. Vlera pR **140,018.95 lekë përbën të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë.**

Për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ngarkohet me përgjegjësi z. D.B .

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr. 127, Prot.3310/1, datë 05.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.149 prot. datë 04.10.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; Për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejte të të vlerave monetare ngarkohet me përgjegjësi z. D.B ; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



16. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 147, Prot.2648/1, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 16, datë 13.07.2021 të KKT për “Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2 dhe 3 kat me 3 kat nëntokë dhe pishinë”, ndodhur ne adresen: Gjilekë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues dhe ndërtues Shoqeria "B " .

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN280520220023 dhe nr.2648 prot. me datë 28.05.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Nr. 147, Prot.2648/1, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2 dhe 3 kat me 3 kat nëntokë dhe pishinë” u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi:

- pasuria me nr. 68/400/2 Z.K.1739, me status ‘arë’, sipërfaqe 2000m², në pronësi të arben Muçobega

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.3.169 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbim, nënkategori S.2_Zonë hotelesh/Shërbime turistike; Përdorime të lejuara: A.5_Zonë me shtëpi të dyta; S_Shërbime; AR_Aktivitete sociale dhe recreative; S.1_Dyqane, Shërbime personale.

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.169, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 25\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 34.2\%$ (me pishinë) duke tejkalluar përcaktimet e PPV Bashkia Himarë.

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.3.169, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 11$ m, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 11.20$ m, duke mos respektuar lartësinë maksimale të lejuar përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.1.168, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.4$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkallohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 0.94$, duke shkelur detyrimin ligjor të përcaktuar nga PPV Bashkia Himarë.

2. Plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin në e-leje nuk i paraqet gjithë të dhënat e sipërpërmendura.

3. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

4. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Ligjin Nr.124/2015 “Për Eficencën e Energjisë”, Urdhërin Nr. 5, datë 12.01.2021, Ligjin Nr. 116/2016 për Efiçencën e Energjisë në Ndërtesa dhe VKM Nr.537, datë 08.07.2020, pasi nuk është marrë konfirmimi i AEE dhe objekti nuk është pajisur me Certifikatën e Performancës së Energjisë.

5. Për lëshimin e kësaj leje ndërtimi janë tejkaluara afatet ligjore për shqyrtimin e aplikimit sipas përcaktimeve të VKM 408/2015 i ndryshuar.


6. Përsa i përket pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për këtë objekt është paraqitur preventivi me vlerë 190,000,951 lekë.

Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% . Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe social kjo taksë në faturën me nr.90 datë 16.09.2022 është përllogaritur me vlerën 7,570,581.62 lekë.

Vlera pR 29,457.04 lekë përbën të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë.

Për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë mos arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë ngarkohet me përgjegjësi **z. D.B .**

Për miratimin e lejes së ndërtimit **Vendim Nr. 147, Prot.2648/1, datë 02.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë** në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi **z. G.S drejtues i DPZHT** për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.149 prot. datë 04.10.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; Për përllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejte të të vlerave monetare ngarkohet me përgjegjësi **z. D.B ;** ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë **Z. J.G** në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



17. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.48, Prot.1717, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 36, datë 03.12.2020 të KKT për “Objekt

hoteleri dhe shërbime 5 kat me 1 kat nëntokë”, ndodhur ne adresen: Himarë, me zhvillues A.G , M.G , K.G, A.R dhe J.R dhe ndërtues Shoqeria "A "ShPK

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN011220210048 dhe nr.1717 prot. me datë 01.03.2022 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Vendim Nr.48, Prot.1717, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Objekt hoteleri dhe shërbime 5 kat me 1 kat nëntokë” u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuritë:
 - pasuria pa numër pasurie Z.K.1952, me status ‘truall + godinë’, sipërfaqe 105 godinë m² dhe 151.38 truall, në pronësi të N.G ;
 - pasuria pa numër pasurie Z.K.1952, me status ‘truall’, sipërfaqe 282.5 m² truall, në pronësi të A.R;
 - pasuria pa numër pasurie Z.K.1952, me status ‘truall’, sipërfaqe 414 truall, në pronësi të J.R;
 - pasuria pa numër pasurie Z.K.1739, me status ‘truall’, sipërfaqe 284.5 m² truall, në pronësi të K.G;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.13.279 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore A_Banim, nënkategori A.2_Zonë Banimi në qendrën e qytetit; Përdorime të lejuara: S.2_Zonë Horelesh/Shërbime Turistike; AR_Aktivitetet sociale dhe rekreative; S.1_Dyqane, Shërbime personale; AS_Arsim.

1.1.Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.13.279, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokës është $K_{shtmax} = 60\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 29.9\%$.

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.13.279, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 18$ m, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 20.45$ m, duke mos respektuar lartësinë maksimale të lejuar përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.13.279, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 1.2$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkalohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 1.52$, duke shkelur detyrimin ligjor të përcaktuar nga PPV Bashkia Himarë.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015, specifikisht:

- Objekti nuk plotëson distancën nga Veriu, e cila për objekt 5 kat duhet të jetë minimalisht 6 m nga kufiri i pasurisë. Kjo distance është miratuar 3.6m.
- Objekti nuk plotëson distancën nga Jugu, e cila për objekt 5 kat duhet të jetë minimalisht 6 m nga kufiri i pasurisë. Kjo distance është miratuar 3.0 m.
- Objekti nuk plotëson distancën nga Jugperëndim, e cila për objekt 5 kat duhet të jetë minimalisht 6 m nga kufiri i pasurisë. Kjo distance është miratuar 1.7 m.

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me objektet kufitare në zbatim të Nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Objekti në jug nuk plotëson distancën pR 9m me objektet 2 katëshe;
- Objekti nuk plotëson distancën pR 8m me objektin 1 kat në veriperëndim.

4. Dokumentat që kanë shërbyer si dokument që provon të drejtat mbi pasurinë, janë vërtetime hipotekore dhe një akt trashëgimie. Pra, lëshimi i lejes së ndërtimit pa një çertifikatë pasurie përbën shkelje të hapur ligjore.

5. Plani i rilevimit të pronës në zbatim të nenit 10 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin në e-leje nuk i paraqet gjithë të dhënat e sipërpërmendura.

6. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr.48, Prot.1717, datë 02.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.34 prot. datë 29.03.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”.



18. Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr.54, Prot.1845, datë 13.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 35, datë 03.12.2020 të KKT për “Strukturë Shërbimi Hoteleri me 3, 4 Dhe 5 Kate mbi tokë dhe 1 Kat nëntokë”, ndodhur ne adresen: Borsh, në territorin e Bashkisë Himarë, me zhvillues “G ” sh.p.k dhe “E ” ShPK

Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250m², aplikuar me AN041120210078 dhe nr.1845 prot. me datë 04.12.2021 për të cilën është marrë vendimi për miratim me Vendim Nr.54, Prot.1845, datë 13.04.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “Strukturë Shërbimi Hoteleri me 3, 4 dhe 5 Kate mbi tokë dhe 1 Kat nëntokë” u konstatua se:

1. Kjo leje është miratuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Himarë, miratuar me Vendim të KKT-së nr.2 datë 16.10.2017, i rishikuar, pasi pasuritë:
 - pasuria Nr.265/7/1 Vol.19, fq.182, Z.K.1253, me status ‘pemtore’, sipërfaqe 1240m², në pronësi të Shoqërisë G sh.p.k;
 - pasuria Nr.265/1/1 Vol.19, fq.180, Z.K.1253, me status ‘pemtore’, sipërfaqe 825m², në pronësi të Shoqërisë G sh.p.k;
 - pasuria Nr.265/1/2 Vol.19, fq.181, Z.K.1253, me status ‘pemtore’, sipërfaqe 53m², në pronësi të Shoqërisë G sh.p.k;

- pasuria Nr.265/7/2 Vol.19, fq.183, Z.K.1253, me status ‘pemtore’, sipërfaqe 260m², në pronësi të Shoqërisë G sh.p.k;
- pasuria Nr.265/2 Vol.11, fq.89, Z.K.1253, me status ‘pemtore’, sipërfaqe 1100m², në pronësi të shoqërisë G sh.p.k;
- pasuria Nr.268/3 Vol.13, fq.148, Z.K.1253, me status ‘pemtore’, sipërfaqe 1400m², në pronësi të ‘E’ sh.p.k;
- pasuria Nr.268 Vol.11, fq.110, Z.K.1253, me status ‘pemtore’, sipërfaqe 500m², në pronësi të N.XH ;

në të cilën zhvillohet ky projekt propozim, bëjnë pjesë në njësinë strukturore HI.UB.6.1083 me përdorim UB-Urban, dhe kategori kryesore S_Shërbime, nënkategori S.2_ Zonë Horelesh/Shërbime Turistike; Përdorime të lejuara: AR_Aktivitete sociale dhe rekreative; S.1_ Dyqane, Shërbime personale; A.5_Zona me shtëpi të dyta.

1.1. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.6.1083, Koeficienti maksimal i lejuar i shfrytëzimit të tokë sipas dokuemntit vendor të planifikimit është $K_{shtmax} = 30\%$, ndërsa Koeficienti i shfrytëzimit i miratuar me këtë leje është $K_{shtmiratuar} = 43.1\%$ duke tejkalluar kështu përcaktimet e PPV Bashkia Himarë.

1.2. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.6.1083, lartësia maksimale e lejuar është $H_{max} = 11m$, ndërsa miratimi $H_{max.miratuar} = 21.25 m$, duke mos respektuar lartësinë maksimale të lejuar përcaktuar nga dokumenti vendor i planifikimit.

1.3. Sipas përcaktimeve të treguesve të zhvillimit për njësinë strukturore HI.UB.6.1083, Intensiteti maksimal i lejuar i ndërtimit është $I_{max} = 0.4$, ndërsa në lejen e miratuar ky intensitet tejkallohet duke u miratuar $I_{max.miratuar} = 1.19$, duke shkelur detyrimin ligjor të përcaktuar nga PPV Bashkia Himarë.

2. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane nga kufiri i pronës në zbatim të Nenit 35 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Objekti nuk plotëson distancën nga Veri-Lindja, e cila për objekt 5 kat duhet të jetë minimalisht 6 m nga kufiri i pasurisë. Kjo distancë është miratuar 4.4 m, ndërsa për volum 4 kat kjo distancë duhet të ishte minimalisht 5m, ndërkohë është miratuar me anë të këtij vendimi 4.4m.

3. Objekti i miratuar nuk plotëson distancat urbane të objektit me objektet kufitare në zbatim të Nenit 34 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” të ndryshuar, specifikisht:

- Objekti i miratuar me këtë leje nuk plotëson distancën në juglindje me objektin kufitar 4 kate. Kjo distancë duhet të ishte minimalisht 10 m, ndërkohë distanca e miratuar me vendimin Nr.54, Prot.1845, datë 13.04.2022 është 5.78m;

- Objekti nuk plotëson distancën pR 6 m me objektin 1 kat në jugperëndim. Kjo distancë me miratimin e lejes së ndërtimit me vendim nr.54 datë 13.04.2022 është 4.2 m.

4. Plani i rievimit të pronës në zbatim të nenit 10 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, duhet të paraqesë infrastrukturën rrugore, dimensionet e konturit të pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Plani i paraqitur në aplikimin në e-leje nuk i paraqet gjithë të dhënat e sipërpërmendura.

5. Kjo leje, është lëshuar në mungesë të bashkërendimit dhe marrjes së informacionit/pëlqimit nga UK Himarë, ASHK, PMNZSH Himarë, konkretisht nenin 21 pika 6 të VKM 408 datë 13.05.2015

6. Për lëshimin e kësaj leje ndërtimi janë tejkaluar afatet ligjore për shqyrtimin e aplikimit sipas përcaktimeve të VKM 408/2015 i ndryshuar.

Për miratimin e lejes së ndërtimit Vendim Nr.54, Prot.1845, datë 13.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë Himarë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ngarkohet me përgjegjësi z. G.S drejtues i DPZHT për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.33 prot. datë 29.03.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”; ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Himarë Z. J.G në zbatim të nenit 29 pika a) e ligjit 107/2014 të ndryshuar, për vendimmarrjen e jashtëligjshme lidhur me aplikimin për leje ndërtimi në territorin administrativ të Bashkisë Himarë.



II.2.7 “Të tjera të dalta gjatë auditimit”

2.7.1 Shqyrtim Ankese

Me ankesën e banorëve të Fshatit Vranisht.

Ankesa lidhet me problematikën e furnizimit me ujë të shtëpive të fshatit Franisht, pas marrjes në dorëzim nga Bashkia Himarë të investimit për ujësjellësin e ri të fshatit, për të cilin pretendohet se nuk furnizohen me ujë për 24 orë, si dhe disa familje të cilat janë mbi kuotën e depozitave të ujësjellësit nuk kanë ujë edhe për shkak të mos pasjes së energjisë elektrike për stacionin e pompave të cilat mundësojnë çuarjen e ujit nëpër familje.

Pavarësisht mos vënies në dispozicion të dokumentacionit të projektzbatimit dhe të zbatimit të kontratës së punimeve për rikonstruksionin e ujësjellësit të Fshatit Vranisht, duke u bazuar në dokumentacionin e përfshirë në realizimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet se:

Projektpreventivi i ndërtimit të ujësjellësit të Fshatit Vranisht është hartuar nga z. K.K (inxhinier hidroteknik) me licencë H/T/0103/5, z. F.B (inxhinier hidroteknik) me licencë K.2590 dhe z. S.N (inxhinier hidroteknik).

Bazuar në termat e referencës, hartuar nga z. E.M (qëllimi i projektit) rezulton se ujësjellësi ekzistues përbëhet vepra e marrjes në kuotën 432 m m.n.d, nga depo ekzistuese në kuotën 409 m m.n.d, rrjeti kryesor që lidhe veprën e marrjes me depon me tubacion me diametër 110 mm dhe rrjeti shpërndarës me dimension nga 110 mm deri 20 mm.

Në termat e referencës është kërkuar:

-Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë për furnizimin me ujë sipas detyrës së projektimit dhe të konsultohet me njësinë e qeverisjes vendore, sh.a. ujësjellësin, KESH e Telekomin.

- Të merren për bazë dhënat e prurjeve dhe volumit të ujit për të përballuar kërkesën për ujë të zonave.

- Cilësia e studim projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të plotësojë kushtet e projektimit.

- Do të trajtohet ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit *për gjithë zonën e fshatit*, depo e re, vepër marje e re në burim, linja e trasmetimit nga burimi në depo dhe rrjetet shpërndarës nga depo e ujit deri në banesë.

Nga auditimi i dokumentacionit të projektit të zbatimit (i disponueshëm në sistemin elektronik të prokurimeve dhe verifikimit në objekt), rezulton se depo e re me kapacitet 100 m³ është ndërtuar ngjitur me atë ekzistuese. Për pasojë disa banesa kanë dalë jashtë skemës së furnizimit me ujë. Ky veprim është në kundërshtim me termat e referencës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Nga ana e bashkisë si përfituese e projektit nuk është verifikuar dokumentacioni i projektit nëse përmbush apo jo kërkesat e përcaktuara në termat e referencës si dhe realizimi i kushteve teknike të projektit.

Kontrata e punimeve civile “Ndërtim ujësjellës Fshati Vranisht, është nënshkruar me datë 10.08.2021, me BOE “K ” SHPK. Nxjerrja jashtë skemës së furnizimit për disa banesa ka krijuar problematika me banorët e zonës gjatë zbatimit të kontratës. Duke qenë se pozicionimi i këtyre banesave është në kuotë më të lartë se edhe depo e vjetër, furnizimi me ujë i tyre duhet të jetë bërë nëpërmjet lidhjeve me rrjetin kryesor të furnizimit. Për këtë arsye është miratuar ndryshimi i projektit, duke përfshirë realizimin e një depoje të re me kapacitet 12 m³, në një kuotë më të lartë e cila do furnizohet nga depo e re 100 m³, nëpërmjet një sistemi pompimi. Kjo depo furnizon banesat jashtë skeme me rrjedhje të lirë.

Bazuar në pretendimet e banorëve të cilët nuk lidhen drejtpërdrejtë nga depo 100 m³, varësia e furnizimit nga energjia elektrike ka krijuar problematikën e ndërprerjes së furnizimit në raste të ndërprerjes së energjisë elektrike, po ashtu ka ankesa në lidhje me funksionimin e pompës.

Për furnizimin me ujë të depos 12 m³, është vendosur një pompë. Mungesa e një sistemi automatik i furnizimit me ujë si dhe mungesa e një gjeneratori të lidhur në mënyrë automatike, nuk jep garanci për furnizim në mënyrë të vazhdueshme.

Arrihet në konkluzionin se:

-Projekti i zbatimit është hartuar me mangësi sa i takon përfshirjes së të gjithë fshatit në zonën e furnizimit.

- Gjatë zbatimit të kontratës janë marrë masa për ndryshimet përkatëse duke përfshirë në skemën e furnizimit banesat të cilat nuk ishin përfshirë, por duke ndërtuar një depo të re me volum 12 m³, e cila furnizohet me ngritje mekanike, duke marrë ujin nga depo 100 m³. Pavarësisht se këtij ndryshimi, furnizimi me ujë i këtyre banesave nuk garantohet në mënyrë të pandërprerë, si për raste të ndërprerjes së energjisë elektrike, ashtu dhe për raste të dëmtimit të pompës.

-Nga verifikimi në objekt, rezulton se përveç problematikës së mësipërme, ujësjellësi është në funksion. Por duhen marrë masa shtesë, për sigurim të vazhdueshmërisë së furnizimit me ujë për të gjithë banesat e Fshatit Vranisht.

- Një problematikë e pa zgjidhur për këtë fshat, ngelet furnizimi me ujë për vaditje, në mënyrë që të mos përdoret uji i pijshëm për këtë qëllim.

Në KLSH është administruar një ankesë e cila lidhet me problematikën e furnizimit me ujë për disa banorë të Fshatit Vranisht.

Pavarësisht mos vënies në dispozicion të dokumentacionit të projektzbatimit dhe të zbatimit të kontratës së punimeve për rikonstrukcionin e ujësjellësit të Fshatit Vranisht, duke u bazuar në dokumentacionin e përfshirë në realizimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet se:

Projektpreventivi i ndërtimit të ujësjellësit të Fshatit Vranisht është hartuar nga z. K.K (inxhinier hidroteknik) me licencë H/T/0103/5, z. F.B (inxhinier hidroteknik) me licencë K.2590 dhe z. S.N (inxhinier hidroteknik).

Bazuar në termat e referencës, hartuar nga z. E.M (qëllimi i projektit) rezulton se ujësjellësi ekzistues përbëhet vepra e marrjes në kuotën 432 m m.n.d, nga depo ekzistuese në kuotën 409 m m.n.d, rrjeti kryesor që lidhe veprën e marrjes me depon me tubacion me diametër 110 mm dhe rrjeti shpërndarës me dimension nga 110 mm deri 20 mm.

Në termat e referencës është kërkuar:

-Për realizimin e projektit, projektuesi duhet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me projektin që duhet të hartojë për furnizimin me ujë sipas detyrës së projektimit dhe të konsultohet me njësinë e qeverisjes vendore, sh.a. ujësjellësin, KESH e Telekomin.

- Të merren për bazë dhënat e prurjeve dhe volumit të ujit për të përballuar kërkesën për ujë të zonave.

- Cilësia e studim projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të plotësojë kushtet e projektimit.

- Do të trajtohet ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit *për gjithë zonën e fshatit*, depo e re, vepër marje e re në burim, linja e trasmetimit nga burimi në depo dhe rrjetet shpërndarës nga depo e ujit deri në banesë.

Nga auditimi i dokumentacionit të projektit të zbatimit (i disponueshëm në sistemin elektronik të prokurimeve dhe verifikimit në objekt), rezulton se depo e re me kapacitet 100 m³ është ndërtuar ngjitur me atë ekzistuese. Për pasojë disa banesa kanë dalë jashtë skemës së furnizimit me ujë. Ky veprim është në kundërshtim me termat e referencës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Nga ana e bashkisë si përfituese e projektit nuk është verifikuar dokumentacioni i projektit nëse përmbush apo jo kërkesat e përcaktuara në termat e referencës si dhe realizimi i kushteve teknike të projektit.

Kontrata e punimeve civile “Ndërtim ujësjellës Fshati Vranisht, është nënshkruar me datë 10.08.2021, me BOE “K ” SHPK. Nxjerrja jashtë skemës së furnizimit për disa banesa ka krijuar problematika me banorët e zonës gjatë zbatimit të kontratës. Duke qenë se pozicionimi i këtyre banesave është në kuotë më të lartë se edhe depo e vjetër, furnizimi me ujë i tyre duhet të jetë bërë nëpërmjet lidhjeve me rrjetin kryesor të furnizimit. Për këtë arsye është miratuar ndryshimi i projektit, duke përfshirë realizimin e një depoje të re me kapacitet 12 m³, në një kuotë më të lartë e cila do furnizohet nga depo e re 100 m³, nëpërmjet një sistemi pompimi. Kjo depo furnizon banesat jashtë skeme me rrjedhje të lirë.

Bazuar në pretendimet e banorëve të cilët nuk lidhen drejtperdrejtenga depo 100 m³, varësia e furnizimit nga energjia elektrike ka krijuar problematikën e ndërprerjes së furnizimit në raste të ndërprerjes së energjisë elektrike, po ashtu ka ankesa në lidhje me funksionimin e pompës.

Për furnizimin me ujë të depos 12 m³, është vendosur një pompë. Mungesa e një sistemi automatik i furnizimit me ujë si dhe mungesa e një gjeneratori të lidhur në mënyrë automatike, nuk jep garanci për furnizim në mënyrë të vazhdueshme.

Arrihet në konkluzionin se:

-Projekti i zbatimit është hartuar me mangësi sa i takon përfshirjes së të gjithë fshatit në zonën e furnizimit.

- Gjatë zbatimit të kontratës janë marrë masa për ndryshimet përkatëse duke përfshirë në skemën e furnizimit banesat të cilat nuk ishin përfshirë, por duke ndërtuar një depo të re me volum 12 m³, e cila furnizohet me ngritje mekanike, duke marrë ujin nga depo 100 m³. Pavarësisht se këtij ndryshimi, furnizimi me ujë i këtyre banesave nuk garantohet në mënyrë të pandërprerë, si për raste të ndërprerjes së energjisë elektrike, ashu dhe për raste të dëmtimit të pompës.

-Nga verifikimi në objekt, rezulton se përveç problematikës së mësipërme, ujësjellësi është në funksion. Por duhen marrë masa shtesë, për sigurim të vazhdueshmërisë së furnizimit me ujë për të gjithë banesat e Fshatit Vranisht.

- Një problematikë e pa zgjidhur për këtë fshat, ngelet furnizimi me ujë për vaditje, në mënyrë që të mos përdoret uji i pijshëm për këtë qëllim.

2.7.2 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së”

1. *Planet e masave të ndërmarra nga Bashkia Himarë për zbatimin e rekomandimeve.*
2. *Dokumentacion plotësues dhe justifikues për zbatimin e rekomandimeve.*
3. *Kthim përgjigje mbi pyetëtorin për zbatimin e rekomandimeve.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

I. Respektimi i afatit pR 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Me shkresën nr. 1024/2 Prot, datë 28.12.2022 është administruar Raporti Përfundimtar nr 1024/10 datë 08.06.2023 “ Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë”. Në mbështetje të nenit 15, gërma “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Himarë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 281/27 prot., datë 13.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1024/11 datë 17.07.2023 duke respektuar afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

II. Respektimi i afatit ligjor pR 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Në zbatim të nenit 30, Pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është kthyer përgjigje në KLSH, në lidhje me masat korrigjuese të marra dhe të pranuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr 1024/10 datë 08.06.2023, janë rekomanduar gjithsej:

- a. Janë rekomanduar **14** masa organizative;
- b. Janë rekomanduar **4** masë për shpërblim dëmi në vlerën **8,206,669 lekë**;
- c. Janë rekomanduar **3** masa për uljen e borxhit në shumën **301,087,971 lekë**;
- c. Janë rekomanduar **7** masa për përdorimin me shpenzime jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit.

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

Sipas shkresës së administruar në Bashkinë Himarë, me nr 1024/10 datë 08.06.2023, statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si me poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar Plotësisht	Pa pranuar
1	Organizative	14 masa	14 masa	0
2	Shpërblim dëmi	4 masa	4 masa	0
3	Masa për uljen e borxhit	3 masa	3 masa	0
4	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa	7 masa	0

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	14 masa		2	1	11
2	Shpërblim dëmi	4 masa				4
3	Masa për uljen e borxhit	3 masa				3
4	Për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike	7 masa			7	

Në mënyrë të analitike statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore.

-Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj.

-Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, dR torie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Nga verifikimi rezultoi:

*Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë dR tim Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

2.1.Rekomandimi: Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të F ve kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si F me risk të lart, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike. Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e vakancave në NJAB me qëllim efencën e këtij sektori të rëndësishëm për Bashkinë.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi

zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë dR tim, ndërsa në lidhje me vendet vakante pranë NJAB nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Himarë është bërë shpalljen për dy vende vakante me shkresën nr.4663 prot., datë 11.10.2023, për ngritje në detyre dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive , specialist auditues i brendshëm , në sektorin e auditimit të brendshëm. Në konkurrim ka marrë pjesë vetëm një kandidat dhe është shpallur fitues sipas urdhrit nr 4663/8 prot., datë 22.11.2023.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë:

Të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë dhe Nëpunësi Zbatues, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura sipas afateve të përcaktuara në kontratë, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimi të detyrimeve të prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Himarë ka pasur detyrime të prapambetura në vlerën 78,025,477 lekë për 15 kontrata të lidhura të cilat nuk ishin likuiduar deri në Dhjetor 2022. Nga ana e Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj është proceduar me shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për 9 kontrata me vlerë totale 57,069,076 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet në proces zbatimi.

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre vlerësimin dhe ekzistencën fizike.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrin masa për të kryer procesin e Inventarizimit dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve me qëllim që në çdo kohë dhe në mënyrë të qartë, të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri informacionin e plotë, gjendjen reale të aktiveve, fizike dhe kontabël.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

7.1.Rekomandime: Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë, si dhe të regjistrojë në kontabilitet dhe debitorët e vitit 2020, të pa kontabilizuar për vlerën 103,574,000 lekë.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën pR 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 me ndikim në informacionin kontabël të vitit 2021 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të dR tën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së dR tës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

9.1Rekomandimi: Drejtoria e Integritit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

10.1 Rekomandimi: Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

11.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

12.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar dispozitat ligjore në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit shoqërues për aplikimin për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

13.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë, të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 594/12, prot datë 08.03.2022 të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara.

Nga verifikimi rezultoi:

Nga subjekti nuk u vendos dokumentacion në dispozicion mbi ecurinë e zbatimit të dokumentacionit. Gjithashtu gjatë zhvillimit të auditimit u kuptua që nuk ishin marrë hapa mbi zbatimin e rekomandimit të mësipërm, duke u konstatuar sërish problematika në këtë drejtim. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

13.1.a Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë

procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 28,575 lekë, përfituar pa të padrejte të dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “J.T”.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkia Himarë dhe nga titullari i saj ka konfirmuar vlerën përfundimtare 28,575 lekë për subjektin J.T dhe i ka dërguar me vonesë shkresën nr. 5492, datë 01.12.2023 Drejtorisë të Ardhurave për të filluar procedurën e njoftimit dhe arkëtimit të vlerës, datë që përkon me kërkesën e grupit të auditimit, drejtuar institucionit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

13.1.b Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 1,097,086 lekë, përfituar pa të padrejte të dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “B ” Shpk.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj ka konfirmuar vlerën përfundimtare 1,097,086 lekë për subjektin “B ” shpk dhe i ka dërguar me vonesë shkresën nr. 5492, datë 01.12.2023 Drejtorisë të Ardhurave për të filluar procedurën e njoftimit dhe arkëtimit të vlerës, datë që përkon me kërkesën e grupit të auditimit, drejtuar institucionit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

13.1.c Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 8,789,727 lekë, përfituar pa të padrejte të dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “E ” Shpk.

Nga verifikimi rezultoi:

Bashkisë Himarë dhe nga titullari i saj ka konfirmuar vlerën përfundimtare 8,789,727 lekë për subjektin “E ” shpk dhe i ka dërguar me vonesë shkresën nr. 5492, datë 01.12.2023 Drejtorisë të Ardhurave për të filluar procedurën e njoftimit dhe arkëtimit të vlerës, datë që përkon me kërkesën e grupit të auditimit, drejtuar institucionit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet i pazbatuar.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1.T’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

2.Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale pR 207.65 ha, duke aplikuar tarifatat dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (14,090,740 lekë/vit, për 18 subjekte).

4. Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

5. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet që kanë aktive minerare në territorin e Bashkisë Himarë me detyrime vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Paketës Fiskale.

Nga verifikimi rezultoi:

*Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë i kanë dërguar kërkesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 3242 datë 12/07/2023 për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor të mbetura. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk i kanë kërkuar Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pjesërish zbatuar***

Nga verifikimi rezultoi:

Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë kanë dërguar **18 kërkesa** Operatorëve Ekonomikë, për lidhje kontrate qiraje sipas rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku u konstatua se nuk është lidhur asnjë kontratë me Operatorët Ekonomikë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**

Nr.	Nr. Lejes	Data	Emri i Subjektit	Lloji i Aktivitetit	Sip. km2	Sip. Ha
1	582/1	22/02/2018	"A" Shpk	Gur gëlqeror	0.081	8.10
2	683/1	22/05/2013	"F" Shpk	Gur gëlqeror	0.0428	4.28
3	965	05/09/2006	"Z" Shpk	Ranor silicor	0.088	8.80
4			"Z" Shpk	Ranor silicor	0.05	5
5	1634	13/06/2013	"DH - 001" Shpk	Gur gëlqeror	0.1	10
6	1730	08/04/2010	"S" Shpk	Gur gëlqeror	0.074	7.40
7	226	26/12/1995	"I" Shpk	Gur gëlqeror	0.182	18.20
8	661/1	19/11/2012	"P" Shpk	Gur gëlqeror	0.107	10.70
9	662/1	28/08/2012	"A" Shpk	Gur gëlqeror	0.05	5
10	870	17/06/2005	"I" Shpk	Argjilë	0.15	15
11	1370	22/06/2009	"I" shpk	Argjilë	0.07	7
12	1774	03/11/2015	"M" Shpk	Ranor silicor	0.218	2.18
13	965/1	06/06/2016	"S" Shpk	Ranor silicor	0.088	8.80
14	1730	08/04/2010	"S" Shpk	Gur gëlqeror	0.074	7.40
15	1023	13/06/2007	"D" Shpk	Ranor silicor	0.34	34
16	1361	19/06/2009	"G" Shpk	Ranor silicor	0.1499	14.99
17	1795	11/04/2016	"S" Shpk	Ranor silicor	0.368	36.10
18	1743/1	23/02/2015	"D" Shpk	Gur gëlqeror	0.04	4
						207.65

Nga verifikimi rezultoi:

Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë hartuar raporte tekniko-ekonomike për vlerësimin e saktë të llojit të bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhen në këto sipërfaqe, si dhe nuk

është llogaritur vlera. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.

Nga verifikimi rezultoi:

Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë masa për te ngarkuar me detyrime vendore subjektet që ushtrojnë veprimtari minerare në territorin e Bashkisë Himarë.

*Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

C. Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejtapër të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën 287,712,121 lekë.

Nga verifikimi rezultoi:

Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë kanë dërguar njoftim për detyrimin e prapambetur dhe kërkesë për pagesë për 73 subjekte ne intervale kohore të ndryshme, përkatësisht në datë 21.06.2022 janë dërguar 33 kërkesa , në datën 21.07.2022 janë dërguar 6 kërkesa , në datën 24.08.2022 janë dërguar 4 kërkesa dhe në datën 25.08.2022 janë dërguar 30 kërkesa.

*Nga këto kërkesa rezulton se vetëm për 7 pR tyre është proceduar me kërkesë ndaj bankave te nivelit të dytë për urdhër bllokim te llogarive bankare në datën 02.11.2022. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

2.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 8 subjekte të vlerës 8,000,000 lekë, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së licencë/autorizimit, Bashkia Himarë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Nga verifikimi rezultoi:

Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë dërguar njoftim për detyrimin e prapambetur dhe kërkesë për pagesën e tarifës së licencës/autorizimit për 6 subjekte.

*Për 2 subjekte tjera, konkretisht “P” Himarë, Fshat dhe Himara “P” Dhërmi janë bërë pagesa të pjesshme me vlere 200,000 leke për periudhën 2021-2022 por nuk është lidhur marrëveshje për shlyerjen e detyrimet brenda afatit 5 vjeçar për pagesën e tarifës së licencë/autorizimit. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 5,375,850 lekë, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas pasqyrës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga verifikimi rezultoi:

Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 5,375,850 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.

D. Masa shpërblim dëmi.

1.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës pR 951,232.26 lekë pa Tvsh nga BOE “K” Shpk & “I” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 15.12.2021, me objekt: “Mbrojtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi:

*Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 951,232.26 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

2.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës pR 2,612,310lekë pa Tvsh nga BOE “K” Shpk& “M” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi:

*Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 2,612,310 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

3.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 279,728.78 lekë, përfituar pa të padrejte të dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues z. F.M .

Nga verifikimi rezultoi:

*Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 279,728.78 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

4.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 4,860,518.2 lekë, përfituar pa të padrejte të dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues OE “J” Shpk.

Nga verifikimi rezultoi:

*Përfaqësuesit e Bashkisë Himarë nuk kanë marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 4,860,581.2 lekë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **i pazbatuar**.*

E. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1-1.7.Rekomandimi: AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kritereve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Himarë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejte të të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Nga verifikimi rezultoi:

*Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se në kushte të tilla ky rekomandim konsiderohet **në proces zbatimi**.*

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me komponentët e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit u konstatua që:

Nuk ka programe të trajnimit për implementimin e parimeve të mësipërme.

Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga 3 njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Gjithashtu nga Bashkia Himarë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për F të ndryshme.

Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar

Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në Bashkinë Himarë nuk ka praktikë apo strategji të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Mungon urdhri për përcaktimin e koordinatorit të riskut, urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut.

Nuk është përcaktuar koordinatori i riskut dhe funksionimi i tij, por as në Rregulloren e Brendshme nuk është përfshirë si funksion “Koordinatori i Riskut”, ku të përcaktoheshin kushtet që duhet të plotësojë për të qenë një nëpunës koordinator risku, detyrat dhe përgjegjësitë etj.

Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up).

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi nuk është ngritur si strukturë, duke sjellë mungesën e një elementi që luan rol të rëndësishëm në funksionin e monitorimit e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” nenet 11, 12/d,19,20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF, i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MF nr.4 datë 10.01.2020, Kap. II 2.4.1 dhe 2.4.2; Kap. III, pika 3.5; Kap. IV pika 4.1.11 dhe 4.1.12; Kap. VI pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kap. VII pika 7.1.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 6-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi, rezulton se planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve *(të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti)* ka vlerën **1,341,496 mijë lekë**, ndërsa realizimi **539,935 mijë lekë**, ose në masën 40%, ku zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **127,825 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **109,436 mijë lekë**, ose në masën 86%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 79%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **297,892 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **158,988 mijë lekë**, ose në masën 53.%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **827,787 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **240,407 mijë lekë**, ose në masën 29%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Himarë në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Gjithashtu rezulton se gjatë vitit 2022 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2022.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Neni 46 “Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor”, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 14-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe dR toritë e tjera të Bashkisë Himarë, të marrë masat për programimin e buxheteve afatmesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, problematikat e konstatuara, janë të ripërsëritura dhe konstatuar nga auditimet e viteve të kaluara. Zbatimi i rekomandimeve të lëna për problematikat në fjalë janë të pazbatuara. Edhe në këtë auditim janë konstatuar problematika që lidhje me procesin e inventarizimit, mbi mos kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve dhe dëmeve ekonomike të konstatuara nga KLSH në auditimet e mëparshme, mos pasqyrim i saktë i veprimeve kontabël.

Gjithashtu Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Himarë, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 52,480,267 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Himarë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466.

Nga auditimi konstatohet se nga ana e Drejtorisë së financës nuk është marrë asnjë masë për likuidimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 19-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 procedura prokurimi të zhvilluara në Bashkinë Himarë për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, me fond limit 411,296 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë të kontraktuar 367,105 lekë pa TVSh, u konstatuan parregullsi në hartimin e kriterëve jo në përputhje me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga AK, si më poshtë:

- Në 1 procedura nga 5 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 66,666 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 66,344 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se janë aplikuar kriteret të paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në 2 procedura nga 5 të audituara, me vlerë totale të fondit limit 54,996 mijë lekë pa TVSh dhe vlerë totale të kontratave 48,284 mijë lekë pa TVSh, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësisht të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Himarë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike në Bashkinë Himarë, pasi në dokumentacionin e paraqitur për tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 39, 34, 40, 41, 76, 77, 82, 92,98, dhe VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), neni 26, 36 , 39, 45, 67,78, 82 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 48-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor (Kryetari i Bashkisë Himarë) të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve që përfshihen në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim shmangien e mangësive të evidentuara në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, dokumentimin dhe argumentimin e specifitimeve teknike dhe në vlerësimin e ofertave.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga Auditimi: Në KLSH është administruar një ankesë e cila lidhet me problematikën e furnizimit me ujë për disa banorë të Fshatit Vranisht.

Bazuar në dokumentacionin e përfshirë në realizimin e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve konstatohet se:

- Projekt preventivi i ndërtimit të ujësjellësit të Fshatit Vranisht është hartuar nga z. K.K (inxhinier hidroteknik) me licencë H/T/0103/5, z. F.B (inxhinier hidroteknik) me licencë K.2590 dhe z. S.N (inxhinier hidroteknik).

- Bazuar në termat e referencës, hartuar nga z. E.M (qëllimi i projektit) rezulton se ujësjellësi ekzistues përbëhet nga vepra e marrjes në kuotën 432 m m.n.d, nga depo ekzistuese në kuotën 409 m m.n.d, rrjeti kryesor që lidhe veprën e marrjes me depon me tubacion me diametër 110 mm dhe rrjeti shpërndarës me dimension nga 110 mm deri 20 mm.

- Nga auditimi i dokumentacionit të projektit të zbatimit (i disponueshëm në sistemin elektronik të prokurimeve dhe verifikimit në objekt), rezulton se depo e re me kapacitet 100 m³ është ndërtuar ngjitur me atë ekzistuese, për pasojë disa banesa kanë dalë jashtë skemës së furnizimit me ujë në kundërshtim me termat e referencës të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Nga ana e bashkisë si përfituese e projektit nuk është verifikuar dokumentacioni i projektit nëse përmbush apo jo kërkesat e përcaktuara në termat e referencës si dhe realizimi i kushteve teknike të projektit

- Kontrata e punimeve civile “Ndërtim ujësjellës Fshati Vranisht”, është nënshkruar me datë 10.08.2021, me BOE “K ” SHPK. Nxjerrja jashtë skemës së furnizimit për disa banesa ka krijuar problematika me banorët e zonës gjatë zbatimit të kontratës.

Konkluzion:

-Projekti i zbatimit është hartuar me mangësi sa i takon përfshirjes së të gjithë fshatit në zonën e furnizimit.

- Gjatë zbatimit të kontratës janë marrë masa për ndryshimet përkatëse duke përfshirë në skemën e furnizimit banesat të cilat nuk ishin përfshirë, duke ndërtuar një depo të re me volum 12 m³, e cila furnizohet me ngritje mekanike, duke marrë ujin nga depo 100 m³.

Pavarësisht ndërtimit të depos së re, nuk garantohet në mënyrë të pandërprerë furnizimi me ujë të pijshëm i këtyre banesave, si për rastet kur ndërpritet energjisë elektrike, ashtu dhe në rastet e dëmtimit të pompës.

- Nga verifikimi në objekt rezulton se ujësjellësi është në funksion por përveç problematikës së mësipërme, mungon furnizimi i vazhdueshëm me ujë të pijshëm për të gjithë banesat e Fshatit Vranisht.

- Problematike për këtë fshat dhe çështje e pa zgjidhur ngelet mungesa e furnizimi me ujë për vaditje dhe nga banorët përdoret uji i pijshëm për këtë qëllim (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 126-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

6.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë të marrë masa për shqyrtimin e projekteve për investimet, duke kërkuar respektimin e termave të referencës dhe kushtet teknike të projektimit, që në fazën e marrjes në dorëzim të tyre.

6.2 Rekomandimi: Për banesat Fshatit Vranisht të cilat nuk lidhen drejtperdrejteme depon kryesore, të merren masa për vendosjen e një sistemi automatik të furnizimit me ujë të depos 12 m², të përbërë nga dy pompa uji dhe gjenerator me karburant, i cili furnizon me energji elektrike pompat në rast të ndërprerjes me energji elektrike të depos kryesore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 1024/2 Prot, datë 28.12.2022, rezulton se:

- Në mbështetje të nenit 15, germa “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Bashkia Himarë ka kthyer përgjigje në KLSH me shkresën nr. 281/27 prot., datë 13.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1024/11 datë 17.07.2023 duke respektuar afatin 20 ditor të informimit në lidhje me planin e veprimeve të ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

- Në zbatim të nenit 30, Pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e Bashkisë Himarë nuk është kthyer përgjigje në KLSH, në lidhje me masat korrigjuese të marra dhe të pranuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga **14** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **2** janë zbatuar pjesërisht, **1** është në proces zbatimi dhe **11** nuk janë zbatuar.

-Nga **3** masa për uljen e borxhit të **3** masat janë të pa zbatuara.

-Nga **4** masa për shpërblim dëmi të **4** masat janë të pa zbatuara.

-Nga **7** masa për eliminimin e efekteve negative të përdorimit të fondeve publike të rekomanduar, të **7** masat janë të pa zbatuar.

Nuk janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve nga ku niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 35%, edhe pse gjatë auditimit në terren bashkia ka vijuar me zbatueshmërinë e plotë të tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 126-137, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Bazuar në nenin 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces, si më poshtë”:

A. Masa Organizative.

2.1.Rekomandimi: Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të F ve kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si F me risk të lart, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike. Kryetari i Bashkisë të marrë masa për plotësimin e vakancave në NJAB me qëllim eficientë të këtij sektori të rëndësishëm për Bashkinë.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore.

Të marrë masat, që në buxhetin e vitit ushtrimor, të programohet shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar nga viti paraardhës sipas kërkesave ligjore.

5.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtorja e Integritetit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrë masa të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për

veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre vlerësimin dhe ekzistencën fizike. **M**

6.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të marrin masa për të kryer procesin e Inventarizimit dhe vlerësimin e të gjitha aktiveve me qëllim që në çdo kohë dhe në mënyrë të qartë, të paraqesin me vërtetësi dhe besueshmëri informacionin e plotë, gjendjen reale të aktiveve, fizike dhe kontabël.

7.1.Rekomandime: Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë, si dhe të regjistrojë në kontabilitet dhe debitorët e vitit 2020, të pa kontabilizuar për vlerën 103,574,000 lekë.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, të sistemojë diferencën pR 178,152 lekë pasqyruar më pak në fund të vitit 2020 me ndikim në informacionin kontabël të vitit 2021 dhe për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2010-2018, në vlerën 11,445,558 lekë të cilat kanë humbur të dR tën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

9.1Rekomandimi: Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik e Social, në të gjitha regjistrimet kontabël, të veprojnë sipas parimit të konstatimit: të gjitha shpenzimet të pasqyrohen në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare, atëherë kur ato ndodhin dhe jo kur kryhet pagesa. Raportimi i tyre në pasqyrat financiare të bëhet në atë periudhë kontabël së cilës i përkasin shpenzimet.

10.1 Rekomandimi: Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, sipas Rregullores së Planifikimit të Përgjithshëm të Territorit dhe legjislacionit në fuqi.

11.1.Rekomandimi: Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar të gjitha afatet kohore për shqyrtimin e aplikimeve për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

12.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Himarë të merren masa për të respektuar dispozitat ligjore në lidhje me listën e plotë të dokumentacionit shoqëruar për aplikimin për leje ndërtimi, të përcaktuara në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar.

13.1 Rekomandimi: Nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë, të merren masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 594/12, prot datë 08.03.2022 të cilat kanë rezultuar të pa zbatuara.

13.1.a Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 28,575 lekë, përfutur pa të padrejte të dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti “J. T.”.

13.1.b Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 1,097,086 lekë, përfutur pa të padrejte të dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “B ” ShPK.

13.1.c Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 8,789,727 lekë, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti juridik “E” ShPK.

14.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale pR 207.65 ha, duke aplikuar tarifën dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (14,090,740 lekë/vit, për 18 subjekte).

4. Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

5. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet që kanë aktive minerare në territorin e Bashkisë Himarë me detyrimeve vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Paketës Fiskale.

Menjëherë

B. Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, Bashkia Himarë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifën vendore në fund të periudhës në vlerën 287,712,121 lekë.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 8 subjekte të vlerës 8,000,000 lekë, duke i njoftuar për detyrimin që kanë ndaj bashkisë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së liçencë/autorizimit, Bashkia Himarë në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Integritimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Sektorit i të Ardhurave, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 5,375,850 lekë, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë, sipas pasqyrës, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. Masa shpërblim dëmi.

1.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 951,232.26 lekë pa Tvsh nga BOE “K ” ShPK & “I” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 460 prot., datë 15.12.2021, me objekt: “Mbrojtje lumore dhe pyllëzim të anës lumit Borsh”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Himarë të merren masa për arkëtimin e vlerës pR 2,612,310lekë pa TVSh nga BOE “K” ShPK& “M ” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 229 prot., datë 07.09.2021, me objekt: “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Vranisht”, Bashkia Himarë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 279,728.78 lekë, përfituar pa të padrejtëdhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues z. F.M .

4.1.Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Vlorë, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e vlerës 4,860,518.2 lekë, përfituar pa të padrejtëdhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti zhvillues OE “J ” ShPK.

Menjëherë

D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

1.1-1.7.Rekomandimi: AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kritereve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Himarë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtët operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës për procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni dhe rinovimi i sallës polifunksionale të bashkisë”, u konstatuan problematika në lidhje me shtrimin e mokitit e cila nuk ishte e vënë në mënyrë të rregullt, dhe jo në përputhje me specifikimet teknike.

Problematika të konstatuara në lidhje me Bokset modulare, ku mungojnë 2 nga 4 bokset që duhet të ishin instaluar. Demi i shkaktuar përlllogaritet në vlerën 2*150,000 lekë= 300,000 lekë pa TVSH.

Problematika të konstatuara në vendosjen e dritaret doppio xham, ku u konstatua që dritarja nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST, si dhe është me një xham, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Bashkisë Himarë në vlerën $4m^2 * 25,000 \text{ lekë} = 100,000 \text{ lekë}$ pa TVSH.

Problematika të konstatuara në lidhje me spotet e ndriçimit, Spot Led Horizontal, ku mungojnë 4 spote * $55,000 \text{ lekë} = 220,000 \text{ lekë}$ pa TVSH.

Problematika të konstatuara në lidhje me shtresat e pllakave të mermerit $11.68m^2 - 5.3m^2$ (që ishin shtruar) = $6.38m^2 * 11,000 \text{ lekë}/m^2 = 70,180 \text{ lekë}$ pa TVSH.

Problematika të konstatuara në lidhje me veshjen e murit e cila nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST, ku dallohet qartë që veshja e murit nuk është e llojit “Dru”, por e një lloji tjetër materiali.

Problematika të konstatuara në ndërtimin e shkallëve të drurit, ku veshja e të cilit është jashtë përdorimit dhe nuk i përmbahet specifikimeve teknike të kërkuara në DST (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 30-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës pR **690,180 lekë pa TVSH** nga shoqëria “L” ShPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Brenda datës 30.09.2024

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga Auditimi: Gjatë analizimit të procedurës së prokurimit me objekt “Shërbimi i Pastrimit”, nga ana e Bashkisë Himarë është mbajtur procesverbali i cili pasqyron dhe evidenton gjendjen aktuale të zbatimit të kontratës. Procesverbali mbahet në bazë të urdhrit nr. 180 datë 22.06.2022 “Për ndjekjen dhe kontrollin e shërbimit të pastrimit për vitin 2022” nga Kryetari i Bashkisë Himarë. Në procesverbalet e mbajtura të cilët nuk janë ditorë, nuk evidentohen sipërfaqet e pastruara (m^2), vendndodhja, punonjësit etj, si dhe realizimi i zërave të mësipërm. Vlera e paraqitur në total për OE “A” është në vlerën **31,298,684 lekë** pa TVSH, për O.E. “R” ShPK. është në vlerën **5,980,808 lekë** pa TVSH, ku në total është në vlerën **37,279,492 lekë** pa TVSH si shumë e përdorur pa Efektivitet, Eficencë dhe Ekonomicitet nga Bashkia Himarë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 30-62, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, personat përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, gjatë hartimit të procesverbale të merret në konsideratë hartimi i tyre në mënyrë të detajuar, duke përfshirë zëra real të situacionuar.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

D.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga Auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 25, Prot. 819 datë 16.02.2023 të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi miratuar me Vendim të KKT Nr. 32 datë 28.12.2020 për objektin “G , zona G6b, REZIDENCE BANIMI ME APARTAMENTE 2, 3, 4 dhe 5 kat me 1 dhe 2 kat parkim nëntokë”, në adresën Gjilekë (Dhrale), Bashkia Himarë, me zhvillues “G ” ShPK, Subjekt Ndërtues “M ” ShPK, projektuar nga ark. B.SH .

Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Social (DZHES) Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.4 datë 27.01.2023 është përlllogaritur me vlerën 17,722,341.40 lekë. Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 491,690,780 = 19,667,631.2$ lekë.

Nga subjekti “G ” ShPK me faturën e R datë 01.02.2023 janë paguar 17,722,341.40 lekë.

Vlera e llogaritur me diferencë pR **1,945,289 lekë përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtëdhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, pR **1,945,289 lekë** me zhvillues “G ” ShPK, Subjekt Ndërtues “M ” ShPK, e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

2.1.Gjetje nga Auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 166, Prot.4720/2, datë 15.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 19, datë 10.06.2021 të KKT për objekt “Strukture 1-5 Kate me 1 kat nëntokë, me funksion hoteleri”, ndodhur në adresën: Rruga e Plazhit, Borsh, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqëria ‘G ’, Shoqëria ‘F ’ ShPK, Shoqëria ‘A ’. Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% . Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.265 datë 23.11.2022 është përlllogaritur me vlerën 49,306,834.08 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 1,343,922,000 = 53,375,688$ lekë.

Nga subjekti G me faturën e OTP Bank datë 12.12.2022 janë paguar 49,306,834.08 lekë. Vlera e llogaritur në mungesë nga Bashkia Himarë pR **4,068,854 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtëdhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, pR **4,068,854 lekë** me zhvillues Shoqëria ‘G ’, Shoqëria ‘F ’ ShPK, Shoqëria ‘A ’. e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e Bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

3.1.Gjetje nga Auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 26, Prot.234/1, datë 11.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 18, datë 13.08.2021 të KKT për objekt "2 Banesa individuale 2 kat me 1 kat nëntokë dhe pishinë", ndodhur në adresën: Gjilekë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me zhvillues V.G , G.G , M.H dhe Subjekt ndërtues shoqëria "A " ShPK. Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4% ose 4% e vlerës së përlllogaritur sipas çmimit të referencës bazuar në Udhëzimit Nr.3 datë 28.12.2016 të EKB e cila për qarkun Vlorë është 32508 lekë/m² (përzgjidhet vlera më e lartë mes të dyjave. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.20 datë 11.03.2022 është përlllogaritur me vlerën 857,007.99 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 22,581,007 = 903,240$ lekë.

Po të llogaritet me çmimin e EKB kjo vlerë del $4\% * 32508 * 380 \text{ m}^2 = 494,121,6$ leke.

Nga subjekti "A " ShPK me faturën e T datë 11.03.2022 janë paguar 875,007,99 lekë. Vlera e llogaritur në mungesë nga Bashkia Himarë pR **28,232 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtë dhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, pR **28,232 lekë** me zhvillues V.G , G.G , M.H dhe Subjekt ndërtues shoqëria "A " ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

4.1.Gjetje nga Auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 09, Prot.328, datë 19.01.2023, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 12, datë 24.11.2021 të KKT për objekt "Strukturë hotelerie 2 kate me 2 kate nëntokë, me vendndodhje në shëtitoren Qeparo, Bashkia Himarë", ndodhur ne adresën: Protopape, Fshati Qeparo Fushë në Territorin e Bashkisë Himarë, me Zhvillues S.K Person Fizik. Sipas VKB me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.257 datë 17.01.2023 është përlllogaritur me vlerën 2'984'585.49 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 78,978,883.53 = 3,159,155.34$ lekë.

Nga subjekti S.K me faturën e OTP Bank datë 18.01.2023 janë paguar 2,984,585.49 lekë. Vlera pR **174,569 lekë** e llogaritur nga Bashkia Himarë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të

padrejtëdhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, pR **174,569 lekë** me zhvillues S.K Person Fizik, e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

5.1.Gjetje nga Auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 127, Prot.3310/1, datë 05.10.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 32, datë 28.12.2020 të KKT për objekt "G , Z , R ", ndodhur ne adresën: Palasë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues Shoqëria "S " dhe Subjekt Ndërtues shoqëria "A " ShPK. Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.92 datë 16.09.2022 është përlllogaritur me vlerën 7,765,636.37 lekë.

Po të llogaritet vlera 4% e preventivit kjo vlerë del $4\% * 197,641,383 = 7,905,655.32$ lekë.

Nga subjekti S 1 me faturën e R datë 05.10.2022 janë paguar 7,765,636.37 lekë. Vlera pR **140,018 lekë** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Bashkia Himarë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtëdhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, pR **140,018 lekë** me zhvillues Shoqëria "S " dhe Subjekt Ndërtues shoqëria "A " ShPK e cila përbën të ardhura të munguara për institucionin e bashkisë Himarë.

Brenda datës 30.09.2024

6.1.Gjetje nga Auditimi: Leje ndërtimi miratuar me Vendim Nr. 147, Prot.2648/1, datë 02.11.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe leje zhvillimi Vendim Nr. 16, datë 13.07.2021 të KKT për "Objekt hoteleri dhe shërbime 1,2 dhe 3 kat me 3 kat nëntokë dhe pishinë", ndodhur ne adresën: Gjilekë, Dhërmi, në territorin e Bashkisë Himarë, me subjekt zhvillues dhe ndërtues Shoqëria "B ". Sipas VKB Himarë me nr.54 datë 25.01.2021 vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë është 4% e vlerës së investimit, vlerë e cila në momentin e pajisjes me leje ndërtimi është e barabartë me vlerën e preventivit të punimeve shumëzuar me 4%. Vlera reale dhe përfundimtare e investimit mund të përlllogaritet duke i mbledhur të gjithë situacionet dhe duke i rakorduar me degën e tatimeve, në momentin përpara pajisjes me certifikatë përdorimi të objektit. Nga DZHES Bashkia Himarë kjo taksë në faturën me nr.90 datë 16.09.2022 është përlllogaritur me vlerën 7,570,581.62 lekë.

Vlera pR **29,457 lekë**, përbën të ardhura të munguara dhe rrjedhimisht dëm financiar për institucionin e Bashkisë Himarë (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 66-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të konfirmoj vlerën përfundimtare të deklaruar dhe konfirmuar zyrtarisht, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerave të mësipërme, përfituar pa të padrejtëdhe në mospërputhje me legjislacionin në fuqi nga subjekti përkatës, pR **29,457 lekë** me zhvillues dhe ndërtues Shoqëria "B ".

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), rezulton se:

- Ky sektor nuk disponon mjetet e nevojshme për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje, duke mos respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” neni 5.

- Inspektorët për përmbushjen e përgjegjësiave të parashikuara në ligj, disponojnë vetëm 1 mjet lëvizës mbi ushtrimin e kontrollit në territor. Nga ana e Bashkisë nuk janë marrë masa që të sigurohen mjetet e nevojshme lëvizëse në përmbushje të detyrave funksionale të Inspektorëve të IMTV bazuar në Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007, neni 4.

- 3 Inspektorët nuk e kanë arsimin përkatës në kundërshtim me Ligjin Nr.9780 datë 16.07.2007 neni 11.

- Për periudhën objekt auditimi nga IMTV janë vendosur gjithsej 64 gjoba me vlerë 28,400,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar vetëm 5 gjoba me vlerë 500,000 lekë, ndërkohë që **59** gjoba me vlerë **27,900,000** lekë janë në proces arkëtimi.

Gjithashtu nga ana e IMTV Bashkia Himarë nuk është bërë njoftim për Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për kontabilizimin dhe vjeljen e gjobave të subjekteve.

Veprime në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, përkatësisht neni 16.

Nuk është bërë i mundur llogaritja e penalitet në masën 2% për 30 nga momenti i moslikujdimi të gjobës nga ana e subjekteve, në zbatim të pikës 3, neni 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative.

- Gjatë periudhës së auditimit 01.01.2022 deri më 31.12.2022, janë nxjerrë në total 66-Vendime për prishje objektivash (kryesisht shtesa, mure rrethuese, ose ndërtime me struktura metalike dhe druri). Janë ekzekutuar nga Bashkia Himarë vetëm në 7 raste pasi nuk disponon mjetet e nevojshme për kryerjen e këtyre proceseve. Në raste të veçanta janë përdorur mjete private, pa kryer asnjë kontratë mes palëve (Bashkisë Himarë dhe personave që i disponojnë këto mjete) duke vepruar në kundërshtim me ligjin. Për këto raste janë kryer denoncime dhe ngritur padi kundër këtyre vendimeve. Gjithashtu nga ana e IMTV Himarë janë bërë njoftime subjekteve të ndryshme kundërvajtës për zbatimin vullnetar të urdhrave të dala nga Bashkia Himarë.

- Nga auditimi i praktikave të mbajtura nga IMTV, në lidhje me inspektimin në terren mbi kontrollet e ushtruara në subjekte të ndryshme sipas dokumentacioni teknik-ligjor, rezultoi se nuk dokumentohet plotësisht puna apo procesi i punës në rastet kur nuk konstatohen kundërvajtje apo në raste ku inspektorët dalin në terren mbi verifikimin e ndërtimeve pa leje. Nga ana e inspektorëve duhet të mbahet një regjistër apo libër ku të paraqitet procesi i punës së përditshme. Kjo në zbatim të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) Nr.10296 datë 08.07.2010, neni 16, gjurma e auditimit.

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Himarë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin të subjekteve nën juridiksionin e saj.

7.2.Rekomandimi: Nga ana e sektorit të Kryeinspektorit të IMTV-së të merren masa për hartimin dhe zbatimin rigoroz të programit vjetor/mujor të inspektimit, si dhe të raportojë periodikisht sipas detyrimit ligjor pranë IKMT-së.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjambat e vendosura nga IMTV, për **59** gjoba me vlerë **27,900,000** lekë.

IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit, duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatë vonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Brenda datës 30.09.2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi administrimin e taksave e tarifave vendore në Bashkinë Himarë, rezulton se:

Plani i të ardhurave është realizuar në masën 110 %, ku nga vlera 550,547 mijë lekë e parashikuara është arkëtuar vlera pR 608,652 mijë lekë, me një diferencë në plus pR 58,105 mijë lekë. Ndikim në këtë realizim ka dhënë TNI e cila nuk është planifikuar saktë, pasi nga vlera e parashikuar prej 290,247 mijë lekë është arkëtuar vlera pR 348,670 mijë lekë, duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 me vlerë 331,102 mijë lekë.

Në lidhje me detyrimet e paarkëtuara deri më 31.12.2022 për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjarë paraqitet në shumën 246,517,068 lekë për 3154 subjekte/abonentë, nga e cila: *për subjektet fizik/juridik në vlerën 193,521,676 lekë për 989 subjekte dhe abonentë familjarë për vlerën 52,995,392 lekë për 2165 abonentë.*

Në krahasim me fundin e vitit 2021, totali i detyrimeve të paarkëtuara është rritur për vlerën 79,284,260 lekë, nga e cila: *për subjekte fizik/juridik në vlerën 69,810,163 lekë dhe për abonentë familjarë në vlerën 9,474,097 lekë.*

Referuar të dhënave të mësipërme si dhe dokumentacionit, nga Drejtoria e Taksave Vendore për arkëtimin e tyre është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve, duke mos ndërmarrë asnjë veprim tjetër deri në kallëzim penal, gjë e cila konstatohet dhe nga vlera e lartë e detyrimeve për subjektet fizik/juridik të cilët megjithëse ushtrojnë aktivitet nga viti në tjetrin vlera e detyrimeve vjen në rritje, duke mos marrë asnjë masë për arkëtim, ku vetëm për subjektet mbi 1 milionë lekë detyrime janë 38 subjekte me vlerë 59,637 mijë lekë sipas Aneksit 1, bashkëlidhur RPA.

Gjithashtu konstatohet dhe fakti se Ndërmarrja e Ujësullës Kanalizime si agjent tatimorë për arkëtimin e detyrimeve të abonentëve familjarë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të arkëtuara të cilat nuk janë xhiruar në Bashkinë Himarë, kjo për vlerën **20,024 mijë lekë**, sipas Aneksit 2, bashkëlidhur RPA (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 24.25, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave vendore Bashkia Himarë të marrë masa për:

- Ndjekjen e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve pR 246,517,068 lekë për 3154 subjekte/abonentë, nga e cila: *për subjektet fizik/juridik në vlerën 193,521,676 lekë për 989 subjekte dhe abonentë familjarë për vlerën 52,995,392 lekë për 2165 abonentë.*

- Të kërkojë në rrugë ligjore e administrative arkëtimin e vlerës së detyrimit të arkëtuar nga UK sha Vlorë por të palikujduara në llogarinë e Bashkisë për vlerën **20,024 mijë lekë**.

Në çdo rast të mos derdhjes së detyrimeve të arkëtuara nga UK sha Vlorë apo të pa mbledhura (*të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj*), të fillojë procedurat për gjobitjen e Agjentit Tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

- Të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore si edhe të hartohet regjistri i familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim rritjen e të ardhurave.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE:

E.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të dR tat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Himarë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë.

a) Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj, neni 58 germa (b) për 6 punonjës;

1. Z. L.M, në cilësinë e DR torit të Financës, nuk ka kryer procedurën për tërheqjen e garancisë të depozituar nga O.E. E. K. me vlerë 1,333,333 lekë pa TVSH “*Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat*” 2022, i cili është tërhequr nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit, në kundërshtim me Nenin 30, Pika 6 E VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar”.

2. Znj. B.R, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:

“Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh” për vitin 2022.

“Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç” për vitin 2022.

“Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjetësi, Hundë E Xhepe Bolenë” për vitin 2022,

në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

3. Z. A.B, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh” për vitin 2022, në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

4. Z. A.G, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:

“Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç” për vitin 2022

“Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjetësi, Hundë E Xhepe Bolenë” për vitin 2022,

në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

5. Z. U.D, në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt:

“Sistemimi i rrugëve të fshatit Kuç” për vitin 2022

“Rrugë Mirëmbajtje Linje Ujësjetllësi, Hundë E Xhepe Bolenë” për vitin 2022, në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006.

6. Z. S.K , në cilësinë e personit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës me objekt “Rikonstruksioni dhe rinovimi i sallës polifunksionale të bashkisë”, ku u konstatuan problematika në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës, në kundërshtim me zbatimet e kushteve të Kontratës së sipërmarrjes nr.3197/19 datë 07.12.2022 si dhe për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejtëtë vlerave monetare.

b) Pezullim nga e drejtat ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, neni 58 germa (c), për 3 punonjës.

1. Z. F.B , për vlerësimin teknik pozitiv të praktikës në shkresën me nr.180 prot. datë 08.11.2022 me lëndë: “Raport i Vlerësimit Teknik”.

2. Zj. E.R , specialiste e praktikës Për miratimin e lejes së ndërtimit Nr.86, Nr.1429/1 datë 10.06.2022, të Kryetarit të Bashkisë Himarë për objekt “G "Q ’.

3. Z. D.B , në cilësinë e anëtarit të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i kompleksit sportiv rajonal Borsh” për vitin 2022, në mospërputhje me Nenin 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, Ligji nr.9643 datë 20.11.2006, si dhe për përlllogaritjen e gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë me pasojë arkëtimin e padrejtëtë vlerave monetare.

E.2. Për punonjësit e larguar.

Për ish-punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre, përkatësisht:

Z. G.S , në cilësinë e ish- drejtues it të DPZHT

Znj. K.M, në cilësinë e ish- DR torit Juridik

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Himarë, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë

në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Perfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTE I SHTETIT